

ETIKA



TA BËSH SHPIRTIN
FOLE MËSHIRE
OSMAN NURI TOPBASH



MODELI MË I BUKUR
NJERËZOR
ALI RIZA TEMEL



MUHAMEDI (A.S.)
TRËNDAFIL ME AROMË
TË PËRHERSHME
ALI. F. ILJAZI



SEMRA ÇEKMEGIL
MIQËSIA MES
NJERIUT DHE KURANIT



MARRËDHËNIA JONË
ME TË KALUARËN
NUREDIN NAZARKO



FERID PIKU
POROSITË E PROFETIT

A JE GATI



Prill 2013

VITI: VII
NUMRI: 61

BOTUESI
Shtëpia botuese Progresi

DREJTOR & KRYERADAKTOR
Alban Kali

REDAKTOR
Zija Vukaj

LEKTOR
Albri Brahushta

KORREKTORE
Dr. Irida Hoti

PËRKTHYES
Albert Halili
Arjan Ymeraj
Artur Tagani
Fatmir Sulaj
Ilir Hoxha

DIZAJN
Bledar Xama

ADRESA
L: Vasil Shanto; Rr: Çajupi
Shkodër; Shqipëri

MOBILE
+355 67 208 6767

E-MAIL
revistaetika@progresibotime.com

WEBSITE
www.revistaetika.com

KOSOVË
Rr: Ardian Zurnaxhiu; pn. Ralin
Prizren; Kosovë
Mob: +377 4411 9848

MAQEDONI
Drvarska 28; Stara Carsija
Skopje; Makedonija
Mob: +389 7042 8245

ABONIMI VJETOR
Shqipëri: 2000 lekë
Kosovë: 15 Euro
Maqedoni: 900 Denar

Ju bëjmë të ditur se materialet e sjella në redaksi pavarësisht nëse botohen apo jo nuk i kthehen autorit. Koha e botimit të një materiali përcaktohet nga redaksia. Honoraret e shkrimeve autoriale ose përkthimeve duhet të vini t'i tërhiqni pranë Shtëpisë Botuese Progresi ose pranë zyrave të përfaqësimit në Kosovë dhe Maqedoni.

Muhamedi (a.s.), është profeti dhe shehbuli i fundit i dërguar nga Allahu për njerëzimin. Ai është i përsosur në të gjitha aspektet. Allahu e përcakton qartë në Kuran personin që duhet marrë si shehbul dhe të mirat që sjell ndjekja e tij: **“Në të Dërguarin e Allahut ka një shehbul të mrekullueshëm për atë, që shpreson tek Allahu dhe Dita e Fundit dhe e përmend shumë Allahun.”** (Ahzab, 21) Ndjekja e Pejgamberit (a.s.), është detyrë dhe virtyt i vyer për çdo besimtar.

Të gjithë pejgamberët kanë qenë udhërrëfyes, prijës dhe shehbulj të përsosur për popullin. Para ardhjes së Pejgamberit (a.s.), shoqëria vuante nga mungesa e shehbuljeve të gjallë. Kur u shfaq Pejgamberi (a.s.), me mësimet hyjnore dhe moralin e përkryer, menjëherë u mor si shehbul nga sahabët, për të vazhduar më tej nga të gjithë besimtarët deri në Ditën e Kiametit. Ngrënia-pirja si Profeti, sjellja me njerëzit si ai, të qenët mik, bashkëshort dhe komshi si ai, janë parë gjithmonë si ideale të dëshirueshme nga të gjithë besimtarët. Thënia e tij: *“Jam dërguar për të plotësuar e përsosur moralin e mirë”,* përbën një ftesë për ta ndjekur atë si një Pejgamber, i Dërguar, për t’u mësuar njerëzve moralin e bukur. Ai erdhi për t’u mësuar njerëzve besimin, aq të nevojshëm për ta. Shkëputja e plotë nga idhujtaria dhe kushti që të adhurohet vetëm Allahu, është hapi parë i bërjes së njeriut, njerëzor.

Pas imanit, hapi i dytë i domosdoshëm për t’u bërë njeri i përkryer është ibadeti. Muhamedi (a.s.), krahas imanit hodhi themelet për krijimin e një shoqërie ideale dhe një qytetërimi madhështor. Përmes Muhamedit (a.s.), njerëzimi shpëtoi nga botëkuptimi pagan, duke përvetësuar parime që do ta çonin në kulmin e marrëdhënieve ndërnjerëzore. Ndër shumë parime të jetës qytetare, Pejgamberi (a.s.), u mësoi njerëzve dashurinë, mëshirën, solidaritetin dhe ndihmën reciproke. U mësoi devotshmërinë, u mësoi të qëndronin larg nga gjërat e ndaluara. U tregoi se të pasurit kanë detyrime mbi të varfrit. Ua qëndisi në zemër besimtarëve se

sadakaja më tepër se mirësi, është detyrim për besimtarët. Duke inkurajuar për bujari, u bëri të qartë se imani dhe koprracia nuk mund të gjenden në të njëjtën zemër.

Një nga parimet bazë të mësimëve islame është respektimi i të drejtave të njeriut dhe marrja në mbrojtje e tyre. Vrasja e një njeriu të pafajshëm, është si vrasja e të gjithë njerëzimit.

Muhamedi (a.s.), i konsideroi si amanet gratë dhe i këshilloi sahabët ta ruanin në mënyrën më të mirë amanetin dhe për këtë tregoi shehbulin e vet. U tregoi se muslimani më i mirë dhe më i devotshmëm, është ai që sillet më mirë me gruan e tij. Femrën e vlerësoi si pasurinë më të shtrenjtë të kësaj bote. Një tjetër parim i Pejgamberit (a.s.), është fshirja e të gjitha dallimeve dhe ndasive racore apo sociale. Pejgamberi (a.s.), na mësoi përmes mësimëve të Tij, se një arab nuk ka përparësi ndaj një joarabi dhe një i bardhë ndaj një të ziu. Dallimi ekziston vetëm në mirësi dhe devotshmëri. Nxitja për t’u pajisur me dituri përbën një nga shehbulj më të qartë të Pejgamberit (a.s.). Ai e konsideroi obligim kërkimin e diturisë për besimtarët. Kjo bëri që besimtarët të kërkojnë dituri në çdo cep të botës, duke përhapur dritën e dijes në gjithë botën.

Pejgamberi (a.s.), përmes shehbulit të Tij vendosi parime të pavdekshme në të drejtën civile. Një nga konceptet bazë, që Pejgamberi (a.s.), ia mësoi njerëzimit është koncepti i drejtësisë. Ai urdhëroi të gjykohej me drejtësi midis njerëzve.

Islami i ofroi njerëzimit një formë të shëndoshë qeverisjeje dhe në këtë kontekst përsëri shehbuli më i përkryer është Pejgamberi (a.s.). Ai (a.s.), megjithëse i Dërguar i Allahut, të gjitha vendimet i merrte duke u këshilluar me shokët. Këtë mënyrë ua urdhëroi shokëve dhe gjithë besimtarëve. Në këtë kontekst, i urdhëroi besimtarët t’i bindeshin drejtuesit dhe të mos krijonin anarki.

A nuk janë këto mësimë shehbul në çdo kohë dhe çdo vend për besimtarët dhe prijësit e tyre që dëshirojnë lumturinë në këtë botë dhe tjetrën?

Përmbajtja



8

Ali Riza Temel
Modeli më i bukur njerëzor



Osman Nuri Topbash
Lukmani (a.s.)

34



16



26

Prof. dr. M. Faruk Bajraktar
Për dashurinë ndaj fëmijëve

5 A je gati?

Ahmet Tashgetiren

11 Marrëdhënia jonë me të kaluarën
Nuredin Nazarko

12 Muhamedi (a.s.) - Një model
në komunikimin me njerëzit
Hasan Baftijari

16 Morali i Pejgamberit (a.s.),
ishite moriali i Kuranit
Shaban Ishlek

21 Kërko zotëruesin e xhenetit
M. Sami Ramazanogllu

25 Muhamedi (a.s.)
trëndafil me aromë të përhershme
Prim. dr. med. sc Ali F. Iljazi

30 Respekti është si një kandil
Neslihan Nur Turk



44

Një Ajet - Një Hadith 32

Medreseja e Madhe 42
e Gjakovës, vatër e dijes
A janë fetarë njerëz të tillë? 43
Muhamed El-Gazali

Familja Profetike 44
Altin Torba
Jeta 47

Festim Rizanaj
Miqësia mes Njeriut dhe Kuranit 48
Semra Kyrin Çekmeçil

Të kuptosh sahabët 50
Nuredin Jëlldëz



Plotësisht 52
Idris Arpat

Porositë e Profetit 54
Ferid Piku

Libri: Rugëtimi i shpirtit 57
Librari Progresi

40

Prof. dr. Ahmet Arakça
Muhamedi (a.s.), lider model



50



A je gati

Ahmet Tashgetiren

Zëre se sot, bota është Mesxhidi Nebevi!...

Zëre se ai (Profeti, a.s.) ndodhet në të gjithë mihrabët².

Ai është në të gjitha minberet³, ai është në të gjitha kursitë⁴.

Ai është mësuesi që qëndron para të gjitha rahleve⁵.

Zëre se të gjithë zërat e botës i përkasin atij.

Për të shkruajnë të gjithë librat dhe artikujt.

Zëre se ai thërret prej të gjithë ekraneve...

Zëre se çdo shkollë është mbështetur në atë Mesxhid të shenjtë.

1. Mesxhidi Nebevi: Xhamia e Profetit (a.s.), në qytetin e Medinës.

2. Mihrab: Pjesë e xhamisë, e cila është e pozicionuar në drejtim të kiblës prej ku prin imami.

3. Minber: Foltore me shkallë prej nga ku imami mban hutbet e xhumasë.

4. Kursi: Vend në formë foltoreje nga ku imami mban ligjëratat.

5. Rahle: Mbajtëse e cila shërben për të vendosur Kurandin gjatë leximit.

Zëre se të gjitha ëndrrat, po shohin atë.

Zëre se ai po të zgjat dorën, po të fton, po të thërret...

A je gati, pyete zemrën a je gati, pyete veten, pyete, pyete...

A je gati t'ia mbash dorën?

A je gati t'i japësh zë zërit të tij?

A je gati t'i shkosh pas?

Zëre se Ravza⁶ u rrit, u rrit, u rrit dhe u bë univers...

A je gati ta vësh ballin në sexhde, në xhenet?

Zëre se në derën tënde ai trokiti papritur...

Derën e zemrës tënde...

A je gati ta hapësh?

Zëre se të doli përpara, kur je duke shëtitur në ndonjë rrugicë,

6. Ravza: Vendi ku pushon trupi i Profetit (a.s.).



A je gati t'i thuash, t'u bëfshin kurban nëna dhe babai im?

A je gati të thuash, ti je shpirt, ti je zemër?

Zëre se ai të thirri, nga zinxhirët të shpëtosh,

Ai të thirri, prangat e këmbëve të t'i këpusë...

A je gati të shpëtosh nga prangat dhe zinxhirët?

Zëre se zbriti dhe erdhi nga Hira⁷...

Në fytyrë i dallohet thellësia, ankthi dhe emociioni i thirrjeve...

"Lexo! Lexo! Lexo me emrin e Zotit tënd Krijues..."

Në sytë e tij duket barra e shpalljes prej takimit me Xhebrailin (a.s.)...

A je gati të bëhesh Hadixhe (r.a.)?

A rrjedh në venat e tua besnikëria e Ebu Bekrit (r.a.)?

A je gati të bëhesh Ali (r.a.)?

Të kapërdish besimin në moshë të fëmijërisë,

Të shtrihesh në shtratin me rrezik vdekjeje?

A je gati të bëhesh Sumeje apo Jasir, duke e ditur se fundin do ta kesh i therur copa copa?

A je gati të bëhesh Bilal, edhe sikur besimi të të dalë përballë si diçka për të cilën duhet ta paguash shtrenjtë?

Apo dëshiron të bëhesh Omer, që piu eliksirin e një reforme rrënjësore të shpirtit të tij?

Kur? Si? Në ç'kohë të arrin ai në zemrën tënde?

Kur? Si? Në ç'kohë do të çelë lulja e Pejgamberit në botën tënde?

Sikur ai të të lexonte Kuran gjithmonë, gjithmonë, gjithmonë...

Çfarë do të bëje?

A je gati të ngopesh me Kuran?

Ajo që ka thënë, arriti tek ti:

"Nuk do të hyni në xhenet përderisa nuk besoni, dhe nuk do të besoni, derisa nuk do ta doni njëri-tjetrin!"

A je gati t'i fshish urrejtjet ndaj vëllezërve të tu besimtarë?

A je gati t'i kapërdish zemërimet?

A je gati të pastrohesh nga papastërtitë e zemrës?

A je gati t'i lutesh Allahut duke thënë: "Më jep dashuri, o Zot! Fale vëllain tim, o Zot! Pastroje zemrën time, o Zot!"

A je gati të pajisesh me dashuri?

A je gati ta vësh kokën në tokë si Ebu Dherri?

E të thuash: "Shkele këtë kokë, që të kuptojë e të mos shohë më kurrë zemër të zezë në një fytyrë të zezë".

Ja shiko! Ai po të thotë "Eja". Me një thirrje të përjetshme, po u thërret të gjitha kohëve. Për të vendosur dorën e tij në dorën tënde dhe mbi dorën tënde. Pra, a je gati t'i shtrëngosh dorën për një besëlidhje, duke vënë në lojë jetën tënde?

Ja shiko! "Dora e Allahut" qëndron mbi duart e atyre që takohen me dorën e tij...

A je gati të vendosësh duart mes atyre duarve?

Si do të vijë Profeti në jetën tënde?

A je gati të pyesësh?

Zëre se ai u rrethua në Hunejn dhe ti e sheh...

Zëre se para teje qëndronte, kur në Uhud dhëmbët ia gjakosën...

I pe, kur Hamzait ia kafshuan mëlçinë...

Pe Mus'abin duke rënë në përtokë.

Si do të ndihesh?

Çfarë do të ndjeje në zemrën tënde?

Dhithërim, dhimbje apo vaj?

A do të doje të ishe prej atyre që u hodhën në prehrin e vdekjes si dëshmorë, duke thënë: **"Nëse Muhamedi ka vdekur, përse të rrojmë ne?"**

7. Hira: Shpellë në malin Hira, që ndodhet në rrethinat e Mekës.

Një nënë që ka humbur djalin e saj?
Një bashkëshorte që ka humbur burrin e saj?
Apo ai që përpiquej të thoshte: **“Më parë... më parë... më parë më thoni gjendjen e Pejgamberit”?**

Po në Uhud, kush do të doje të ishe?
Kush do të doje të ishe, kur u lëshua kushtrimi për luftë...

Kur të lëshohej, eja me jetën, eja me pasurinë, eja patjetër?..

A do të vinin në mendje pretekste?

Apo...

Do të kishe mbledhur çfarë kishe e çfarë nuk kishe dhe...

Do të bëheshe prej atyre që thanë: **“Në shtëpi lashë Allahun dhe të Dërguarin e Tij”?**

Mbylli të gjitha kursitë për një çast,
Bëji të heshtin të gjithë zërat për një çast,
Drejtoju zemrës dhe mbylli të gjitha kanalet për një çast.

Pa dëgjoje njëherë atë.

Dëgjoje përsëri.

Hapja përsëri zemrën.

Le të dalë para syve, për një çast.

Bëhu dikush tjetër.

Le të ndjejë dora jote, ngrohtësinë e dorës së tij, për një çast.

Mallëngjehu me të, për një çast.

Ndizu me eshkën e tij, për një çast.

Digju nga dashuria për të, për një çast.

Fute atë brenda në shpirt.

Mos qëndro pa të, asnjë çast.

Kudo që t'i hedhësh sytë, atë shih, për një çast.

Duaje, për një çast.

Ngjyrosu me ngjyrën e tij, për një çast.

....

Zëre se ai erdhi duke kapërcyer katërmbëdhjetë shekuj...

Zëre se shkove ti përmes shekujve...

....

Është koha për të riorganizuar gjithçka.

Për të kurdisur orët nga e para...

Për t'u bërë përsëri umeti i Muhamedit (a.s.).

Për t'u bërë sërish besimtar.

Për të gjetur përsëri formulën e shehadetit...

Të besosh përsëri se: **“Allahu ekziston dhe është Një!”**,

Të besosh përsëri se: **“Muhamedi është rob dhe i Dërguari i Tij.”**

Ai gjithmonë thërret...

Gjithmonë fton.

Gjithmonë në krye...

Ai gjithmonë zgjat dorën.

Dëgjoje përsëri...

Drejtoje përsëri zemrën tek ai...

Shikoje përsëri...

Shiko kiblën^o tënde.

Kontrollo vendin ku shkel.

Kthjelloji sërish ndjenjat.

Laji duart...

Laji sytë...

Laj zemrën dhe mendjen...

“Sulltani nuk vjen në saraj pa iu ndërtuar shtëpia!”

Ndërto shtëpinë e shpirtit.


Shpenzo gjithçka që ke, për Pejgamberin fisnik.

Zëre se pak më vonë, dera jote do të trokasë dhe ai do të urdhërojë...

A je gati?

A je gati?

A je gati?



Modeli i bukuri NJERËZOR

All Riza Temel

Njeriu është krijuar për të qenë halife dhe dëshmues i Allahut mbi tokë, për të mbajtur në këmbë të vërtetën dhe për të mbajtur mbi supet amanetin. Mirëpo, për t'i mbartur në kuptimin e vërtetë të fjalës të gjitha këto cilësi, ai ka nevojë për një proces maturimi që zgjat gjithë jetës dhe për një njeri model, i cili i mbart të gjitha këto cilësi.

Përparimi i njeriut në rrugën e përsosmërisë, nuk është i mundur vetëm me njohjen e të vërtetave. Të vërtetat që nuk gjejnë jetë në sjelljet njerëzore, jetojnë si teori vetëm nëpër libra dhe mendje. Në krye të njerëzve që i vënë në jetë të vërtetat dhe parimet, vijnë profetët. Ata janë zgjedhur prej Allahut dhe janë ngarkuar me detyrën e zbatimit dhe mësimin të mënyrës së jetesës së vërtetë njerëzore. Dhe i fundit prej profetëve është i dashuri ynë, Muhamedi (alejhi salatu ue selam).

Muhamedi (a.s.), i cili u dërgua për të edukuar të gjithë njerëzimin dhe për të plotësuar moralet e bukura, u përgatit për këtë detyrë prej Allahut Teala. Profeti (a.s.), ka thënë: *"Mua më edukoi Allahu dhe më dha një edukatë të bukur."* (Keshfu'l hafâ 1/170.) Ndërsa i Lartmadhëruari na e ka prezantuar në këtë mënyrë të dashurin e Vet: **"Në të Dërguarin e Allahut ka një shembull të mrekullueshëm**

për atë që shpreson tek Allahu dhe Dita e Fundit dhe e përmend shumë Allahun." (Ahzab, 21)

Profeti (a.s.), ishte në majat më të larta të moralit dhe jeta e tij zhvillohej në bazë të Kuranit Kerim. Prandaj, ai është edhe shembulli më i bukur për çdo fushë të jetës. Ai është modeli më ideal si mësues, tregtar, komandant, kryefamiljar, kryetar shteti, gjykatës etj. Duke e përmbushur me sukses detyrën e tij si një profet lehtësues, përgëzues, paralajmërues dhe zbatues, me fjalët dhe veprat e tij u bë udhëzuesi më ideal për njerëzimin.

Ja disa tablo nga jeta e tij shembullore në lidhje me moralin e tij të përsosur:

Prej parisë së sahabëve, Enes bin Malik tregon: "Unë i shërbeva Resulullahut për dhjetë vjet rresht, që prej moshës tetëvjeçare, në Medinë dhe jashtë saj. Ashtu siç nuk më tha qoftë edhe njëherë, "of", për një punë që e kam bërë ose nuk e kam bërë, nuk më ka thënë kurrë, "përse e bërë kështu, përse nuk e bërë ashtu". Ai nuk më ka qortuar kurrë për asnjë gabim apo të metë që kam pasur".

Sipas një transmetimi të Muslimit, Muauije bin Hakem, tregon: "Isha duke falur namazin pas

Resulullahut (a.s.). Gjatë namazit, dikush tesh-tiu. Kurse unë i thashë "Jerhamukellah /Allahu të mëshiroftë!" Të pranishmit m'i ngulën sytë. Përse m'i ngulën ashtu sytë? - thashë me vete. Por kur thashë edhe disa herë "jerhamukellah", ata filluan të rrihnin edhe gjunjët me dorë. Kur ma bënë me shenjë "pusho", unë e mbylla gojën. Pasi Resullahu (a.s.), mbaroi namazin, më thirri. – Ju bëfshin kurban nëna me gjithë babain - unë nuk kam parë mësues më të mirë se ai, as më parë dhe as më pas. Ai as më qëlloi, as më dënoi dhe as më qortoi, por më tha vetëm këto fjalë: "Gjatë namazit nuk flitet asnjë fjalë e kësaj dynjaje, por bëhet vetëm dhikër, tekbir dhe lexohet Kuran".

Sipas një transmetimi të Ebu Umames: "Një i ri erdhi tek Resullahu (a.s.) dhe i kërkoi leje për të bërë zina¹. Të pranishmit ngritën zërin duke i thënë të mos fliste. Kurse Resullahu (a.s.), e pyeti të riun: 'A do të dëshiroje që dikush të bënte zina me nënën, me motrën dhe me hallën tënde?' Kur i riu tha: 'Jo, kurrë nuk do të dëshiroja!', atëherë Resullahu (a.s.), tha: 'Ashtu si ti, edhe njerëzit e tjerë nuk do të dëshironin që dikush të bënte zina me nënat, me motrat dhe me hallat e tyre. Pra, ato që nuk i dëshiron për veten, mos i dëshiro as për të tjerët. Ato që i dëshiron për vete, dëshiroji edhe për të tjerët.' Më në fund, i riu u bind dhe u bë njeri i ndershëm."

Transmetohet nga Xhabiri (r.a.), se: "Një beduin, erdhi tek Resullahu (a.s.), dhe e pyeti: 'Në xhenet, a do t'i endim vetë pëlhurat për veshje apo do t'i marrim të gatshme prej xhenetit dhe do t'i qepim?' Sahabët filluan të qeshnin. Kurse beduini tha: 'Kujt i qeshni? Të paditurit që pyet për të mësuar atë që nuk di?' Pas këtyre fjalëve, Resullahu (a.s.), tha: 'O beduin! Ti ke të drejtë të pyesësh. Veshjet e xhenetit do të qepen prej copave të gatshme të xhenetit'. Në këtë mënyrë, ai e shpëtoi edhe beduinin prej situatës së keqe."

Profeti ynë (a.s.), i vlerësonte dhe i respektonte

1. Zina: Marrëdhënie seksuale jashtëmartesore.

të gjithë. Kur i jepte dorën dikujt, asnjëherë nuk e tërhiqte dorën i pari. Kur dikush i drejtohej me fytyrë, Profeti (a.s.), nuk e kthente fytyrën e vet, derisa ta kthente ai. Ndërsa, kur ulej në mexhllis (kuvend), nuk i zgjaste këmbët përpara askujt.

Sipas një transmetimi të Buhariut dhe Muslimit, Enesi (r.a.), tregon: "Isha duke ecur me Resullahun (a.s.). Profeti kishte veshur një rrobë të bërë me cohë jemeni dhe me jakë të ashpër. Erdhi një beduin dhe e tërhoqi fort Profetin (a.s.), prej rrobës. Vura re se kjo tërheqje e fortë la një shenjë në qafën e Resullahut (a.s.). Mbi të gjitha, ky beduin i paditur dhe i paedukatë, tha: 'O Muhamed! Jep urdhër të më japin diçka prej këtyre mallrave.' Pas kësaj, Resullahu (a.s.), qeshi dhe urdhëroi t'i jepej diçka prej asaj pasurie."

Ai arriti të qytetëronte edhe njerëzit më të paedukatë, më të paditur, më të vrazhdë dhe më kokëfortë, të cilët ishin larg qytetërit. Ai ua shndërroi mendjet dhe zemrat. Ky është revolucioni i vërtetë. Edhe sikur të ishin dërguar me mijëra filozofë në shkretëtirë, ata nuk do të kishin realizuar as edhe një të mjtën e reformës që realizoi Profeti (a.s.). Transformimi më i madh dhe më i rëndësishëm është ai i njeriut. Me durim, dituri dhe mëshirë edhe beduinët më të prapambetur u bënë njerëzit më të qytetëruar.

Sipas transmetimeve, në burimet e sigurta të hadithit, një beduin hyri në xhami, ndërkohë që Resullahu (a.s.), qëndronte ulur. Beduini fali dy rekat namaz dhe bëri këtë dua: "O Allah! Më mëshiro mua dhe Muhamedin. E mos mëshiro askënd tjetër!" Pas kësaj, Profeti (a.s.), i tha: "O vëlla arab! E ngushtove atë që është e gjerë." Më vonë, po i njëjti beduin urinoi në një cep të mesxhidit. Kur njerëzit iu vërsulën, Profeti ynë (a.s.), i ndaloi, duke u thënë: "Lëreni të mbarojë punë!". Pasi beduini mbaroi punë, Profeti (a.s.), urdhëroi e tha: "Ju nuk jeni dërguar si vështirësues, por si lehtësues. Mësoni, lehtësoni dhe mos vështirësoni. Tani hidhni ujë mbi vendin e urinuar." Beduini e kuptoi gabimin



e vet. Kurse Resulullahu (a.s.), i tha: *"Në mesxhid nuk urinohet. Mesxhidi është ndërtuar për të përkujtuar dhe adhuruar Allahun"*.

Profeti (a.s.), si një edukues i pashoq, i edukonte njerëzit në mënyra të ndryshme. Ja disa shembuj në lidhje me këtë çështje:

Një ditë, një beduin erdhi tek Resulullahu (a.s.), për t'i kërkuar ndihmë dhe i tha: *"O Muhamed! Më jep diçka, se nuk ke për të më dhënë prej mallit tënd apo të babait tënd!"*. Profeti ynë (a.s.), i dha diçka dhe tha: *"A të ndihmove? A u kënaqe?"*. Kur beduini tha: *"Jo nuk më ndihmove"*,- myslimanët u zemëruan dhe iu vërsulën. Ndërsa Resulullahu (a.s.), u bëri me shenjë të tërhiqeshin. Pastaj u ngrit dhe shkoi në shtëpinë e tij. Më vonë i dërgoi haber bedunit dhe e thirri në shtëpi, ku i dha diçka tjetër. *"Po tani a u kënaqe?"*- i tha Resulullahu (a.s.). Beduini, përsëri tha *"Jo"*. Profeti i shtoi edhe diçka tjetër dhe e pyeti përsëri: *"A u kënaqe?"*. Këtë herë, beduini tha se ishte kënaqur. Resulullahu (a.s.), tha: *"Ti erdhe këtu, kërrove diçka dhe ne të dhamë. Pastaj fole mbrapsht dhe myslimanët u zemëruan prej kësaj. Nëse do, tani shko e thuaju myslimanëve se je i kënaqur me mua, që zemërimi i tyre të shuhet"*. *"Mirë!"*- tha beduini dhe u kthye përsëri në mbrëmje (ose në mëngjes). Resulullahu (a.s.), u drejtua nga sahabët dhe tha: *"Ky shoku juaj ishte i uritur, prandaj kërkoi diçka prej nesh. Kurse ne i dhamë. Tani ai thotë se është i kënaqur prej nesh"* dhe duke u kthyer nga beduini e pyeti: *"A s'është kështu?"*. Beduini ia ktheu: *"Po, kështu është. Allahu të shpërbleftë me të mira ty, familjen tënde dhe të gjithë të afërmit e tu"*. Pas këtyre fjalëve, Profeti (a.s.), urdhëroi e tha: *"Sjellja ime me sjelljen tuaj i ngjan gjendjes së një njeriu që kishte një deve, e cila ishte e pabundur ndaj tij dhe ikte. Njerëzit i shkonin pas për ta kapur. Mirëpo kjo bënte që deveja të largohej edhe më shumë. I zoti i devesë u thotë atyre që ishin duke e ndjekur: 'Mos e ndiqni devenë. Ma lini mua, sepse unë sillem më butë ndaj saj! I zoti i devesë eci drejt saj, mblodhi pak bar dhe iu afrua. Deveja e pa barin,*

qëndroi në vend dhe u ul. I zoti ngarkoi ngarkesën dhe i hipi sipër. Pra, pikërisht si ky. Nëse nuk do t'ju kisha ndaluar në fillim, kur ju iu vërsulët, mbase do ta kishit vlarë të shkretin dhe do të bëhej prej banorëve të xhehenemit. Kurse unë, bëra çfarë kisha mundësi për ta kënaqur".

Edhe Profeti (a.s.), ishte njeri dhe ndoqi gjithmonë vijën njerëzore, duke mos dalë kurrë nga kufijtë e devotshmërisë. Ai nuk i lejoi kurrë ata që kërkonin ta nxirrnin nga këta kufij dhe ta bënin idhull. Ai jetoi me modesti si një individ i thjeshtë i shoqërisë. Nuk bëri dallime as për veten dhe as për të tjerët. Të gjithë i pa me syrin, se *"janë njerëz"*, si të pasurit e të varfrit, si robërit e pronarët, si ata që ishin të ndryshëm në racë dhe në gjuhë. Ai i jepte vlerë çdo gjëje të gjallë ose jo të gjallë dhe veçanërisht njeriut. Nëse nuk e shihte tri ditë rresht ndonjë prej sahabëve, pyeste, interesohej dhe, nëse nuk jetonte më, bënte dua për të, nëse jetonte ose ishte i sëmurë, i shkonte në shtëpi për vizitë.

Pjekuria dhe stolisja e njerëzve me cilësi të bukura dhe mbizotërimi i këtyre bukurive në botën tonë, është i mundur vetëm me marrjen shembull të profetëve në përgjithësi, profetit tonë në veçanti dhe robërve të dashur të Allahut.

Sot, kur vlerat materiale dalin në plan të parë dhe vlerat morale hidhen pas shpine, për të sjellë qetësi dhe paqe në botën tonë nuk kemi zgjidhje tjetër përveçse të motivojmë njerëzit të bëhen të mirë dhe të ndjekim rrugën e të mirëve. Rezultatet e mira arrihen nën udhëheqjen e njerëzve të mirë. Kurse udhëzuesi më i mirë është Profeti ynë (a.s.). Ai është shembulli më i mirë për çdo pjesë të jetës dhe për çdo shtresë. Çobani më i mirë, tregtari më i drejtë, mësuesi më ideal, komandanti më trim, miku më besnik, babai më zemërbutë, bashkëshorti më i dashur, lideri më i mëshirshëm dhe gjykatësi më i paanshëm. Këto cilësi që i përmendëm, ai i ka fituar duke i jetuar dhe zbatuar. Të gjithë duhet të organizohen sipas këtij modeli dhe duke parë veten në pasqyrë, të rregullojnë sjelljet dhe jetën e tyre.



Marrëdhënia jonë me të kaluarën

Nuredin Nazarko

Çdo qenie njerëzore ka historinë e saj mbi sipërfaqen e Tokës. Çdo histori ka ngjarjet e saj, autentike, origjinale, të papërsëritshme në përjetim. Historia e qenies njerëzore nuk mund të jetë tërësisht individuale, duke qenë se jetojmë dhe jemi të ekspozuar ndaj marrëdhënies që mund të krijojmë me historinë e cilësdo qenie, që mund të jetë bashkëkohëse e jona apo e vendosur në një kohë tjetër. Ngjarjet historike janë të vendosura në kohë dhe hapësirë, qofshin këto individuale ose jo. Edhe pse të vendosura në kohë dhe hapësira të ndryshme nisur nga koha dhe hapësira në të cilën jetojmë, ngjarje të veçanta apo histori që diferencohen qartë, i kapërcejnë dhe shpojnë tejprtej kufijtë e kohës dhe hapësirës në të cilën kanë ndodhur. Kjo është rrjedhim i pashmangshëm i natyrshmërisë së qenies njerëzore, shqetësimet dhe dilemat ekzistenciale të së cilës mbeten të njëjta, pavarësisht kohës dhe hapësirës në të cilën ajo jeton. Çdo njeri, çdo etni, çdo komb, çdo popull, çdo shoqëri, çdo bashkësi, ka një marrëdhënie të veçantë me ngjarje apo histori të diferencuara qartë, pra me të kaluarën, edhe pse është i magnetizuar nga ndërtimi i së ardhmes së panjohur. Çdo ngjarje e kaluar është histori dhe çdo histori i përket së kaluarës. Natyrisht që historia bazohet tek faktet, datat, emrat konkretë, vende të caktuara me rrethana historiko-shoqërore dhe me kushte fiziko-geografike të caktuara, të cilat shërbejnë si lëndë e parë për përpunimin dhe sjelljen në vëmendje të njerëzve të një kohe dhe hapësire të caktuar, të asaj çfarë ka ndodhur, pra sjelljen në vëmendje të një historie tashmë të institucionalizuar. Përtej këtij praktikiteti në rrëfimin dhe shtjellimin historik të së kaluarës, pra të asaj që na ka paraprirë, hasim dhe një lloj tjetër rrëfimi, i cili më shumë sesa interpreton dhe institucionalizon, kumton për ngjarje dhe histori në të kaluarën. Marrëdhënia jonë me faktet është institucionale, e ngurtë, tipike shkenciste. Marrëdhënia jonë me kumtimin është e çiltër, e hapur, njerëzore, emocionale, shpirtërore. Marrëdhënia jonë me faktet ndërtohet duke aplikuar metoda të cilat bëjnë që pavarësisht botëkuptimit, kulturës, identitetit të përvijohesh sipas disa kallëpeve të caktuara në interpretimin e fakteve, përndryshe nuk mund të jesh shkencor dhe, në qoftë se nuk je shkencor, zhvlerësohesh. Kjo marrëdhënie është problematike për qenien njerëzore, sepse institucionalizimi mund ta keqpërdorë hermeneutikën, "pastërtisht shkenciste" mbi faktet, për qëllime dhe interesa të caktuara, si dhe ta zhveshë të kaluarën nga njerëzorja, duke e veshur me kostumin e statistikës, tmerrësisht të ftohtë dhe të akullt. Në raport me kumtimin, marrëdhënia është e hapur, shpirtërore dhe si e tillë shtrihet në the-

llësitë e kohëve, duke ngritur një kohezion shpirtëror me të kaluarën. Ky kohezion i brendshëm me të kaluarën na rikthen vazhdimisht drejt saj, jo për të qenë nostalgjikë të pandreqshëm të një kohe të perënduar tashmë, por për të gjetur aty vetveten tonë si njerëz, si komb, si popull, si shoqëri, si bashkësi. Kësisoj, kumtimi na rikthen për ta parë të kaluarën tonë me të gjitha tonalitetet njerëzore të saj, për të mos e harruar të kaluarën tonë në arkivat e heshtjes dhe pluhurit shekullor në emër të së ardhmes së panjohur. Metodave shkenciste shtyhen drejt së ardhmes, shpeshherë duke parashikuar edhe fundin e historisë njerëzore me këtë apo atë ideologji apo sistem qeverisës, ndërkohë kumtimi duket sikur "nuk shqetësohet" për të ardhmen, meqenëse fton pandalshëm për reflektim ndaj së kaluarës. Ky "mosshqetësim" i hapur ndaj së ardhmes është një shqetësim ndaj vetëdijes njerëzore për të kaluarën, edhe pse ajo e kaluar është jetuar nga të tjera qenie njerëzore dhe jo nga ne. Reflektimi për të kaluarën, përmes kumtimit, pra të një historie pa shifra, por mbushur me shumë personazhe plot jetë, është reflektim për vlerat dhe antivlerat njerëzore, të cilat qëndrojnë përmbi kohën dhe hapësirën e përcaktuar shkencërisht. Kumtimi na bën me dije se në çfarë patën sukses dhe në çfarë dështuan, se ku vepruan mirë dhe ku vepruan keq, se ku u treguan njerëzorë dhe ku djallëzorë, ata të cilët na paraprinë. Kështu, kumtimi mban gjallë vetëdijen tonë për të shkelur atje ku shkelën ata që na paraprinë në vlerat njerëzore dhe për të mos shkelur atje ku shkelën ata që na paraprinë në antivlera. Sot mund të ngremë lavde e të thurim himne për ngjarje dhe histori të caktuara, ashtu sikundërse mund të mallkojmë dhe shfryjmë urrejtjen ndaj ngjarjeve dhe historive të caktuara. Marrëdhënia jonë me të kaluarën nuk duhet të jetë marrëdhënie faji e as mbivlerësimi për vendimet që kanë marrë ata që na paraprinë. Duhet të kuptojmë se çdo kohë dhe çdo ngjarje që ndodh në kohë, mirë apo keq, vendoset në një kohë të caktuar jo pa urtësi, edhe pse logjika e akullt shkenciste nuk rreh ta kuptojë këtë urtësi. Marrëdhënia jonë me të kaluarën përmes kumtimit, është marrëdhënie me urtësinë që flet pa urrejtje, pa izma, dhe na dëfton mësim të thella për ata që mendojnë rreth këtyre ngjarjeve të së kaluarës. Marrëdhënia me të kaluarën nuk duhet të shërbejë si zhvendosje e vëmendjes ndaj problemeve të së tashmes dhe as si shtrat i ngrohtë i ëndërrimeve, për shkak të dembelizmit dhe përtacisë për të punuar sot, duke harruar ata që ishim dje. Nuk mund të jemi të qartë sot, në qoftë se harrojmë ngjarjet që ndodhën dje. Ata që kaluan fituan atë që merituan, ne do të fitojmë atë që meritojmë.



Muhamedi (a.s.)

Një model në komunikimin me njerëzit

Hasan Baftijari

Ata që kanë mundësi të studiojnë komunikimin në nivel akademik, e dinë se sa teori, libra, studime ekzistojnë në procesin e ndërlikuar të komunikimit njerëzor. Modelet perëndimore të komunikimit, verbale, grafike, ose matematike, e kanë shumë të vështirë të përshkruajnë aspektet strukturore, funksionale dhe teknike të këtij fenomeni.

Megjithatë, shembulli më i mirë i një akti komunikimi në marrëdhëniet me njerëzit, mund të fitohet nga jeta e Profetit Muhamed (a.s.). Në të vërtetë, në rrethanat e përditshme të jetës së Profetit, ne vërejmë se ai ishte shembulli më i mirë në mënyrën se si i trajtonte njerëzit. Aftësitë e tij të komunikimit, me sjellje unike dhe interesante, gjithmonë i edukuar dhe i buzëqeshur, bënë që Profeti (alejhis-selam), të arrijë të fitojë zemrat e njerëzve që kishte përreth tij, si edhe të të gjithë atyre që krijojnë lidhje shpirtërore me të.

A MUND TË DËGJOHET ME SY?

Në Arabinë e lashtë, elokuenca përcaktonte pozitën e individit në shoqëri. Kjo, sepse gjuha arabe është e pasur me nuanca e ngjyrime kuptimore. Arabët konkuronin me njëri-tjetrin në thurjen e fjalëve të bukura, duke i dhënë kështu formë estetike artit gojor. Në këtë kohë lindi profeti Muhamed, paqja qoftë mbi të.

Dhe, megjithëse nuk dinte të shkruante dhe të lexonte, ai kishte shprehur gjuhësore më shumë se kushdo tjetër.

Këto aftësi ia bënë të mundur përcjelljen e koncepteve të vështira tek publiku, vetëm me pak fjalë. Thëniet e urta të Profetit (alejhis-selam), të cilat quhen "hadithe", janë përmbledhur në libra të shumtë, që mësohen dhe shërbejnë për të udhëzuar njerëzit kudo në botë. Edhe pse sot, më shumë vëmendje i kushtohet studimit të saktësisë së fjalëve të profetit Muhamed (alejhis-selam), duke mos u dhënë rëndësinë e duhur aftësive të shumta verbale e joverbale, të cilat ai i përdorte për të theksuar kuptimin e fjalëve, një gjë është e sigurtë se ai, Profeti (alejhis-selam), kishte aftësi të jashtëzakonshme për të aktivizuar të gjitha shqisat e dëgjuesit e jo vetëm shqisën e të dëgjuarit.

PIKTURA MENDORE ME FJALË

Gjatë leximit të haditheve, shpesh mund të përfitojmë pamje të gjalla, plot tinguj, aroma dhe ndjenja. Në të njëjtën kohë, transmetuesit e haditheve përdorin fjalë përshkuese, për të na dhënë një pamje të plotë tredimensionale të çdo ngjarjeje. Kështu, ne mund "të shohim" me syrin e mendjes, gjestet dhe veprimet konkrete të Profetit (alejhis-selam), kur ai fliste.

Për shembull, çifutët ishin mësuar të provokonin dhe të ofendonin dhe këtë mundoheshin ta bënin edhe me Profetin Muhamed (a.s.). Në një rast, njëri nga çifutët e përshëndeti Profetin (alejhis-selam), duke i thënë: "Es-samu'alejkum – Vdekja qoftë për ju!" Kur Profeti me një ton të butë u përgjigj: "Ve'alejkum – Edhe për ju", gruaja e tij,

Aishja, radijall-llahu anha, duke mos arritur ta ruante qetësinë, ua ktheu çifutëve përgjigjen, duke u thënë: "Vdekja qoftë mbi ju!" Me këtë rast, i Dërguari i Allahut, Muhamedi (alejhis-selam), iu drejtua Aishes, duke e këshilluar:

- O Aishe, Allahu i Madhërishtëm nuk e do vrazhdësinë dhe paturpësinë!

Aishja ia ktheu:

- Po a nuk e dëgjove përshëndetjen e tyre, o Profeti i Zotit? Ata thanë: "Vdekja qoftë për ju".

Kurse i Dërguari i Allahut iu përgjigji:

- A nuk e dëgjove se unë u përgjigja "ve alejkum", pra "Edhe për ju".

Dhe Allahu (xh.sh.), zbriti shpalljen, ajetin e tetë të sures Muxhadele: **"Ata, kur vjnë te ti, të përshëndesin me atë që Allahu nuk të përshëndet edhe vetë me vete thonë: "Përse Allahu nuk na dënon për këtë që po themi?" Por mjaft është për ta Xhehennemi, në të cilin hidhen. Sa vend i shëmtuar është ai."**

Në një transmetim tjetër thuhet se, kur Aishja (r.a.), e dëgjoi përshëndetjen e çifutëve drejtuar Profetit Muhamed (alejhis-selam), u përgjigji me hidhërim të madh, duke u thënë: "Edhe për ju qoftë poshtërimi, vdekja dhe mallkimi" dhe se Muhamedi (alejhis-selam), i kishte thënë asaj: "Ajo që ne themi për ta, pranohet; kurse ajo që ata thonë për ne, nuk pranohet".

Ky është shembulli më i mirë se si Profeti Muhamed (alejhis-selam), u shmangej situatave, që fyerjen të mos e kthente me fyerje. Ky është edhe një shembull që na jep një mesazh me shumë vlerë, se si Muhamedi (alejhis-selam), i trajtonte njerëzit, duke përfshirë këtu edhe jo-besimtarët.

Nga sjellja e tij praktike dhe komunikimi me njerëzit, ne mund të nxjerrim një mësim të rëndësishëm, audienca e një mësuesi me aftësi të rralla komunikuese, duhet t'i vërë në funksion të gjitha shqisat, për të nxjerrë kuptime të sakta dhe mësim të rëndësishme. Kjo është arsyeja se pse njerëzit rreth Profetit Muhamed (alejhis-selam), u transformuan në pak vite dhe arritën të ndërtonin një qytetërim madhështor. Atëherë, ndoshta edhe ne duhet të ndjekim të njëjtën rrugë sot. Pra, nuk mjafton të lexojmë e të mësojmë përmendsh thëniet e Profetit (alejhis-selam), por është e rëndësishme t'i ndiejmë efektet pozitive të këtyre thënieve në zemrat dhe mendjet tona dhe t'i praktikojmë ato në jetën reale.

Në të kaluarën e afërt, një nga modelet më me ndikim në historinë e humultimeve të komunikimit, është modeli i komunikimit i Shenonit dhe Viverit (1949). Shenoni e përshkruan komunikimin si një proces linear, njëkahësh, i cili përbëhet prej 5 funksioneve thelbësore, të cilat duhet të ekzistojnë, në mënyrë që komunikimi të jetë i suksesshëm: burimi i të dhënave, dërguesi, kanali (mediumi), pranuesi dhe destinacioni, si edhe një faktor jofunksional, zhurma. Kjo lëmi nuk ishte e njohur deri nga mesi i viteve '90, kur sociologët filluan ta studionin komunikimin nga perspek-

tiva psikologjike dhe të përqendrohen në faktorë të tillë, si qëndrimi, perceptimi, mbajtja e audiencës përfutuese, si dhe përfshirja e publikut në procesin e komunikimit. Shumë njerëz sot i shohin aftësitë e komunikimit në dritën komerciale dhe zakonisht shikohen ata, që janë më të mirët në botën e biznesit, duke lënë anash vlerat morale dhe sjelljen e shëndoshë. Prandaj edhe nuk duhet të habitemi, kur të shikojmë jetën e tyre private dhe familjare, nëse i shohim si njerëz të ligj e të këqinj, si njerëz të cilët tradhetojnë familjen dhe nuk ndihmojnë askënd, pa interes. Kurse Profeti Muhamed (alejhis-selam), ka thënë: "Më i miri nga ju është ai i cili është më i mirë me familjen e vet. Dhe unë jam më i miri me familjen time." (Tirmidhiu dhe Ibn Maxhe në Sahih)

Modeli i komunikimit, sipas Osgood dhe Schramit: Komunikimi paraqet një proces rrethor, i cili fokusohet në gjetjen e aktorëve kryesorë në procesin e komunikimit, ku ata shpesh përshkruhen si të barabartë dhe të njëjtë në kodimin dhe dekodimin, deshifrimin dhe interpretimin e mesazhit të komunikimit. Megjithatë, ndodh shpesh që komunikimi të jetë një proces i paekuilibruar, i cili dominohet nga individët.

Shumë nga teoritë dhe modelet perëndimore të komunikimit janë kryesisht njëkahëshe, të cilat kanë vendosur një nocion të gabuar mekanik të komunikimit, si transferimin e informacionit nga burimi aktual të marrësi pasiv. Për më tepër, akti i komunikimit shikohet si një fenomen statik i burimeve të privileguara, e jo si një proces dinamik, i cili përfshin të gjithë elementet e marrëdhënieve shoqërore.

Por qëllimi i vërtetë i komunikimit është përcjellja e mesazhit në mënyrë sa më të qartë e më të saktë të publiku. Komunikimi nuk është një proces i njëanshëm, sepse mesazhi i dërguar duhet të perceptohet nga publiku, në mënyrë që të vendoset komunikimi midis dy palëve. Këto janë bazat themelore për shkëmbimin efektiv të ideve dhe ndjenjave me të tjerët.

Studimet e fundit tregojnë se komunikuesit më të suksesshëm arrijnë të aktivizojnë të gjitha shqisat e publikut përmes dy lloj aftësish: aftësive verbale dhe joverbale. Aftësitë verbale shprehin mendimet me fjalë apo shprehje të shkruara, ndërsa aftësitë joverbale përforcojnë kuptimin e tyre; këtu përfshihen shprehjet e fytyrës, lëvizjet trupore, volumi dhe toni i zërit. Ironikisht, humultimet tregojnë se pjesa më e madhe e përmbajtjes së një mesazhi transmetohet përmes aftësive joverbale, të cilat janë përgjegjëse për përcjelljen e rreth 70% të kuptimit të mesazhit. Ndërkaq, vetëm 30% e kuptimit transmetohet nëpërmjet fjalëve. Për më tepër, nëse mesazhet verbale dhe ato joverbale janë kontradiktore, njerëzit besojnë më shumë në mesazhet joverbale. Për shembull: nëse dikush na thotë: "Gëzohem që po ju shoh", por e thotë këtë me sarkazëm, ne, në mënyrë instinktive, nuk e marrim këtë përshëndetje si diçka të hijshme. Kurse Muhamedi (alejhis-selam), siç dëshmojnë shokët e tij, kur fliste me ta, fliste aq ëmbël dhe bukur duke i parë drejt e në sy, sa

që mendonin se u drejtohej secilit prej tyre individualisht. Gjithashtu, edhe kur shprehte dashurinë për shokun e tij, tek sahabi formohej një bindje se ai ishte njeriu më i dashur për Profetin (alejhis-selam). Për shembull, kur e përcolli Omerin radijall-llahu anhu, për ta kryer Umren, e përqafoi me mallëngjim dhe i tha: *"O Omer, mos më harro në lutjet e tua!"*

Kjo ishte sjellja e Muhamedit (alejhis-selam), e cila nguliste në zemrat e sahabëve të tij dashurinë më të lartë dhe respektin për të. Muhamedi (alejhis-selam), na ka mësuar se, kur dikush flet me dikë, duhet të bisedojë për gjëra që janë të përshtatshme dhe në fushën e interesit të bashkëbiseduesit, në mënyrë që komunikimi të mos jetë i njëanshëm. Po ashtu, Muhamedi (alejhis-selam), na mësoi se, të folurit duhet të jetë ndryshe në komunikimin me të moshuarit, me fëmijët apo gratë. Përmes kësaj, ai na tregon se bashkëbiseduesit e tij i ka vlerësuar individualisht. Për shembull, me Ebu Bekrin fliste rreth luftërave, armatimit, problemeve me të cilat ballafaqohej shteti islam, kurse me Aishen bënte shaka dhe biseda, të cilat e gëzonin atë.

ARTI I HESHTJES ELOKUENTE

Njerëzit kanë nevojë për trajnime të posaçme, të cilat udhëzojnë kuptimin e gjesteve njerëzore, në të njëjtën kohë, si të dërgohen mesazhe pozitive joverbale, për të rritur mirëkuptimin reciprok dhe për të inkurajuar komunikimin efektiv. Si komunikuesi më i aftë, profeti Muhamed (alejhis-selam), gjatë gjithë kohës i kushtonte rëndësi të veçantë përcjelljes së mesazheve të qarta joverbale, madje edhe kur rrinte në heshtje. Jo rastësisht, Allahu Fuqplotë kishte zbritur ajetin kuranor: **"Ti me të vërtetë ke një karakter të lartë."** Kurse këtë e kishte vërtetuar Muhamedi (alejhis-selam), me thënien e tij: *"Më edukoi Zoti im, me një edukim të mirë."*

Profeti Muhamed (alejhis-selam), ishte i vetëdijshëm se pjesa më e madhe e traditës së tij do të transmetohej gojariht, prandaj edhe fliste qartë, duke e përsëritur çdo çështje të rëndësishme nga tri herë. Në të njëjtën kohë, ai ngrinte zërin dhe përdorte gjeste, për t'ua lehtësuar njerëzve memorizimin e fjalëve të tij, në mënyrë që ato t'ua përsërisnin të tjerëve. Ai e mbante gjithmonë trupin drejt, duke shprehur kështu besim dhe forcë. Ecte me temp, duke shprehur vendosmëri, kurse fytyra e tij ishte gjithmonë e qeshur. Ai u jepte njerëzve vëmendje të plotë, duke e kthyer të gjithë trupin, e jo vetëm kokën, në drejtimin e tyre. Kjo i bënte ata të ndiheshin të rëndësishëm dhe të vlerësuar. Kur zemërohej, ai thjesht shikonte mënjanë, duke e shprehur kështu mospëlqimin e tij. Në takime, ai nuk rezervonte ndonjë vend të veçantë për vete, por ulej kudo, duke shprehur kështu barazinë me të tjerët; kishte kontakt të drejtpërdrejtë me ta, duke treguar afrueshmëri.

E megjithatë, ne shohim që Allahu i Madhërishtëm e qortoi të Dërguarin e Tij, në një situatë të veçantë, për shkak

të komunikimit të tij joverbal, duke na dhënë kështu edhe neve një mësim të vlefshëm. Një herë, Profeti (alejhis-selam), po fliste me një grup nga elita e udhëheqëse të fiseve mekase, në përpjekje për të fituar mbështetjen e tyre. Aty vjen një i verbër, i quajtur Abdullah ibn Ummi Maktum, për të parashtruar disa pyetje. I përqendruar plotësisht tek aleatët e tij të mundshëm, Profeti (alejhis-selam), u vrenjt në fytyrë dhe e largoi shikimin nga Abdullahu, për ta kthyer sërish te udhëheqësit e fiseve. I verbri nuk e pa vrenjtjen në fytyrën e Profetit (alejhis-selam), megjithatë, Zoti e qortoi të Dërguarin e Tij, duke i thënë: **"Ai u vrenjt dhe ktheu kurrizin, kur i erdhi pranë i verbri."** (Abese,1-2)

Transmetimi i një emocioni të sinqertë nuk mund të arrihet, nëse gjuha e trupit bie ndesh me fjalët tona. Provoje vetë. Dil përpara pasqyrës dhe përpiku të thuash një "mirëmëngjes", duke e vrenjtur fytyrën. Nuk mundesh. Nëse nuk do të dëgjosh vrazhdësi në zërin tënd, atëherë duhet të buzëqeshësh. A mund ta imagjinoni se si do të kishte tingëlluar zëri i Profetit (alejhis-selam), nëse do t'i kishte folur në atë çast njeriut të verbër? I verbri do ta kishte dëgjuar bezdinë në zërin e Profetit (alejhis-selam) dhe kjo do të shkaktonte ndjenja negative tek ai, të cilat do të pengonin komunikimin efektiv. Përveç kësaj, grupi i udhëheqësve të fiseve, te të cilët ishte përqendruar Profeti (alejhis-selam), ishte aty i pranishëm dhe, sikur Profeti Muhamed t'i kishte folur keq të verbrit, ky do të ishte një mesazh negativ edhe për ta e, në këtë mënyrë, i gjithë procesi i komunikimit do të dështonte. Për shkak të mësimëve të thella që përfitoi nga kjo ngjarje, sa herë që Profeti (alejhis-selam), e takonte burrin e verbër, i buzëqeshte dhe sillej butë me të e i thoshte: *"Mirë se vjen, o ti për të cilin, më qortoi Zoti im!"* (El-Kurtubi)

Në një ngjarje tjetër, përderisa Aisheja, radijall-llahu anha, ishte duke folur për një grua, bëri shenjë me dorë për të treguar se ajo ishte shumë e shkurtër. Profeti (alejhis-selam), i tha: *"Ti ke thënë një fjalë, e cila po të përzihet me ujin e detit, sigurisht do ta njolloste atë!"* (Ebu Daudi). Profeti (alejhis-selam), e cilësoi gjestin e saj si "fjalë", dhe e paralajmëroi se ishte aq i dëmshëm, sa mund të njolloste një det të tërë.

Shpeshherë ne bëjmë shprehje të fytyrës apo gjeste në mënyrë tallëse, pa i peshuar mirë efektet e tyre shkatërruese për imazhin tonë dhe për komunikimin tonë me të tjerët. Kurse këto ngjarje nga jeta e Profetit (alejhis-selam), na mësojnë se duhet të tregojmë po aq kujdes edhe për gjuhën e trupit, sa tregojmë për gjuhën e të folurit. Mbi të gjitha, ne duhet ta bëjmë këtë gjë, sepse është Zoti, Ai që e sheh çdo veprim tonin, e pastaj edhe sepse të tjerët do të formojnë mendime dhe bindje për ne, duke u bazuar në sjelljen tonë.

Prandaj, në çdo moment duhet të përfytyrojmë se dikush po e vlerëson mënyrën se si komunikojmë me bashkëshortin apo bashkëshortin në një qendër tregtare, si e trajtojmë një të moshuar në autobus apo si sillemi me shokët tanë në rrugë. Nëse dëshiron të dukesh i mirë, ji

gjithnjë i tillë, me gjithë qenien tënde, edhe atëherë kur mendon se nuk po të sheh asnjë njeri. Në çdo kohë dhe në secilin vend. Keni parasysh se buzëqeshja dhe sjellja e mirë janë kode universale. Pra, edhe kur nuk e flisni gjuhën e dikujt, keni parasysh se fjalët janë vetëm 30 % e mjeteve që ke në dispozicion. Ju duhet të përpiqeni që tjetri të mund të "dëgjojë" mendimet tuaja dashamirëse përmes syve.

Profeti Muhamed (alejhis-selam), u dërgua te një popull që kishte oratorë të shkëlqyer, u dërgua në mesin e njerëzve, të cilët si krenari të tyren kishin elokuencën në të folur. Megjithatë, ai i shtoi një dimension të ri edhe më të thellë elokuencës, e kjo është heshtja elokuede, atëherë kur veprimet janë ato të cilat flasin. Sjellja e Profetit Muhamed ishte e njëjtë me të gjitha klasat shoqërore dhe grupet e njerëzve. Kurdo që ai kalonte pranë ndonjë fëmije, e përshëndeste atë, ua përkëdhelte kokat si një shenjë e dashurisë dhe mëshirës. Ai gjithmonë përpiquej që njerëzit t'i gëzonte gjatë bisedave që kishte me ta apo gjatë fjalimeve që mbante para tyre. Transmetohet nga Enesi, radijallahu anhu: "Nga të gjithë njerëzit,

Profeti Muhamed (alejhis-selam), ishte njeriu të cilit Allahu i kishte dhënë karakterin më të mirë. Unë kisha një vëlla të vogël, i cili quhej Umejr, të cilit sapo i kishte përfunduar periudha e pirjes së qumështit (mëkimit). Ai erdhi njëherë tek Profeti (alejhis-selam), i cili pa humbur kohë i kushtoi vëmendje të plotë fëmijës, duke biseduar me të për botën dhe problemet me të cilat ai ballafaqohej. Profeti Muhamed (alejhis-selam), e pyeti: "O Umejr, si është Nugejri?" (Nugejri ishte një shpend i vogël me të cilën ai luante)". (Hadith i saktë - Buhariu)

Profeti (alejhis-selam), ishte shembull i suksesshëm në komunikimin me njerëzit në nivel individual dhe shoqëror. Kur ai fliste, atë e bënte me zë, aq sa njerëzit të mund ta dëgjonin qartë dhe kuptueshëm, ndërsa kur dëgjuesit i bënin ndonjë pyetje, ai ua eliminonte çdo paqartësi në mënyrën më të bukur. Kur Profeti (alejhis-selam), vinte re se ndokush po bënte ndonjë gabim, ai asnjëherë nuk ia tërhiqte vërejtjen për gabimin e bërë në sy të të tjerëve, në mënyrë që ky njeri të mos ndihej i poshtëruar. Në vend të kësaj, ai zotëronte një përsosmëri dhe urtësi të jashtëzakonshme pedagogjike. Kur dëshironte ta largonte ndonjë të metë nga shoqëria, drejtohej me fjalët: "Po çfarë mendoni në lidhje me ata njerëz, që e bëjnë këtë dhe këtë?" Profeti Muhamed (alejhis-selam), për gjatë nëntë vjetëve, për sa Enesi radijall-llahu i kishte shërbyer, asnjëherë nuk e kishte qortuar, e as që i kishte thënë ndonjë fjalë, e cila do ta lëndonte atë. Kjo nuk do të thotë se Muhamedi (alejhis-selam), nuk i këshilloi njerëzit e tij. Profeti Muhamed (alejhis-selam), i ka këshilluar ata gjithsesi, por ai

largohej nga biseda e kotë dhe fjalët e panevojshme dhe kur këshillonte, e bënte atë me një ose dy fjalë.

ARTI I TË DËGJUARIT

Arti i të dëgjuarit është një pjesë integrale në procesin e komunikimit të suksesshëm. Njeriu nuk duhet të pyesë në lidhje me çdo gjë që dëgjon, duke i ndërprerë vazhdimisht fjalën folësit. Profeti Muhamed (alejhis-selam), i dëgjonte me kujdes të gjithë ata që i paraqisnin mendimet dhe dëshirat e tyre, pa marrë parasysh a ishin këta shokët e tij, gratë e tij apo jobesimtarët, që vinin ta takonin.

Profeti Muhamed (alejhis-selam), ka thënë: "Kush dëshiron të jetë i shpëtuar nga zjarri dhe të hyjë në Xhenet, le ta besojë Allahun Fuqiptotë dhe, kur ta godasë ndonjë sprovë, të besojë në Ditën e Gjykimit dhe të sillt me njerëzit, ashtu siç ka dëshirë që njerëzit të sillen me të." (Muslimi)

Kuptimi i hadithit është shumë i qartë, që njeriu duhet t'i trajtojë njerëzit me një sjellje të atillë, me të cilën do të kishte dëshirë që njerëzit ta trajtonin atë. Nëse ne i përdorim aftësitë tona për të përfutur zemrat e njerëzve dhe për të fituar dashurinë e tyre, kjo do të na sillte lumturinë dhe gëzimin më të madh.

Ne duhet të përpiqemi vazhdimisht të rregullojmë të folurit dhe fjalimet tona duke përkujtuar lutjen që bëri Musai (a.s.), kur Allahu Fuqiptotë e urdhëroi të shkonte të takohej dhe të bisedonte me Faraonin: **"Ai (Musai) tha: 'Ma zgjero (më ndihmo) gjoksintim! Dhe më lehtëso në këtë punë timen! Më zgjidh nyjen e gjuhës sime! Që ta kuptojnë fjalën time!'"** (Ta Ha, 25-28)

Eh, sikur të kishe jetuar në kohën e Muhamedit (alejhis-selam) dhe të kishe pasur mundësi të pyesësh:

Hadixhen – Me çfarë njeriu ka jetuar?

Jetimët – Kush është kujdesur për ta?

Të uriturit – Kush i ka ushqyer?

Të eturit – Kush ua largoi etjen?

Udhëtarët – Kush i ndihmoi dhe ua tregoi rrugën?

Njeriun që ecte në errësirë – Kush iu bë pishtar ndriçues?

Gruan e ve – Kush e ngushëllonte?

Të harruarit – Kush i kujtonte?

Dyert e mbyllura – Kush i hapte?

Të dëshpëruarit – Kush u sillte lumturi?

Të padëshpëruarit – Kush i pranoi në shoqëri?

Njerëzit – Cili është ai që asnjëherë nuk i ka lënduar?

Sahabët – Kë kanë dashur më shumë se veten?

Të gjithë këta do të përgjigjeshin: Ky ishte Muhamedi alejhi selam.





Morali i Pejgamberit (a.s.), ishte morali i Kuranit

Shaban Ishlek

H. Pejgamberi, sallallahu alejhi ve sellem, ishte një njeri i shumanshëm dhe me mënyrën e jetesës së tij, ka shfaqur shembuj të bukur në çdo aspekt. Me jetën e tij shembullore, ai ka vënë në pah qartësisht se si duhet të zbatohen masat që ka caktuar Allahu i Lartësuar në Kuranin Fisnik, duke i praktikuar vetë ato. Jeta e tij para profetësisë dhe jeta pas saj, si dje edhe sot, është e mbushur plot me bukuri.

H. Muhamedi, sallallahu alejhi ve sellem, është njeriu që çdo mysliman duhet të përpiqet shumë t'ia pëvetësojë moralin e etikën. Allahu i Lartmadhëruar e shpreh kështu këtë të vërtetë në një ajet fisnik:

“Në të Dërguarin e Allahut ka një shembull të mrekullueshëm për atë, që shpreson tek Allahu dhe Dita e Fundit dhe e përmend shumë Allahun.”
(el-Ahzab, 21)

Islami ka dy burime themelore: Kuranin dhe Sunetin. Këta janë dy elementë themelorë, të pandashëm prej njëri-tjetrit, si mishi me thoin. Nëse i ndajmë, atëherë nuk mund ta perceptojmë kuptimin e vërtetë të fesë.

Besimtari duhet t'i kuptojë shumë mirë dhe t'i zbatojë pa asnjë mangësi këto dy burime të Islamit, në mënyrë që të arrijë lumturinë absolute në Ahiret. Praktikata e Pejgamberit, sallallahu alejhi ve sellem, i cili kishte

moralin e Kuranit, pothuajse janë një komentim i gjallë i Kuranit Fisnik.

Të gjithë besimtarët mbartin mbi supet e tyre përgjegjësinë për t'ua prezantuar njerëzve të Dërguarin e Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, me gjithanshmërinë e tij dhe t'i bëjnë ata të përvetësojnë moralin e tij (s.a.s.), duke treguar veçoritë dhe bukuritë e epërme që ka një shoqëri, e cila formohet nga njerëzit që marrin për shembull moralin e H. Pejgamberit, sallallahu alejhi ve sellem.

Allahu i Lartësuar na ka njoftuar në Kuran se Pejgamberi, alejhis-salatu ves-selam, ka një moral shumë të lartë. Kjo e vërtetë shprehet kështu në Kuranin Fisnik:

“...Me të vërtetë, ti ke një moral shumë të lartë.”
(el-Kalem, 4)

I Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, ka njoftuar se jeta e tij është e mbushur plot me shembuj, që çdo besimtar duhet t'i praktikojë, duke thënë:

“Unë jam dërguar për të përsosur moralin e lartë.”
(Bejhakui)

Morali i lartë dhe praktikata e H. Muhamedit, sallallahu alejhi ve sellem, janë shembulli më i shkëlqyer



për besimtarët në përditshmërinë e tyre. Çdo sjellje e të Dërguarit të Allahut, alejhis-selam, është shfaqur nën mbrojtjen dhe orientimin e Allahut Teala.

I Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, i cili shfaqti shembujt më të bukur të moralit të lartë para se t'i vinte profetësia, edhe kur ia predikoi njerëzimit fenë islame, u bë shembull për të gjithë, me personalitetin e zgjedhur dhe moralin e lartë që zotëronte. Përgjatë këtyre katërmëdhjetë shekujsh, njerëzimi është përpjekur që t'i përvetësojë parimet e moralit të lartë që ai ka vendosur (s.a.s.).

Sepse morali i tij, ishte morali i Kuranit Fisnik. Kur nënën tonë Hz. Aishen, radijallahu anha, e pyetën për moralin dhe mënyrën e jetesës së të Dërguarit të Allahut, ajo u përgjigj:

"A nuk e lexoni Kuranin? Morali i tij ishte morali i Kuranit!"

Profeti, sallallahu alejhi ve sellem, i lutej Allahut:

"O Zot! Më drejto te morali më i lartë dhe më largo nga morali i keq!"²

Disa prej haditheve fisnike, që na sugjerojnë moralin e lartë të të Dërguarit të Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, janë:

"Fale atë që të bën padrejtës! Shko te ai që është zemëruar me ty! Bëji mirë atij që të ka bërë keq! Thuaj të vërtetën, sikur të jetë edhe kundër teje!"

"Ki frikë nga Allahu, kudo që të jesh! Pas një të keqeje, bëj një të mirë! Kjo e shkatërron atë. Njerëzit trajtoji me moral të lartë!"

"Silluni ndaj njerëzve me moral të lartë!"

Shembuj në lidhje me vëllazërinë, dashurinë, respektin, modestinë dhe tolerancën e të Dërguarit të Allahut, sallallahu alejhi ve sellem.

Veçoritë më kryesore të jetës së Pejgamberit (s.a.s.), përfshijnë besnikërinë, besimin, nderin, dashurinë, respektin, mirësjelljen, çiltërsinë, zgjedhjen e bukur, buzëqeshjen, gjuhën e ëmbël, tolerancën, mirëkuptimin, besën, sinqeritetin, respektin ndaj të drejtave njerëzore, mbrojtjen e privatësisë, adhurimin, ekuilibrin, ngrënien, pirjen, largimin nga ekstravaganca në veshje, pastërtinë, sistemimin, arsimimin, shkencën, dhuratat reciproke, ushqyerjen e të tjerëve, mikpritjen,

1. Muslim, 1/514 (Hadithi Nr. 746; Jyxhel, Irfan, Peygamberizin Hayati, Sh. 264, DIB Yayınları.

2. Muslim, Sahih, 1/535 (Hadithi Nr. 771). Juxhel, Irfan, a.g.e. Sh. 264.

pjesën e punës, marrjen e masave, të qëndruarit larg sjelljeve që mund të bëhen shkak për akuzim, mbrojtjen e forcimin e lidhjeve fafëfisnore, lidhjet me fqinjët, shokët dhe miqtë.

I Dërguari i Allahut, alejhis-salatu vesselam, ia ka treguar gjithmonë umetit të tij rëndësinë e moralit të lartë dhe ka thënë:

"Më i miri prej besimtarëve, është ai që ka moralin më të lartë."³

Çdo sjellje e të Dërguarit të Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, është shembulli më i mirë për ne. Tani do të përpiqemi të shpjegojmë një pjesë të moralit të tij të lartë.

NDERSHMËRIA

Njëra prej veçorive më tërheqëse në moralin e lartë të të Dërguarit të Allahut (s.a.s.), është ndershmëria e tij. Hz. Pejgamberi ishte një shembull ndershmërie. Ndershmëria ishte një cilësi që gjendej në çdo fushë të jetës së tij. Fjalët e tij përputheshin me atë çka vepronte. Ai e urdhëronte ndershmërinë dhe në të njëjtën kohë, i zbatonte ato që thoshte. Një herë, Abdullah ibn eth-Thekafij, kërkoi ta këshillonte. I Dërguari i Allahut (s.a.s.) i tha:

"Thuaj: 'I besova Allahut! Pastaj ji i qëndrueshëm!'"⁴

Këtu të bën shumë përshtypje ndershmëria, që është përmendur pas besimit ndaj Allahut dhe lidhja ndërmjet ndershmërisë e besimit ndaj Zotit. I Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, ishte njeriu më i besueshëm që ka ardhur ndonjëherë në këtë botë, megjithatë ai shpeshherë i kërkonte llogari vetes në lidhje me këtë.

I Dërguari i Allahut (s.a.s.), ka thënë:

"Mua më ka plakur sureja Hud dhe el-Vakia"⁵, sepse në suren Hud, Allahu Teala thotë:

"Prandaj qëndro i patundur në udhën e drejtë, ashtu siç je i urdhëruar. Ashtu le të veprojnë edhe besimtarët që janë me ty; e mos i kaloni kufijtë, se Ai, me të vërtetë, i sheh mirë ato që bëni ju." (Hud, 11/112.)

I Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, gjithmonë i ka sugjeruar njerëzit që të jenë të drejtë e të ndershëm, ashtu siç ishte edhe vetë. Para se të ftonte të tjerët në këtë fe, Hz. Pejgamberi (s.a.s.), u lidh vetë me të me plot sinqeritet dhe parimet e saj i praktikoi në jetën e tij.⁶ Ai ka agjëruar me ditë të tëra dhe ka falur namaz, derisa i janë enjtur këmbët. Një herë, bashkë-

3. Buhari, Edeb, 38, VII, 81; Tirmidhi, Rada, 11, III, 466, 1162; Ahmed, II, 250.

4. Muslim, Iman, 62, I, 65; Ahmed, III, 413, IV, 385.

5. Tirmidhi, Tefsir, 57, 3297, V, 402.

6. Sarëçam, Ibrahim, Hz. Peygamber'in Çağımızda Mesajları, Ankara 2000, fq. 2. Tirmidhi, Salat 304, II, 268-269.

shortja e tij Hz. Aisheja (r.a.), e pyeti:

“O i Dërguari i Allahut! Përse po e bën këtë, ndërkohë që Allahu Teala t'i ka falur të gjitha mëkatet e kaluara dhe të ardhshme?”

I Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, iu përgjigj: “A të mos jem rob falënderues?”

I Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, nuk e ka pranuar asnjëherë veten si të përgjashtuar nga përgjegjësia ose më të lartë se të tjerët. Shumë herë në Kuranin Fisnik, ai urdhërohet ta ndjekë atë që i shpallet. Në ajetin e 12-të të sures ez-Zumer, Allahu Teala thotë:

“Unë jam urdhëruar të jem i pari prej myslimanëve.” (ez-Zumer, 39/12.) Ky ajet e urdhëron të Dërguarin e Allahut (s.a.s.), të jetë prijës dhe udhëzues edhe në moral e virtyt, ashtu si në çdo çështje tjetër. Përsëri Allahu i Madhëruar në një ajet fisnik, thotë:

“(O Pejgamber!) Ne të kemi dërguar vetëm si përgëzues dhe paralajmërues. Thuaj: ‘Unë nuk kërkoj nga ju kurrfarë shpërblimi, por vetëm që, kush të dëshirojë, le të ndjekë rrugën (që e shpie) drejt Zotit.” (el-Furkan, 56-57)

I Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, i ka pranuar të mirat materiale vetëm si mjet dhe asnjëherë nuk i ka bërë ato synim. Kurrë nuk e ka preferuar luksin dhe teprimin. Ai (s.a.s.), ka jetuar një jetë të ekuilibruar dhe modeste.

E keqja më e madhe është kur një njeri mbron një mendim që nuk e beson dhe thotë atë që nuk e bën. Allahu i Lartësuar thotë në Kuranin fisnik:

“O ju që keni besuar! Përse e thoni atë që nuk e bëni? Te Allahu është shumë e urryeshme të thoni atë që nuk e veproni.” (es-Saff, 3) Pejgamberi, sallallahu alejhi ve sellem, është ai që e ka praktikuar më mirë në jetën e tij këtë urdhër hyjnor.

BESUESHMËRIA

Besueshmëria është një cilësi tjetër e rëndësishme e të Dërguarit të Allahut (s.a.s.). Besueshmëria është njëra prej cilësive të përbashkëta të të gjithë pejgamberëve. I Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, na ka treguar se ndërmjet besimit (imanit) dhe besueshmërisë ka një lidhje të fortë. Ai (s.a.s.), thotë:

*“Mysliman është ai që i bën myslimanët e tjerë të ndihen të sigurt nga gjuha dhe dora e tij. Ndërsa besimtar është ai që njerëzit i besojnë në çështjen e jetës dhe pasurisë së tyre.”*⁸ I Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, që në fëmijërinë e tij është njohur si një njeri besnik, respektues i amanetit dhe i ndershëm. Atij i patën vendosur cilësimin “el-Emin”⁹

Besueshmëria e të Dërguarit të Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, ka pasur një ndikim të madh në përhapjen e ndjeshme të Islamit. Sikur ai (s.a.s.), të mos ishte një njeri që shfaqte besim me sjelljet e tij, sigurisht se njerëzit nuk do të mbledheshin rreth tij dhe nuk do ta mbështesnin, sepse në krye të gjërave që njerëzit presin prej të tjerëve në marrëdhëniet njerëzore, vjen ndjenja e besueshmërisë. Po ashtu, është e qartë se sa rëndësi ka që myslimanët të shfaqin besueshmëri dhe siguri në shoqëri me sjelljet e fjalët e tyre.

FALJA DHE TOLERANCA

Falja dhe toleranca ishin dy cilësi të tjera të rëndësishme të të Dërguarit të Allahut, sallallahu alejhi ve sellem. Toleranca ishte ndër cilësitë më të dallueshme të Hz. Pejgamberit. I Dërguari i Allahut ishte i pari në faljen e gabimeve të njerëzve dhe në mbulimin e tyre. Ai kurrë nuk ia thyente zemrën dikujt për interesat e tij dhe nuk ia përplaste në fytyrë gabimin, por, nëse gabimi që bëhej ishte shkelje e ndonjë urdhri apo ndalesë të Allahut, atëherë patjetër që e qortonte, por gjithsesi nuk e lëndonte.

Nëse personi që bëri gabimin ishte në një grup, atëherë e qortonte pa dhënë emër. Toleranca e Hz. Pejgamberit, sallallahu alejhi ve sellem, ishte aq e gjerë, saqë nuk hiqte dorë prej saj edhe në situata shumë të vështira për t'u përballuar. Kjo ngjarje është një shembull i bukur për këtë që thamë më lart:

Një ditë, erdhi një beduin dhe e prishi abdestin në një qoshe të xhamisë. Sahabët nuk e përballuan dot këtë gjendje dhe deshën ta ndëshkojnë beduinin, por i Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, u tha që ta linin të lirë. Pastaj e thirri atë dhe i tha që prishja e abdestit në xhami nuk është një sjellje e duhur. Po ashtu, me një gjuhë të butë, i tha se xhamitë duhet të mbahen pastër, për shkak se ato janë vende ku përmendet Allahu, ku falet namazi dhe ku lexohet Kurani. Pastaj urdhëroi që



7. Buhari, Tehexhxhud, 6, II, 44; Muslim, Sifatu'l-Munafikin, 79, III, 2171.

8. Muslim, Iman, 14, I, 65.

9. Ibn Hisham, I, 336; Sarëçam, fq. 10.

të sillnin një kovë ujë e ta pastronin vendin.¹⁰

Dyshemeja e xhamisë së Pejgamberit, sallallahu alejhi ve sellem, atëherë ishte rërë. Ai (s.a.s.), na ka treguar me këtë sjellje se deri ku mund të arrijë toleranca apo, thënë ndryshe, na ka treguar përmasat e tolerancës. Ndërsa nga ana tjetër, i ka treguar të gjithë umetit se si fitohet një njeri.

Le ta sjellim këtë ngjarje në ditët e sotme. Kur radhiten cilësitë e njerëzve të devotshëm në ajetet fisnike, ndër të tjera thuhet:

“Ata i falin njerëzit...” (Al Imran, 134) Në këtë ajet është përdorur fjala “nas”, që do të thotë njerëz. Ajo është përdorur në formën absolute, pa i ndarë ata në besimtarë dhe mohues. Ky fakt na jep një mësim edhe në çështjen e gjithëpërfshirjes së faljes.

I Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, dëshiron të përhapte dashurinë ndërmjet njerëzve. Këtë e shpreh shumë qartë në këtë hadith fisnik:

“Beto hem në Allahun se nuk mund të hyni në xhenet pa u bërë besimtarë.”

Pastaj tha një shprehje, që ndikon deri në palcën e njeriut:

“Ju nuk do të besoni, deri sa ta doni njëri-tjetrin.”¹¹

Një hadith tjetër, në lidhje me çështjen që po shtjellojmë, është:

“Shembulli i besimtarëve në dashuri, në mëshirë dhe në ndihmë ndaj njëri-tjetrit, i ngjason trupit. Nëse sëmurët njëri prej organeve edhe organet e tjera ndikohen dhe shqetësohen nga pagjumësia dhe dhimbja.”¹²

Parimet që ka sjellë i Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, nuk përbëhen vetëm nga dimensionet e dashurisë dhe mëshirës, por në të njëjtën kohë, kanë përfshirë edhe drejtësinë ndaj të tjerëve dhe plotësimin e nevojave të myslimanëve. I Dërguari i Allahut, alejhis-salatu ves-selam, ka arritur ta mbjellë në zemrën e njerëzve ndihmën reciproke dhe afrimitetin ndërmjet tyre, duke thënë:

“Myslimani është vëlla i myslimanit. Nuk i bën padrejtësi dhe nuk e lë atë në dorën e të padrejtës. Kush e ndihmon një vëlla në plotësimin e nevojës, edhe Allahu e ndihmon atë në plotësimin e nevojave të tij. Kush ia

heq pikëllimin një myslimani, edhe Allahu ia heq pikëllimin atij në Ditën e Kiametit. Kush mbulon gabimin e një besimtari, edhe Allahu ia mbulon gabimin atij në Ditën e Kiametit.”¹³

I Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, e fali Vahshiun, që i vrau xhaxhain, Hz. Hamzain, radijallahu anh. Po ashtu, nuk i mallkoi, madje i fali banorët e Taifit, të cilët e keqtrajtuar kur shkoi për t'i ftuar në Islam. Në ditën e çlirimit të Mekës, i mbloodhi të gjithë. Kur i pyeti ata që i kishin bërë padrejtësi dhe tortura përgjatë njëzet e një vjetëve:

“Çfarë prisni tani prej meje?”. Ata u turpëruan prej atyre që kishin bërë. Ai njeri i madh, me një qetësi të plotë i tha popullit të Mekës:

“Asnjëri prej jush nuk do të ndëshkohet. Shkoni! Jeni të lirë.”

Attabi, që ishte njëri prej liderëve të Mekës, u tronditë kaq shumë kundrejt kësaj faljeje gjithëpërfshirëse, sa që nuk e mbajti veten, iu afrua të Dërguarit të Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, dhe i tha:

“O Muhamed! Unë Jam Attabin Esidi.” Pastaj u bë mysliman, duke thënë shehadetin. I Dërguari i Allahut, alejhis-salatu ves-selam, buzëqeshi dhe i tha:

“Ty të emëroj prefekt të Mekës.”

Në këtë mënyrë, ai (s.a.s.), emëroi si prefekt të Mekës një njeri të përbetuar në armiqësi ndaj tij deri pak kohë më parë, dhe u kthye në Medine duke ua lënë atyre amanet krahinën e çliruar.¹⁴ Kurani Fisnik, duke iu drejtuar të Dërguarit të Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, u thotë të gjithë besimtarëve:

“O Pejgamber! Ji falës, urdhëro për të mirë dhe shmangu nga të paditurit.” (el-Araf, 7/199.)

Të falësh, është me të vërtetë virtyt i lartë moral. Falja e të tjerëve, duke e ditur se je në të drejtë dhe heqja dorë nga ajo, është një vepër që mund ta bëjnë vetëm burrat e mëdhenj dhe jo çdokush, sepse njeriut i vjen shumë e rëndë të heqë dorë nga e drejta. Të gjithë këto shembuj dhe plot të tjerë, na e shpjegojnë në mënyrë të dukshme faktin se sa shumë i Dërguari i Allahut (s.a.s.), anonte nga falja.



10. Buhari, Edeb, 35, VII, 80; Muslim, Taharet, 98, I, 236; Ebu Davud, Taharet, 137, I, 264.

11. Muslim, Iman, 93, 74; Ebu Davud, Edeb, 142.V, 378; Tirmidhi, Isti'dhan I, V, 52.

12. Muslim, Birr, 17, 66. III, 1999.

13. Ebu Davud, Edeb, 46. V, 202.

14. Hamidullah, Muhammed, “Hem Rahmet ve Hem de Harp Peyamberi” (Përktheu, Jusuf Zija Kavakçë), Revista **Diyanet** (Pejgamberimiz Özel Sayısı), 93–94. Ankara 1971.

DHEMBSHURIA DHE MËSHIRA

I Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, ndjente shumë dhembshuri dhe ishte shumë i mëshirshëm. Ai ka zgjedhur gjithmonë butësinë, dhembshurinë dhe mëshirën, kundrejt urrejtjes, zemërimit dhe ashpërsisë. Kjo cilësi e tij shprehet kështu në Kuranin Fisnik:

“Në sajë të mëshirës së Allahut, u solle butësisht me ta (o Muhamed). Sikur të ishe i ashpër dhe i vrazhdë, ata do të largoheshin prej teje. Prandaj, falua atyre gabimin, kërkoi falje Allahut për ta dhe këshillohu me ata për çështje të ndryshme. Kur të vendosësh për diçka, mbështetu tek Allahu. Vërtet, Allahu i do ata që i mbështeten Atij.” (Al Imran, 159)

Ndërmjet butësisë dhe tolerancës ka një lidhje, sepse në marrëdhëniet njerëzore, toleranca i paraprin butësisë. I Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, thotë:

“Kush është i privuar nga butësia, është i privuar edhe nga mirësia.”¹⁵ Hz. Pejgamberi (s.a.s.), e kishte përvetësuar këtë cilësi të lartë etike. Kjo ngjarje që tregon Hz. Enesi, radijallahu anh, është shumë interesante:

“Po ecja bashkë me të Dërguarin e Allahut (s.a.s.). Ai kishte veshur një rrobë me jakë të ashpër e të trashë, të bërë prej cohës së Nexhranit (krahinë e Jemenit). Një arab, që jetonte në shkretëtirë, u afrua dhe e tërhoqi fort për rrobash të Dërguarin e Allahut. E tërhoqi aq fort, sa që jaka e rrobës la shenjë në qafën e tij. Pastaj i tha:

“O Muhamed! Urdhëro të më japin nga pasuria e Allahut që gjendet te ti!” I Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, u kthye nga ai, buzëqeshi dhe urdhëroi t’i jepej diçka.¹⁶ Është shumë e rëndësishme që edhe ne ta shfaqim këtë tolerancë, në mënyrë që të bëhemi shembull për njerëzit në prezantimin e fesë islame në formën më të bukur. Ata që sillen me butësi edhe kur zemërohen, i Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, në një hadith fisnik, i pranon si më të fortë se mundësit:

“I fortë nuk është ai që mund njerëzit në mundje.” Sahabët e nderuar, e pyetën:

“O i Dërguari i Allahut! Atëherë kush është i fortë?” Hz. Pejgamberi, alejhis-salatu ves-selam, u përgjigj:

“I fortë është ai që e mban veten kur zemërohet.”¹⁷

15. Muslim, Birr, 23. III, 2003.

16. Buhari, Libas, 18, VII, 40, Humus, 19, IV, 60; Muslim, Zekat, 128, 1057, I, 730–731.

17. Muslim, Birr, 30. III, 2014.

MODESTIA

Një cilësi tjetër e rëndësishme e të Dërguarit të Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, ishte modestia. Ai nuk e shikonte veten kurrë më lart se të tjerët. Atij nuk i pëlqente që njerëzit të ngriheshin në këmbë kur shkonte në ndonjë kuvend, nuk i vinte mirë të ulej në vendin kryesor ndërmjet njerëzve dhe qëndronte aty ku kishte vend të lirë.

Gjërat e tij nuk ua jepte të tjerëve për t’i mbartur dhe nuk hezitonte të hante ushqim me shërbëtorët. Në shtëpi e ndihmonte familjen, lante rrobat, qepte ato të grisurat dhe milte delet. Vetën e shikonte si një njeri të thjeshtë dhe nuk e pëlqente respektin e tepërt, ashtu siç ua bëjnë mbretërve.¹⁸ Një herë, erdhi një burrë për të folur me të. Kur burri filloi të dridhej, i Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, i tha:

“Qetësohu dhe mos u dridh! Unë nuk jam mbret. Unë jam biri i një gruaje që ka ngrënë mish të thatë prej Kurejshve.”¹⁹

I Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, nuk u mburr, por e uli kokën prej modestisë ditën e çlirimit të Mekës, edhe pse politistët patën mbajtur qëndrime të padrejta ndaj tij dhe i bënë shumë presione, derisa e detyruan ta linte Mekën.²⁰ Sjelljet e të Dërguarit të Allahut (s.a.s.), duhet të përbëjnë shembull për të gjithë myslimanët, sepse një edukatë e mirë, sjell në pah dashuri e respekt ndërmjet individëve dhe e lartëson njeriun te Allahu Teala. Hz. Pejgamberi, sallallahu alejhi ve sellem, duke na e shpjeguar këtë

gjë, në një hadith fisnik, thotë:

“Allahu e lartëson atë njeri që është modest për hir të Allahut.”²¹

Fjalën time dua ta përfundoj me këto këshilla të arta të Hz. Mevlanës:

“Ji si lum në bujari e mirësi,
Ji si diell në mëshirë e butësi,
Ji si errësirë në mbulimin e gabimeve të të tjerëve,
Ji si i vdekur në zemërim dhe ashpërsi,
Ji si dhëu në gjakftohtësi e modesti,
Ji si det në tolerancë,
Ji siç dukesh ose duku siç je!”

18. Kadi Ijaz, Ebu'l-Fadl, *esh-Shifa bi Ta'rifi Hukuki'l-Mustafa*, 132–133. Bejrut, pa datë.

19. Ibn Maxhe, Et'ime, 30. II, 1101.

20. Buti, M. Said Ramazan, *Fikhu's-Sire*, fq. 404–405. Botimi i djetë, Bejrut 1991.

21. Muslim, Birr, 69. III, 2001; Tirmidhi, Birr, 82. IV, 376; Muvatta, Sadaka, 12, II, 1000.

Kërko zotëruesin e Xhenetit

“Në të vërtetë, Allahu ka blerë nga besimtarët jetën dhe pasurinë e tyre, në këmbim të Xhenetit. Ata luftojnë në rrugën e Allahut, vrasin dhe vriten. (Ky është) premtimi i Tij i vërtetë në Teurat, Ungjill dhe Kuran. Kush e mban premtimin më shumë se Allahu? Andaj, gëzojuni kësaj shitjeje! Kjo është fitorja madhështore.” (et-Teube, 111)

Shkaku i zbritjes së këtij ajeti:

Natën e Akabes, kur shtatëdhjetë vetë prej ensarëve të nderuar, i dhanë besën të Dërguarit të Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, Abdullah bin Revaha, radijallahu anh, tha:

-O i Dërguari i Allahut! Vendos kushtin që dëshiron për Zotin dhe për veten tënde! I Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, tha:

-Për Zotin, kushti është, që ta adhuroni Atë dhe të mos i bëni shirk. Ndërsa për veten time, kushti është, që të më mbronin mua ashtu siç mbronin veten dhe pasurinë tuaj.

Ensarët e nderuar, thanë:

-Nëse e bëjmë këtë, cili është shpërblimi ynë? I Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, tha:

-Xheneti.

Ensarët e nderuar, radijallahu anhum, thanë:

-Ne ta dhamë besën. Kështu që nuk e prishim dhe nuk shfaqim mangësi në të.

Xhafer Sadik, kuddise sirruh, thotë:

“O biri i Ademit! Njihe vlerën e vetes sate, ashtu

siç ka treguar Allahu. Allahu nuk është i kënaqur që çmimi i vetes tënde të jetë diçka më poshtë se xheneti!

Asnjëherë nuk duhet ta harrojmë se blerësi është Allahu, artikulli në shitje është robi dhe çmimi është xheneti.

Duhet të dimë se xheneti është për atë që e flijon veten duke e kërkuar atë. Ky xhihad, quhet xhihadu'l-asgar.

Ai që e flijon zemrën dhe shpirtin duke kërkuar Allahun, e arrin Zotëruesin e xhenetit. Sakrifica për ta fituar Atë, quhet xhihadu'l-ekber.

Rruga e pastrimit të zemrës dhe ndryshimi i moralit nga i keq në të mirë, janë më të vështirë se lufta me armiqtë e hapur.”

Fahreddin Razi, në Tefsiru'l-Kebir, transmeton:

Shejtani debatoi me Allahun në lidhje me këtë ajet fisnik dhe tha:

-Sipas shariatit, nëse klienti blen nga shitësi një mall me mangësi, duhet t'ia kthejë atë. Ti ke blerë jetën dhe pasurinë e tyre. Jeta dhe pasuria e tyre është mall me mangësi. M'i lër mua ata me gjendjen që kanë!

Allahu Teala iu përgjigj:

-Ti nuk e di shariatin Tim, nuk e kupton drejtësinë Time dhe nuk e vlerëson mirësinë Time.

Në këtë mënyrë, djalli ra përtokë dhe u refuzua si i poshtëruar.

Trajektorja e Njeriut

Osman Sëkëxhë

Njeriu është krijesa që ka rënë në tokë nga një vend tjetër dhe është i detyruar të kthehet sërish tek vendi nga ka ardhur. Njeriu ka dalë udhës dhe udhës që ka nisur do t'i vijë fundi një ditë. E rëndësishme është që njeriu ta ketë përfunduar si duhet udhën, kur asaj t'i vijë fundi. Me fjalë të tjera, në qoftë se njeriu është përsosur gjatë këtij udhëtimi dhe kjo rrugë e shpie atë drejt përsosjes, pikërisht kjo është rruga që duhet ndjekur. Në të kundërt, ashtu siç është shprehur edhe Ismet Ozeli: "Në qoftë se të gjitha rrugët që i dalin përpara njeriut janë rrugë ku mund të ecë, atëherë ai njeri e ka humbur rrugën."

Të gjithë krijesat janë udhës dhe rruga e secilës prej tyre një ditë do të sosë. Krijuesi ka përcaktuar një rrugë të veçantë për secilën krijesë. Rruga formon trajektoren që do të ndjekë secila krijesë. Të gjithë, me përjashtim të njeriut, vazhdojnë rrugën e tyre në mënyrë instinktive në trajektoren e përcaktuar për to. Pra, të gjithë krijesat i binden Zotit të tyre. Kur vjen puna tek njeriu, kjo gjë ndryshon. Njeriu dallon nga krijesat e tjera, për shkak të intelektit dhe vullnetit që i ka dhuruar Zoti. Por në fund të fundit edhe njeriu ka dalë udhës dhe është i detyruar ta plotësojë këtë udhëtim. Me fjalë të tjera, paracaktimi (kader)

për të gjitha krijesat është i njëjtë: të kthehen aty ku e kanë filluar udhëtimin dhe të plotësojnë rrethin.

Që ta përmbushë në mënyrë të përkryer këtë udhëtim, njeriu duhet t'ia dorëzojë vullnetin e tij Krijuesit. Vullneti i Krijuesit në këtë jetë është feja islame. Në të vërtetë, Islami është feja e universit. Në kuptimin e ngushtë të fjalës, feja islame është feja e shpallur njeriut, thirrja që i bëhet njeriut që të përfshihet me vullnet brenda nënshtrimit universal. Kështu që, trajektorja e njeriut është Islami. Ndërsa Profeti është udhërrëfytyes, që përpiket ta vendosë njeriun brenda trajektores së tij.

Deri në periudhën e përgjegjësisë fetare, njeriu është si gjithë krijesat e tjera. Pra, me fjalë të tjera, ai është brenda trajektores në kuptimin ontologjik. Atëherë kur njeriu arrin forcën të ndajë të mirën nga e keqja, ai ballafaqohet edhe me problemin e shmangies prej trajektores së tij. Kështu që Profeti, në një farë kuptimi, është personi që punon fort që njeriu të qëndrojë brenda trajektores së vet. Në një hadith të Profetit thuhet: "Çdo njeri lind në natyrën e pastër islame. Më pas janë prindërit e tij, që e bëjnë atë të krishterë, hebre apo zjarrputist..." (Buhari, Xhenaiz 92, Muslim, Kader 22.) Po të lexohet me kujdes, do



të kuptohet se në hadith nuk përdoret shprehja e *bëjnë mysliman*, sepse, të jesh në përputhje me natyrën njerëzore, do të thotë të vish në këtë botë si mysliman. Pra, kur njeriu nis për udhë, Allahu e lë atë pikërisht në drejtimin e duhur për të vazhduar udhën.

Të gjitha krijesat janë në paqe me Allahun pa kushte dhe pa diskutim. Pikërisht këtë paqe tregon në çdo sekond edhe harmonia dhe përputhshmëria e madhe që ekziston në gjithësi. Njeriu është krijesa e vetme, që mund ta vërë në rrezik këtë paqe dhe këtë harmoni që ekziston në gjithësi. **“Ata të cilët shkelin besën e Allahut, pasi e patën dhënë, ndërprejnë atë që ka urdhëruar Allahu për ta mbajtur lidhur dhe bëjnë ngatërresa në Tokë; ata janë njëmend të shkatërruar.”** (Bekare, 27) **Shkatërrimi në tokë dhe në det është shfaqur si pasojë e punëve të këqija të njerëzve, kështu që (Allahu) do t'i bëjë “të shijojnë” pjesë nga ajo që kanë punuar, me qëllim që të kthehen** (në përmirësim). (Rum, 41) Në qoftë se njeriu dëshiron të përfshihet në këtë paqe universale si një anëtar i paqes, duhet të pranojë Islam, në mënyrë që të këndojë së bashku me korin e krijesave që i këndojnë paqes universale. Kjo do të thotë që feja islame është paqe. Kjo do të thotë që, kur njeriu bëhet mysliman, nënshkruan me Allahun “marrëveshjen e paqes”. Në këtë kuptim edhe Profeti është ambasadori i paqes, i ngarkuar me detyrën që të vendosë paqen universale.

Universi funksionon sipas ligjeve të caktuara. **“Sunduesi i qiejve dhe i Tokës, i Cili nuk ka bir e nuk ka ortak në pushtet; i Cili ka krijuar çdo gjë dhe e ka rregulluar si duhet!”** (Furkan, 2) Kurani i ka quajtur sunetullah këto ligje universale. Çdo krijesë duhet të veprojë në përputhje me ligjet fiziologjike dhe biologjike. **“I tillë ka qenë ligji i Allahut edhe më parë e ti kurrë nuk do të gjesh ndryshime në ligjin e Allahut.”** (Feth, 23) **“Ky ishte ligji Ynë për të dërguarit e ardhur para teje, kështu që edhe ti nuk do të gjesh shmangie nga ligji Ynë.”** (Isrâ, 77) Nënshtrimi i tyre arrihet nëpërmjet këtyre ligjeve. Pra, në një kuptim, ata janë myslimanë të bindur. Njeriu bëhet mysliman me vullnetin e tij, duke u përfshirë

në këto ligje, që mund të quhen përcaktim (kader) universal.

Liria e njeriut duhet vlerësuar në këtë kontekst. Peshku në det, shqiponja në qiell dhe fara e bimës në tokë janë të lira. Në qoftë se peshku kërkon lirinë e tij përtej detit dhe del në tokë, kjo është fatkeqësi për të. Prandaj, rruga që e shpie njeriun tek takimi me Zotin, është rruga që e bën të lirë atë, që e ruan atë në gjendjen që është krijuar, pa e këputur lidhjen mes së kaluarës dhe së ardhmes së tij, duke e ruajtur të dëlirë në natyrë. Të gjitha krijesat janë të lira në shtëpinë dhe në vendlindjen e vet. Shtëpia dhe vendlindja e njeriut është feja islame.

Feja është një lidhje dhe urë... **“Të gjithë mbahuni fort për litarin e Allahut (Kuranin) dhe mos u përçani...”** (Al-i Imran:103.) Islami është litari dhe ura që e kalon njeriun në gjendje të sigurt prej lindjes drejt vdekjes, pa e marrë me vete rrjedha që quhet botë. Njeriu do të kthehet tek Ai në fund fare. Pra, rrethi do të mbyllet. Problemi është se si do të përfundojë ky udhëtim. Me vetëdijen e shprehur aq mirë nga poeti me fjalët: “Mos ma zgjat më shumë syrgjynosjen time në këtë botë” dhe duke thënë fjalët: “E kush flet më bukur se ai që thotë: **“Unë, me të vërtetë jam mysliman.”** (Fusilet, 33) apo i penduar duke thënë fjalët: **“Më mirë të kisha qenë dhé sesa njeri”**, mund të jesh në udhën e drejtë. Fjalët: **“Na udhëzo në rrugën e drejtë”** në një farë kuptimi janë lutja e dëshirës dhe përpjekjes për të qenë udhëtari i kësaj udhe.

Me fjalë të tjera, kjo lutje nënkupton: “O Zot! Unë jam nisur udhës për tek Ti, prandaj më mundëso një udhëtim të lehtë”. Nuk ka asnjë dyshim se ky udhëtim është i vështirë, por udhëtari e di se ky udhëtim ka për të përfunduar një ditë dhe ai do të jetë i lumtur kur ta ketë përfunduar atë. Prandaj, udhëtari i kësaj udhe nuk mund të ankohet për udhëtimin e tij. E vetmja frikë është se mos del nga rruga e drejtë. Të dalësh nga rruga e drejtë, do të thotë të bëhesh njëri nga ata që janë **“magdubi alejhim...”**.

Feja islame është feja e pyetjes: “A nuk jam Unë Zoti juaj?” Islam është emri i respektimit të Besës së Madhe. Të hysh në Islam, do të thotë të jesh besnik. Të hysh në Islam, do të thotë të hysh në rrugën e drejtë

“O Zot!
Unë jam nisur
udhës për tek Ti,
prandaj më mundëso
një udhëtim
të lehtë”.

dhe të vish në vete. "Islami nuk bën gjë tjetër, përveç se i kujton njerëzimit dëshminë e parë që ai ka bërë ndaj Zotit. Hyrja në Islam do të thotë kujtesë dhe kthim në origjinë." Nuk ka dyshim se njeriu nuk është i vetëmjaftueshëm. Asnjë ideologji dhe besim tjetër përveç Islamit nuk e vë njeriun në paqe me veten e tij dhe me Allahun. Për këtë arsye, çdo gjë veç Islamit do të thotë shmangie nga trajektorja, tëhuajësim dhe largim nga thelbi. **"Kush kërkon tjetër fe përveç Islamit, nuk do t'i pranohet dhe ai në botën tjetër do të jetë i humbur."** (Al Imran, 85) Feja islame është rruga organike dhe e natyrshme e njeriut. Çdo rrugë tjetër veç Islamit, është joorganike, me hormone artificiale dhe e rreme.

Sistemi islam i besimit shprehet me konceptin e monoteizmit (tevhid). Monoteizëm do të thotë bashkim dhe unifikim. Pra, në kontekstin e njësisë së Krijuesit njeriu duhet të përfshihet në këngën e vetme të përlulesisë ndaj Zotit që këndon e gjithë gjithësia dhe këtë duhet ta bëjë në mënyrë të natyrshme dhe me vullnetin e tij.

Në çdo periudhë të historisë kanë ndodhur shmangie nga natyra e pastër njerëzore, por në kohët tona moderne shmangia është shndërruar në një mosbindje sistematike. Në një farë kuptimi, njeriu modern ka dalë nga trajektorja e vet dhe e ka braktisur vendin e tij. E ka braktisur shtëpinë e tij. Pikëpamja moderne e ka nxjerrë njeriun nga rruga dhe e ka bërë atë të huaj me veten e tij. Ajo i ka hapur luftë çdo gjëje që mundëson lidhjen me të vërtetën absolute. Ajo e ka mashtruar njeriun duke e bindur se ai është i zoti i vetes dhe e ka reduktuar jetën vetëm në këtë botë. Ajo u bënte thirrje njerëzve se do t'u krijonte parajsën në këtë botë, por ngado që ka kaluar, ka sjellë shkatërrimin e jetës. Rrugët janë shtuar dhe numri i madh i tyre ka bërë që edhe njeriu të humbasë rrugën e drejtë. Sasia e madhe do të thotë shpërndarje, copëtim dhe arratisje nga vetja. Të bëhesh si gjithë të tjerët. Ai fenomen që quhet globalizim, në fakt nuk është gjë tjetër përveç se procesi ku të gjithë individët unifikohen në një prototip. Njeriu tani nuk sheh më nga qiejt dhe nga horizontet, por sheh vetëm mishin dhe barin. Ajo që është në qendër të vëmendjes sonë, në të vërtetë vlen vetëm për të pajisur njeriun në rrugën e tij.

Po ne myslimanët, ku jemi dhe çfarë shohim? A është rruga jonë rruga e të nënshtruarve ndaj Zotit, ashtu siç e ka edhe emrin feja jonë, apo është rruga që na shpie në rrugica pa krye? Çfarë mendimi keni ju në lidhje me këtë çështje?

Muhamad

trëndafil me aro

Krijuesi i plotfuqishëm i nesh më së miri fshehtësitë e krijesave. Allahu i Madhërishëm është Krijues, ndërsa njeriu krijesë. Për këtë, është e kuptueshme për ne kjo e vërtetë kuranore:

"Është e vërtetë se njeriu është i prirur të jetë i padurueshëm. Kur e godet ndonjë e keqe, ai ankohet së tepërmi. Ndërkaq, kur e gjen e mira, ai bëhet tepër koprrac. Përveç atyre që falen, të cilët janë të rregullt në faljen e namazit të tyre." (El Mearixh, 19-23)

Këtu na ofrohen dy të vërteta. E para negative, e cila njeriu e orienton në humbje dhe e dyta, pozitive, e cila e orienton drejt qëllimit të lartë - sublim.

Zgjedhja është jona: ose të mbesim në gjendjen e pashpresë të njeriut me shpirt të vogël, të cilit kur i ndodh e keqja, dëshpërohet, bie në depresion, ndërsa në rehati, bëhet arrogant, ose të bëhemi njerëz që strehohen, prej zhurmës së madhe, në qetësinë e namazit, e të cilët te mirësia shohin obligimin për të qenë në shërbim dhe ndihmë të njerëzve. Ata e dinë se të gjitha rrugët udhëzojnë drejt Burimit, aty ku çdo gjë kthehet dhe aty ku është shpëtimi dhe lumturia e përhershme. Ky është njeriu i cili në çdo moment dhe në çdo vend dëshmon të vërtetën.

Feja kultivon dhe formëson njeriun siç kultivohet bima. Shartimi i njeriut bëhet me Kuran, i cili e fisnikëron njeriun, dhe i jep frytet e dëshiruara: modestinë, mirësinë, përgjegjësinë, nderin, besnikërinë dhe sinqeritetin.

A ka sot në "tregun" moral kërkesa më të mëdha se këto fryte? A ka diçka më të rëndësishme në këtë botë se sa edukimi i njeriut? A ka gjë më të rëndësishme në këtë planet se shpëtimi i jetës së njeriut? A ka mesazh më të shenjtë për ne se mesazhi i Kuranit? A ka më të afërt dhe më të dashur për ne se Pejgamberi (s.a.v.s.)?

Është fare e qartë se ata që përsëri shfaqen në skenë me karikaturat ndaj Profetit Muhamed (a.s.) dhe lajmërojnë paraqitjen e një filmi të shëmtuar në lidhje me Kuranin (a.sh.), nuk kuptojnë dot se për ne nuk ka mesazh më të shenjtë se mesazhi kuranor, si dhe nuk ka dashuri më të madhe në zemrat tona, se sa dashuria për më të Dashurin e Allahut (a.s.).

Në fakt, përpjekjet e tyre për të na larguar nga Pejgamberi ynë, e ndezin edhe më fuqishëm dashurinë tonë ndaj Tij (a.s.).

Myslimanët të cilët edhe pa e parë, e duan kaq shumë Muhamedin (a.s.), të cilin aq shumë e respektojnë sa nuk ia gdhendin atij lapidarin, aq shumë e ndjejnë, sa nuk ia vizatojnë atij fytyrën, aq shumë e pasojnë, sa nuk ia valëvitin atij imazhin. Dhe kjo, sepse besimtarët e vërtetë e bartin

Prim. dr. med. sc Ali F. Iljazi

Medi (a.s.) më të përherëshme



Hazreti Muhamedin (a.s.) në zemrat, frymëmarrjet dhe në jetët e tyre të përditshme pa ia "shitur" atë reklamave të kësaj dynjaje.

Ata, të cilët me urrejtjen e tyre ndaj Kuranit dhe Pejgamberit (a.s.), dëshirojnë t'i lëndojnë myslimanët, harrojnë se drita e Islamit mënjanoi prej tyre errësirën, që dhurata e besnikërisë i ruan ata nga qëllimet e ulëta, që fjala e mirë i liron nga vargonjtë e iluzioneve, që emri i Muhamedit (a.s.), i fuqizon në rrugën e shërimit moral. Gjithashtu, ata harrojnë se myslimanët e dinë që nuk ka dallim mes Ebu Xhehlit të vjetër dhe të riut, ai i cili u përpoq ta ndalojë Muhamedin (a.s.), ta falte namazin, të cilin zilia ia erri sytë dhe nuk e la të shihte të vërtetën. A thua edhe Ebu Xhehlët e rinj mendojnë se Allahu (xh.sh.), nuk i sheh veprimet e tyre?

Mirëpo Allahu i Madhërisëm sheh çdo gjë. Kur dëgjojmë se Ebu Xhehli i ri në Hollandë, Danimarkë e gjetiu, lajmëron për karikaturat dhe përralla të tjera si këto, besimarëve u kujtohen fjalët e ajetit fisnik:

"E s'ka dyshim se janë ata, të cilët e fyejnë Allahun dhe të dërguarin e Tij, ata i ka mallkuar Allahu në Dynja e në Ahiret dhe për ta ka përgatitur një dënim të dhembshëm." (El Ahzab, 57)

Të mos harrojmë se ai që fyen ndjenjat e tjetrit, tregon dobësinë e tij shpirtërore. Islami është begati, sikurse begatia e Diellit, ngroh dhe ndriçon të gjithë ata që e duan, por edhe ata që nuk arrijnë ta duan.

Sa bukur e fuqizon këtë dritë të Islamit, Allahu (xh.sh.), në Kuranin fisnik:

"Ata dëshirojnë të fkin dritën e Allahut me gojën e tyre, por Allahu e përsos Dritën e Vet, edhe nëse (këtë gjë) e urrejnë jobsimtarët." (Es Saff, 8)

Kjo zhurmë që po përsëritet rreth nesh, vetëm na i mpreh të gjitha shqisat tona për të qenë më vigjilentë, për të parë e dëgjuar më mirë, dhe për të ndjerë thellësisht atë që duhet ndjerë për të mirën e fesë dhe atdheut tonë.

Të mos harrojmë se veshi ynë duhet të dëgjojë mesazhin hyjnor, në të cilin është shpëtimi ynë, por duhet të jetë i vëmendshëm edhe ndaj nevojave të njerëzve, ku fshihet sukcesi ynë në këtë botë.

Para nesh është muaji festimit të ditëlindjes së Pejgamberit tonë të dashur (s.a.v.s.), më fisnikun e tërë pejgamberëve, mëshirën e çdo bote...

Sahabët patën nderin të flisnin, të bisedonin, të udhëtonin, të faleshin, me krijesën më të mirë të kozmosit... Gurët patën fatin t'i jepnin selam atij... Askujt ushqimi nuk i ka bërë tesbih

si atij... Askujt veç tij nuk iu nda Hëna përgjysmë... Për askënd nuk qau trangu i palmës, përveç se për të dashurin tonë, të lavdëruarin e Allahut.

Dora e bekuar e lëmoi dhe trangu u qetësua, Pejgamberi (s.a.v.s.), i tha: "Zgjidh njëren prej dy gëzimeve: të bëhesh pemë e frytshme në Dynja apo pemë e përjetshme Xheneti".

Trangu zgjodhi gëzimin e dytë dhe Pejgamberi (s.a.v.s.), ia premtoi tri herë. Pastaj, i Dërguari (a.s.), u tha sahabëve: "Pasha Atë, në dorën e të Cilit është shpirti im, sikur të mos e qetësoja trangun, ai do të qante deri në Ditën e Gjykimit prej mallëngjimit për mua."

Kur trangu qau për Muhamedin (a.s.), po ne, sa lot derdhim për Pejgamberin tonë (a.s.)? Allahu i Madhërisëm i njehsoftë përjetimet tona me ato të palmës dhe na bashkoftë me të mirët nën flamurin e tij.

Le ta ripërtërijmë besën e dhënë, Allahut (xh.sh.) dhe Muhamedit (a.s.), le ta mbrojmë me dinjitet dhe dashuri të thellë tërë veprën e tij madhështore, sakrificat që ka bërë dhe do të bëjë për ne. Le të jemi më të bashkuar në pasimin e rrugës dhe veprës së tij, të jemi të edukuar ndaj prindërve tanë, fëmijëve tanë. Të mos harrojmë se jemi vëllezër e motra në besim dhe bashkudhëtarë në jetë që duam paqen dhe mirëqenien në botë.

Ne nuk jemi të dehur me urrejtje, nuk jemi të magjepsur me zullum dhe nuk jemi të veshur me hakun e huaj!

O Zot i Plotfuqishëm, na forco në qëllimin tonë për të qenë të bindur ndaj Teje dhe të dëgjueshëm ndaj të Dërguarit Tënd!

O Zot i Gjithëdijshëm, na mëso të dallojmë qartë të mirën nga e keqja!

O Allah, përhapna aromën e trëndafilshites së më të Dashurit Tënd!

AMIN



Prof. dr. M. Faruk Bajraktar

Për dashurinë ndaj fëmijëve

Mesazhe nga Pejgmaberi (a.s.)

Dashuria shpreh të gjitha ndjenjat e bukura që lidhin ngushtë njerëzit me njëri-tjetrin. Dashuria është një ndjenjë që vazhdon gjithë jetën dhe që ka nevojë të ushqehet vazhdimisht. Dashuria për prindërit, fëmijët, vëllezërit, bashkëshorten, shokun, atdheun dhe njeriun është pasqyrimi në forma të ndryshme i kësaj ndjenje universale. Dhembshuria, interesi, vlerësimi, mirëkuptimi, toleranca, respekti, dashamirësia, mëshira, pjesëmarrja, pëlqimi, përkëdhelja, buzëqeshja, fjala e bukur, keqardhja, simpatia, shqetësimi, të gjitha këto janë produkte të dashurisë.

Sipas psikologëve, për njeriun shprehja e dashurisë ndaj tjetrit është nevojë emotive e gradës së parë. Njeriu e fiton aftësinë për të dashur, së pari duke u dashur nga të tjerët. Para se të dojë, ai mëson të duhet. Fjala e urtë: "Nëse ti do fëmijën edhe ai do të dojë fëmijën e vet", e shpreh shumë bukur këtë fakt.

Nëse një njeri në fëmijëri nuk është ushqyer mjaftueshëm me dashuri, është shumë e vështirë që të formojë një personalitet të ekuilibruar dhe akoma më e vështirë, të zhvillojë ndjenjën e dashurisë për të tjerët. Individu nuk dëshiron ta ndajë me të tjerët atë që nuk e ka mjaftueshëm.

Dashuria dhe respekti mësohen përmes imitimit dhe modelit të prindërve. Fëmija që respektohet dhe ushqehet me dashuri, bëhet i lumtur. Krejt natyrshëm i zhvillohet ndjenja e dashurisë dhe respektit për të tjerët, arrin të krijojë marrëdhënie të mira me mjedisin që e rrethon. Përderisa veprimi ka më ndikim se fjala, atëherë, në vend që fëmijëve t'u jepen këshilla, është më mirë të qenit model dhe shembull në sjellje. Fëmija mëson dhe zbaton atë që shikon dhe jo atë që dëgjon. Prindërit që flasin bukur, që buzëqeshin dhe krijojnë një mjedis të lumtur familjar, në të njëjtën kohë ia mësojnë edhe fëmijës së tyre këtë.

Dihet se komunikimi fizik është një rrugë për të transmetuar dashurinë. Shumë kërkime të bëra mbi zhvillimin e fëmijës kanë arritur në këtë përfundim.

Fëmijët që përkëdhelen, përqafohen dhe puthen, zhvillojnë një sistem më të shëndoshë ndjenjash

në raport me fëmijët që kanë qenë të privuar për një kohë të gjatë nga ky komunikim. Shqisa e prekjes, ndryshe nga katër shqisat e tjera, nuk është e kufizuar vetëm në një pjesë të trupit. Në çdo pjesë të trupit tonë janë vendosur minisensorë, të cilët perceptojnë prekjen. Kur ndodh prekja, sensorët që ndodhen nën lëkurë i dërgojnë sinjale trurit, i cili i percepton si përshtypje dashurie, kënaqësie, urrejtje apo dhimbjeje.

Një komunikim fizik me dhembshuri shpreh dashurinë ndaj fëmijës dhe e transmeton në mënyrë bindëse dashurinë ndaj tij. Fjalët që përdorim në komunikimin me fëmijën mund të shprehin shumë, por kontakti fizik i jep atij perceptim më të plotë në lidhje me vlerësimin që i bëjmë ne me fjalë.

Për të treguar dashurinë ndaj fëmijëve, prindërit marrin lodra për ta, por loja me lodra është tjetër. Prindërit, veçanërisht kur këtë ua kërkojnë fëmijët, duhet ta vendosin veten në vend të lodrave, duke luajtur me ta.

Për nga natyra, njeriu dëshiron të vlerësohet, të promovohet, që në fëmijëri kërkon të përqafohet. Komunikimi që arrihet përmes përqafimit, puthjes dhe përkëdheljes luan një rol të rëndësishëm në plotësimin e nevojave të trupit. Disa kërkime shkencore të bëra mbi individët e prekur nga sëmundjet psikomatike, kanë zbuluar se shkaku kryesor është pamjaftueshmëria e përqafimeve, puthjeve dhe përkëdheljeve.

Dimë që parimi themelor në komunikim është vlerësimi dhe pranimi. Prandaj, pranimi i fëmijëve siç janë ndikon pozitivisht në krijimin e marrëdhënieve të shëndosha. Të pranosh fëmijën siç është, do të thotë ta duash me të vërtetë atë. Kur fëmija e shikon që pranohet, ndjen se vlerësohet dhe duhet. Fëmija që ndjen mungesë dashurie, e ndjen veten të pamjaftueshëm dhe të pavlefshëm.

Pejgamberi (a.s.), i cili i donte shumë fëmijët, së pari çrrënjosi dallimin që ekzistonte midis vajzës e djalit dhe urdhëroi që fëmijët të trajtoheshin si të barabartë. (Muslim, Hibat, 13.) "Nuk është prej nesh

Fëmijët që përkëdhelen, përqafohen dhe puthen, zhvillojnë një sistem më të shëndoshë ndjenjash në raport me fëmijët që kanë qenë të privuar për një kohë të gjatë nga ky komunikim.

ai që nuk do të vegjlit ...” (Edebul-Mufred, I, 366.) Në këtë mënyrë, Pejgamberi (a.s.), vuri dashurinë në qendër të edukimit të fëmijës. Librat e hadithit dhe biografisë së Pejgamberit (a.s.), janë të mbushur plot me shembuj të dashurisë, mëshirës dhe interesimit që ka treguar Pejgamberi (a.s.), ndaj fëmijëve. Më poshtë do të shikojmë disa modele sjelljeje, që shprehin dashurinë e Pejgamberit (a.s.), për fëmijët.

PEJGAMBERI (A.S.), I PËRQAFONTE DHE I PUTHTE FËMIJËT

Puthja dhe përqaftimi janë dy rrugët kryesore për të treguar dashurinë për fëmijët. Tregon Enes ibn Maliku: “Nuk kam parë njeri më të dhembshur ndaj familjes se Pejgamberi (a.s.). Kur Ibrahim, djali i Pejgamberit (a.s.), qëndronte pranë mëndeshës, e cila jetonte në një lagje periferike të Medinës dhe bashkëshorti i saj punonte si kovaç, Pejgamberi (a.s.), na merrte ne dhe shkonte për të shikuar djalin. Kur arrinte në shtëpi, e merrte në prehër djalin, e përqaftonte, e puthte, i nuhaste aromën e këndshme dhe pastaj kthehej në shtëpi.” (Buhari, Edeb, 18; Muslim, Fedail, 63).

Një hadith tjetër, që tregon dashurinë dhe dhembshurinë e Pejgamberit (a.s.), për fëmijët është rasti i vdekjes së Ibrahimit, në moshë të njomë. Pejgamberi (a.s.), e mori në kraharor djalin e tij, Ibrahimin, i cili ishte duke dhënë shpirt dhe e puthi në ballë me sy të përplotur. Përballë kësaj gjendjeje, Abdurrahman ibn Auf i tha Pejgamberit (a.s.): “Edhe ju qani?” Pejgamberi (a.s.), u përgjigj: “Këto janë lot mëshire, syri qan dhe zemra vajton, kurse gjuha jonë nuk flet gjë tjetër, përveç asaj që Allahu është i kënaqur me të.” Pastaj tha: “O Ibrahim! Ne jemi të mërzhitur për largimin tënd.” (Buhari, Xhenaiz, 44.)

Pejgamberi (a.s.), shprehej për dy nipat e Tij, Hasanin dhe Husejin: “Dy nipat e mi janë si dy lule që i puth dhe prej tyre marr erë të këndshme.” (Buhari, Edeb, 18.) Një herë, Pejgamberi (a.s.), puthi nipin e tij Hasanin. Një sahab, me emrin el-Akra, kur pa këtë gjest të Pejgamberit (a.s.), i tha: “Unë kam dhjetë fëmijë dhe asnjërin prej tyre nuk e kam puthur.” Pejgamberi (a.s.), u kthye nga ai dhe i tha: “Kush nuk mëshiron, nuk mëshirohet.” (Buhari, Edeb, 18; Muslim, Fedail, 65; Ebu Davud, Edeb, 145; Tirmidhi, Birr, 12.)

Aishja (r.a.), tregon se një ditë erdhi te Pejgamberi një beduin dhe i tha: “A i puthni ju fëmijët, sepse ne nuk i puthim e as i përkëdhelim fëmijët tanë.” Pejgamberi (a.s.), i tha: “Çfarë mund të bëj unë për ty, kur

Allahu ta ka shkukur mëshirën dhe dhembshurinë nga zemra?” (Buhari, Edeb, 18.)

PEJGAMBERI (A.S.), I PËRKËDHËLTE FËMIJËT

Një nga fëmijët e sahabëve, Xhabir ibn Semure, tregon: “Një ditë fala namazin e drekës me Pejgamberin (a.s.). Pastaj Pejgamberi (a.s.), u nis drejt shtëpisë e unë shkova me të. Rrugës takuam disa fëmijë. Pejgamberi (a.s.), filloi t’u përkëdhelte faqen të gjithëve me radhë. Edhe mua më përkëdheli faqen. Në dorën e Tij ndjeva një freski dhe aromë të këndshme, sikur dorën e nxirrte nga një shishe me parfum trëndafili ...” (Muslim, Fedail, 80.)

Said ibn Yezid tregon:

“Më mori tezja dhe më dërgoi pranë Pejgamberit (a.s.). Pejgamberi (a.s.), më përkëdheli kokën dhe u lut për mua. Pastaj qëndrova pas Tij dhe pashë midis shpatullave vulën e profetësisë. (Buhari, Daavat, 30.)

PEJGAMBERI (A.S.), INTERSOHEJ DHE KUJDESEJ PËR FËMIJËT

Ummu Halid tregon: “Në fëmijëri, shkova së bashku me babain tek Pejgamberi (a.s.), ku na priti me mirëseardhje. Unë fillova të luaja me Profetin. Babai, pasi më ndaloi, më qortoi për këtë. Në këtë çast ndërhyri Pejgamberi (a.s.), duke i thënë: “Lëre rehat djalin.” Pastaj u lut tri herë: “Jetë të gjatë...” (Buhari, Edeb,



17; Ebu Davud, Libas, 2.)

PEJGAMBERI (A.S.), BËNTE SHAKA ME FËMIJËT

Fëmijët, me të cilët më së shumti bënte shaka Pejgamberi (a.s.), ishin nipat, Hasani dhe Husejni. Xhabiri (r.a.), tregon se një ditë Pejgamberi (a.s.), i kishte hipur mbi kurriz nipat, Hasanin dhe Husejin dhe ashtu me ta mbi kurriz u thoshte: *“Sa e mirë deveja juaj dhe sa grahës të mirë jeni ju.”* (Tirmidhi, Menakib, 31)

Kurse një herë, kishte marrë ujë dhe kishte spërkatur Mahmud ibn Rebian, që atëherë ishte pesë vjeç. (Buhari, İlm, 18, Daavat, 30-31) Pejgamberi (a.s.), shpesh bënte shaka me fëmijët.

PEJGAMBERI (A.S.), VIZITONTE FËMIJËT E SËMURË

Pejgamberi (a.s.), kishte shkuar për të vizituar djalin e vajzës së tij Zejnepe. Djali i vogël ishte në agoni, kurse Pejgamberi (a.s.), qante për të, duke thënë: *“Këta lot janë mëshirë, të cilët Allahu i vendos në zemrat e njerëzve që do.”* (Buhari, Merda ve't-Tib, 9; dhe Buhari, Xhenaiz, 79.)

I PËRSHËNDESTE FËMIJËT

Enesi (r.a.), tregon: *“Kur isha duke luajtur me fëmijët, erdhi Pejgamberi (a.s.) dhe na përshëndeti”* (Muslim, Sahabe, 33.)

Enes ibn Maliku një herë shkoi pranë fëmijëve dhe, pasi u dha selam, tha: *“Kështu i përshëndeste Pejgamberi (a.s.), fëmijët.”* (Buhari, İsti'zan, 15; Muslim, Selâm, 5; Ebu Davud, Edeb, 136; Tirmizi, İsti'zan, 8; İbn Maxhee, Edeb, 14.)

Përshëndetja e fëmijëve nga ana e Pejgamberit (a.s.), tregon vlerësimin që u bënte atyre dhe në të njëjtën kohë, dëshirën e tij për t'u mësuar atyre edukatën islame. Përshëndetja është parimi bazë i komunikimit.

NUK LEJONTE TË BËHESHIN DALLIME NDËRMJET FËMIJËVE

Pejgamberi (a.s.), ka urdhëruar trajtim të barabar-të ndaj fëmijëve, (Muslim, Hibat, 13.). Në bërjen e dhuratave i ka këshilluar prindërit të jenë të drejtë. (Buhari, Hibe, 9.)

PEJGAMBERI (A.S.), LUANTE ME FËMIJËT

Pejgamberi (a.s.), siç ka luajtur vetë, i nxiste edhe besimtarët të luanin me fëmijët. Pejgamberi (a.s.), kur e shikonte Hasanin në rrugë duke luajtur, nuk e pengonte nga loja.

Ebu Katade tregon: *“Një ditë, Pejgamberi (a.s.), erdhi tek ne. Në krah kishte Usamen, djalin e vajzës së tij Zejnebe. Pejgamberi (a.s.), e fali namazin me të në krahë. Kur binte në ruku, e vendoste në tokë. Kur ngrihej nga rukuja, e merrte përsëri në krahë.”* (Buhari, Edeb, 18; Salat, 106; Muslim, Mesaxhid, 41; Ebu Davud, Salat, 169.)

Pejgamberi (a.s.), urdhëron: *“Kush ka fëmijë, të luajë dhe të argëtohet me ta.”* Përmes këtij hadithi, Pejgamberi (a.s.), u kujton familjeve interesimin dhe përgjegjësinë që duhet të kenë për fëmijët.

Parimet që ka sjellë dhe zbatuar Pejgamberi (a.s.), përputhen plotësisht me parimet e zbuluara nga kërkimet në fushën e edukimit dhe zhvillimit të fëmijëve. Pika mbi të cilën duhet përqendruar, është rëndësia e dashurisë dhe vlerësimit në zhvillimin emotiv të fëmijës. Nëse lulja nuk ujitet, thahet, nëse ujitet tepër, kalbet. Nëse dëshirojmë të na respektojnë fëmijët, që brezat e ardhshëm të jenë të dashur e të suksesshëm, atëherë t'i ushqejmë dhe edukojmë me dashuri, respekt dhe njohuri. Të mos harrojmë që dashuria që merr fëmija nga familja, është një faktor i rëndësishëm në suksesin e fëmijës. Fëmijëve t'u flasim më shumë për Pejgamberin (a.s.), në mënyrë që ta njohin dhe ta duan atë.



Respekti është si një Kandil

Nesllhan Nur Turk

Në pjatën e një *njeriu të Zotit* ndodheshin tre ullinj. I pari tha:

- Sa i shëmtuar që jam! Kush më ha mua? Kam një fytyrë të zezë katran. E mbi të gjitha, jam edhe i athët dhe bërthamën e kam shumë të madhe.

Ulliri i dytë tha:

- Eh, për çfarë shqetësohesh edhe ti! Unë nuk kam as tul e as bërthamë normale. As piruni nuk ngulet tek unë, jam një gjë e thatë.

Ulliri i tretë tha:

- Unë e kam edhe fytyrën edhe bërthamën të bukur. Kam shije të mirë, jam krijuar i veçantë. Kam një respekt të plotë për veten time, sepse ai që më krijoi është Allahu. Mos më shihni ashtu, thoni "Mashallah!".

Nërkohë, vjen *njeriu i Zotit*, u hedh një sy ullinjve me një vështrim plot urtësi. Duke buzëqeshur, zgjati dorën tek ulliri i tretë. Tha "bismil-lah" dhe e hëngri me kënaqësi.

Sepse ulliri i tretë ishte i *ndriçuar*, si pasojë e respektit që kishte ndaj Krijuesit. E njëjta tërheqje ndodh tek të gjithë ata njerëz, që e dinë se ai që veshi shpirtin e tyre me trup është Allahu. Ata kanë reshtur së ankuari për vetullën, syrin, hundën dhe e kanë flijuar veten e tyre për lartësimin shpirtëror. Këta njerëz, ngaqë gjithnjë buzëqeshin me mirënjohje, dita ditës zbukurohen

edhe më shumë. Ata janë gjithnjë në sexhde fizikisht dhe shpirtërisht përpara Zotit të tyre. Bindja e tyre ndaj Allahut dhe të qenit të kënaqur me përcaktimin e Tij, i bën më të respektuara nga krijesat e tjera.

Një krijesë, që nuk është mirënjohëse për Krijuesin e saj, nuk pret t'i vijë respekti. Respekti është si kandili, ndriçimi i tij duhet ushqyer gjithnjë me një mirënjohje të vërtetë!

* * *

Në një rrugë me gështenja kaloi një njeri, i cili tha me vete:

- Aman kujdes, mos shpohesh!

I shijonte shumë jeta. Kaloi duke bërë kujdes të mos shpohet nga gjembat në rrugë.

Kurse njeriu që kaloi pas tij, mendoi:

- "Allahu ta paska mbushur të jashtmen me gjemba. Kushedi sa i rëndësishëm duhet të jetë fruti yt i brendshëm. Duke marrë përsipër gjakosjen, e kapi gjembin në dorë. Pa i kushtuar vëmendje dhimbjes, e hapi. Gështenja i buzëqeshi në duar me respekt, njeriut të dytë. Kushedi qysh kur gështenja po priste njeriun që e meritonte."

Njeriu i dytë ishte i *ndriçuar*, që vinte nga respekti për të brendshmen. Ai nuk i kushtonte rëndësi anës së jashtme të mbushur me gjemba, për arsye se depërtonte në të brendshmen dhe për të e jashtëmja nuk kishte shumë peshë. Kështu arriti aty ku fshihej shija dhe shërimi. Urtësia është si një gështenjë e fshehur nën shtresën e jashtme të saj. U fshihet njerëzve egoistë, të vrazhdë, të paedukatë dhe u hapet atyre që durojnë dhe sakrifkajnë.

Për të arritur në thelb, duhet shumë mund. Njerëzit që mundohen, meritojnë respekt. Respekti është si një kandil. Ndrëçimin e tij duhet ta ushqesh gjithnjë me një durim të bukur.

* * *

Në një shkrepëse kishte disa fije. E para tha:

- U mërzita duke djegur kokën për hir të të tjerëve. Ç'profesion që është ky i yni! Ose na duhet të rrimë brenda një kutie kaq të ngushtë, ose sa të dalim na duhet të digjemi. Mjaft, u mërzita! Ç'detyrë qenka kjo!

Fija e dytë:

- Po, le të protestojmë! U konsumuam kot gjer sot. Le të kërkojmë të drejtën tonë, tashmë! Na flijojnë sa na marrin në dorë. Mjaft, le të na dëgjohej zëri tashmë!

Edhe fijet e tjera i mbështeten, duke duartrokatur e fishkëllyer. Vetëm njëra prej tyre nuk entuziazmohej, dhe sikur ishte zhytur në mendime. Në fund, fija e tretë dha një mendim:

- Ç'kuptim mund të kishte ekzistenca ime në këtë botë, nëse do të isha një fije shkrepëseje që nuk do të flijojë kokën time për qëllimin e krijimit tim? Përderisa sobat, oxhaqet, qirinjtë, kandilët kanë nevojë për sakrificën time, si mund të bëhem egoiste unë? Allahu im! Unë jam e kënaqur me detyrën që më është dhënë. Nëse nuk e bëj detyrën time, sa e sa vende do të ishin të errëta, sa e sa oxhaqe do të ishin të fikur, sa e sa vatra do të ishin të ftohta. Ngaqë e di shumë mirë këtë, zemra ime gufon me dëshirën për t'u bërë shkak për mirë.

Ndërkohë, një dorë zgjatet dhe merr kutinë. Në mesin e të gjithë këtyre fijeve, zgjedh të tretën. Fija pranoi me kënaqësinë më të madhe të digjej. U gëzuan të gjithë drunjtë që u ndezën, të gjitha vatrat që u ngrohën. Falënderuan Allahun për atë fije shkrepëseje, që flijoi kokën e saj për të shërbyer.

Sepse fija e tretë ishte e *ndriçuar*, që vinte nga vetëdija dhe përgjegjësia e qëllimit të ekzistencës.

Vetëdija e Resulullahut (a.s.), që bënte dua për popullin e Taifit është pikërisht qendra e këtij ndrëçimi dhe është një thesar i paçmueshëm! Rruga e atij që është i dhënë pas rehatisë së vet, nuk kalon tek pëlqimi përmes brengës. Ai që nuk kalon përmes brengës, nuk mund ta ketë duanë të brendshme, sytë të përlotur, mendjen të ndrëçuar. Si mund të jetojë njeriu pa marrë përsipër të flijojë veten e vet për kauzën e tij? Kur njeriu nuk është egoist, por sakrifkues, i zgjerohet bota e mendimeve, i hapet horizonti. Ndaj dhe ka begati në punë. Njeriu, në vend që ta angazhojë mendjen për interesa të vogla, duhet ta bëjë të funksionojë atë në rrugë të Allahut, me dashuri, vullnet dhe besim. Të pasurit e vërtetë janë ata që mund ta bëjnë një gjë të tillë dhe një pasuri e tillë e mendjes u dhurohet pak njerëzve.

Ata që e kanë mendjen të zënë me meditime, me një entuziazëm të madh, janë gjithnjë të gatshëm. Respekti

është si kandili, ndrëçimin e tij duhet ta ushqejmë gjithnjë me mendime të ndrëshme.

* * *

Respektohet ai që do krijesat, ngaqë do Krijuesin e tyre, ai që sheh urtësinë përtej sipërfaqes, që kupton qëllimin e krijimit dhe që përpiqet të jetë një krijesë e mirë e Krijuesit. Ai që është mirënjohës, durimtar, i arsyeshëm, meriton respekt, sepse respekti është një ndjenjë e veçantë që ndihet ndaj atyre që kanë vlera, që janë të ndrëçuar dhe të dobishëm. Po, respekti është si një kandil. Ashtu sikurse edhe njeriu i respektuar... Nuret që reflektohen nga shikimet e tij, nga shpirti i tij, nga fjalët e tij dhe nga sjelljet e tij, ndrëçojnë sa e sa errësira.

Respekti është si një zinxhir. Nëse çdo njeri bën atë çfarë i takon, me vetëdijen e një hallke të këtij zinxhiri, zinxhiri rritet, bëhet stoli, bëhet i çmuar. Mirëpo, njeriu harron se është një hallkë e atij zinxhiri, dhe në vend që të merret me shërimin e sëmundjes së vet, ai merret me fajësimin e të tjerëve. Atëherë i njëjti zinxhir i lidhet për duar, për gojë, për shpirt dhe bëhet një prangë e rëndë dhe e ndryshkur për të.

Një besimtari nuk i shkojnë prangat. Duke ushqyer shpirtin me besim, ai gjallërohet. Dashuron dhe dashurohet, gëzon dhe gëzohet. Dashurohet dhe e di që kjo vjen si një dhuratë nga Allahu. Respekton, gëzohet t'i dhurojë respektin atij që e meriton. Bëhet i respektuar, bëhet i thjeshtë përballë atij që e respekton.

Ashtu sikurse çdokush përmend më shumë të dashurin, besimtari përmend më shumë të Dashurin e tij, Zotin e vet. Fjalët që zgjedh, fjalitë që formon, e bëjnë një nga hallkat më të bukura të zinxhirit të të respektuarve. I jep mundësinë që të garojë në të mirë, të flasë të vërtetën, i shton vlerë vlerës së tij, shton njerëzit që i sillen përreth me dashuri. Natyrisht, njeriu e respekton atë që e do. Për sa kohë që e respekton, i shtohet dashuria.

Besojmë se lartësia e vërtetë është afrimiteti me Zotin. Atëherë ne, kur nuk ia mungojmë respektin Zotit, padyshim që ne kështu bëhemi njerëzit që Zoti u dhuron respekt më shumë.

Njerëzit që e ruajnë gjuhën nga gafleti (harresa) dhe përmendin gjithnjë Zotin, atëherë edhe Ai i sheh, ruan me respekt. Respekti është si një kandil, ndrëçimi i tij gjithnjë duhet ushqyer me dhikër, ditë e natë.

* * *

Gjithmonë ka diçka që duhet kujtuar, duhet ta themi: ashtu sikurse njeriu është një qenie që dobësohet, fuqizohet, gjallohet dhe vdes, ashtu janë edhe ndjenjat e tij... Ndrëçimi i kandilit të respektit venit, nëse nuk i kushtohet rëndësi, nëse shpërfillet dhe nëse nuk i jepet ajo çfarë meriton. Vetëm besnikëria, qëndrueshmëria dhe sinqeriteti ia shton atij ndrëçimin. Respekti është si një kandil, duhet ushqyer me dashuri...

*“Nuk barazohet e mira me të keqen!
Të keqen ktheje me të mirë e atëherë armiku yt
do të të bëhet menjëherë mik i ngushtë.”*

(Fussilet, 34)

Një Ajet

Një nga qëllimet primare, që synon të zbatohet Islami në jetën e njeriut, është edhe morali i bukur. Pejgamberi (a.s.), na mëson se njeriu më i mirë është ai që ka moral më të mirë. Pejgamberi (a.s.), nga njëra anë predikonte moralin si një nga kriteret më të rëndësishme të fesë, kurse nga ana tjetër ekspozonte shembullin ideal të moralit të mirë në jetën e Tij.

Një nga treguesit kryesorë të besimit në një shoqëri islame janë vlerat morale në jetën shoqërore. Prandaj, është e pamundur të flasësh për besimin dhe Islamin e përkryer të një shoqërie që nuk jeton sipas parimeve morale. Parë nga ky këndvështrim, nuk mund të themi që shoqëria jonë është në një gjendje të mirë morale. Tashmë, përditë e më shumë humbja e këtyre vlerave është bërë realitet.

Po konstatohet që edhe personat korrektë dhe të përpiktë në adhurimet e tyre, nuk po e shfaqin këtë ndjeshmëri etike në sjelljet e tyre të përditshme. Rrënimin e vlerave morale e vërtetojnë çdo ditë e më shumë çështjet e shumta penale, mashtrimet, vrasjet dhe cenimi i të drejtave të të tjerëve. Morali i mirë është një nga dhuratat më të bukura që Islami i ka dhuruar njerëzimit. Përmes moralit sigurohet gjallëria, harmonia, stabiliteti, paqja, toleranca dhe drejtësia. Morali i bukur e dallon myslimanin nga të tjerët. Me humbjen e moralit, myslimanët kanë humbur një nga shenjat dalluese të tyre.

Është e vërtetë që zbatimi i vlerave morale në jetë kërkon vendosmëri dhe disiplinë. Sepse është e vështirë braktisja e veseve të mësuara më parë. Nga kjo pikëpamje, një njeri besimtar mund t'i zbatojë me lehtësi adhurimet, por është shumë e vështirë të çrrënjosë sjelljet dhe veset e kahershme.

Falja është prej devotshmërisë. Në këtë kuptim, të falësh është virtyt, sepse në këtë rast njeriu hedh poshtë qëndresën dhe kontestimet e nefsit, duke mbajtur një qëndrim dinjitoz duke falur të keqen që i është bërë. Ajeti i mësipërm i këshillon, përmes Pejgamberit, të gjithë besimtarët t'i largojnë të këqijat me vepra të mira. Kjo është shumë e vështirë, sepse i duhet të përballojë akuzat e shejtanit për mungesë dinjiteti dhe nderi dhe të marrë nën kontroll kapriçot e egos. Ky është shkaku që ajeti Kuranor: “Nëse djalli fillon të të joshë, kërko mbështetje te Allahu. Me të vërtetë, Ai i dëgjon të gjitha dhe i di të gjitha.” i këshillon besimtarët të strehohen tek Allahu, në rast nxitjeje nga shejtani.

Mirësia ka një ndikim të fortë mbi njeriun, sepse njeriu është një krijesë me ndërgjegje dhe, si e tillë, ndërgjegjja e keqbërësit vihet në lëvizje, kur përballlet me mirësitë e personit të cilit i ka bërë padrejtësi. E mira ka veti që zbut edhe armikun më të përbetuar. Prandaj, në fund të ajetit theksohet që përballë butësisë dhe mirësjelljes, armiku do të bëhet një mik i sinqertë dhe i dashur. Por duhet të theksojmë se ata që zgjedhin këtë rrugë, janë personalitete monumentale, të cilët kanë triumfuar mbi egon. Ky moral u jepet vetëm atyre që janë durimtarë, siç theksohet edhe në ajetin vijues: “Ky virtyt u dhurohet vetëm atyre që durojnë dhe vetëm atyre që kanë një fat të madh.” (Fussilet, 35)

Këta janë grupi që e kanë mundur egon dhe kanë shkrirë akujt e armiqtë me durim dhe vullnet. Durimi dhe gjakftohtësia e tyre nuk është një sjellje spontane, por një sjellje që bëhet për të fituar dashurinë e Allahut. Sa mirë për ata që zgjedhin këtë rrugë, në një kohë kur egoizmi dhe narcisizmi është shumë provokues!

Një ditë, Pejgamberi (a.s.), e këshilloi Hamzain (r.a.), mbi natyrën e kësaj bote, duke i thënë:

"Dynjaja është e ëmbël dhe joshëse. Kush merr prej saj atë që i takon, Allahu i jep begati në atë që merr dhe ka shumë të tjerë që shpërdorojnë pasurinë e Allahut dhe të Dërguarit të Tij, të cilët në Ditën e Gjykimit do të kenë si shpërblim Xhehenemin." (Ahmed b. Hanbel, 6/364)

Me këtë porosi, Pejgamberi (a.s.), na kujton përgjegjësinë që kemi përballë të mirave dhe begatave të botës në të cilën jetojmë. Veçoria më e rëndësishme, që e dallon njeriun nga të gjitha gjallesat e tjera që jetojnë në këtë botë, është vetëdija e përgjegjësisë. Kjo vetëdije na kujton që bota dhe të mirat e saj janë pasuri e gjithë njerëzimit, duke filluar nga njeriu i parë, deri te gjenerata e fundit që do të jetojë në këtë botë.

Allahu, i cili na ka mundësuar të shfrytëzojmë të gjitha të mirat e kësaj jete, në të njëjtën kohë mënyrën e shfrytëzimit të tyre e ka bërë provim për ne. Të gjitha krijesat e tjera që jetojnë në këtë botë, ekspozojnë një stil jetese brenda kufijve të vendosur nga Krijuesi, të ekuilibruar, të bazuar në ndihmën reciproke, që shpenzojnë sa u nevojitet dhe që nuk sjellin asnjë dëm për natyrën. Sepse ata janë një pjesë e natyrës, në të cilën jetojnë dhe janë në harmoni të plotë me pjesët e tjera. Kjo harmoni pritet edhe prej njeriut, si një pjesë e kësaj natyre. Megjithatë njeriu është superior në krahasim me krijesat e tjera në tokë, nuk duhet që ai të sundojë natyrën në mënyrë të atillë, që çon në shkatërrimin dhe prishjen e harmonisë së saj. Sepse kjo është pika ku ne humbim sprovën. Rregulli më i rëndësishëm i kësaj sprove është zotërimi i asaj që të takon, pa cenuar dhe dhunuar të drejtat dhe hakun e të tjerëve. Thënë ndryshe, çdo gjë që ka krijuar Allahu duhet të konsiderohet si amanet dhe

kjo duhet të bëhet motoja e çdo myslimani.

Në atë kohë, shprehja "pasuria e të Dërguarit", në hadith nënkuptonte "Bejtul Mal", thesarin shtetëror, kurse në ditët tona nënkupton pasurinë publike. Qysh në fillimet e tij, Islami i ka dhënë një rëndësi të madhe pasurisë publike dhe cenimi i pasurisë publike është konsideruar si një padrejtësi dhe faj ndaj krejt shoqërisë dhe në botën tjetër parashikohet të dënohet me Xhehenem. Prandaj, Pejgamberi (a.s.), nuk e ka falur xhenazën e personit që ka fshehur mallin e luftës, pa u ndarë prej tij.

Që nga ajo ditë nuk ka ndryshuar asgjë. Pasuria e shtetit nuk është pasuri personale e drejtuesve, por pasuri e përbashkët e gjithë shoqërisë. Çdo lloj dhunimi i kësaj pasurie konsiderohet si padrejtësi ndaj të gjithë shoqërisë. Cenimi i kësaj të drejte, që në terminologjinë islame njihet si haku i njeriut, është një faj i rëndë, i cili nuk mund të përfshihet në amnistinë e Allahut, pa u falur më parë nga individët e veçantë. Myslmani është përgjegjës para Allahut për çdo veprim që kryen. Një mysliman i mirë nuk i ushqen fëmijët me fitim haram.

Nuk duhet të harrojmë se shumë të këqija burojnë nga babëzia dhe pamjaftueshmëria ndaj asaj që të takon. Është e qartë se ai që nuk është i kënaqur me të drejtën e tij, në Ditën e Gjykimit do të jetë larg Mëshirës Hyjnore.

Një Hadith

Mësimet që nxjerrim nga hadithi:

1. Kjo botë e josh njeriun drejt të mirave të saj.
2. Allahu i jep begati atij që fiton me nder dhe punë.
3. Dënimi për ata që fitojnë në mënyrë të padrejtë është Xhehenemi.



Urtësi prej të dashurve të Allahut

TA BËSH SHPIRTIN FOLE MËSHIRE

Njeriu që është larg urtësive dhe të vërtetave të Islamit, valëvitet midis shpirtërores dhe materiales, si pasojë e ndryshimit të vazhdueshëm të kushteve në sprovat e jetës së kësaj bote. Ai i ngjan një anijeje me timon të thyer, e cila ndodhet në një oqean të errët me furtunë dhe vorbulla. Prej se e ka humbur orientimin shpirtëror, për të cilin ka nevojë shpirti i tij, ndodhet në një gjendje ku nuk e di se në cilën vorbull të nefsit do të shkatërrohet.

Njeriu, i cili lëviz nëpër korridoret tepër të ngatërruara të jetës, e ka të pamundur që vetëm me mendjen e tij të dobët të gjejë rrugën e duhur, që të mos humbë ndjenjën e devotshmërisë dhe nderit, që të mos shkatërrojë lumturinë e përrjetshme dhe që të kuptojë mirësinë dhe butësinë e Islamit. Në rrugëtimin drejt përjetësisë, ai ka nevojë të madhe për udhëzimin dhe nënshtrimin ndaj ligjeve hyjnore.

Që të mund të jetojnë, gjallesat janë të detyruara të ushqehen. Po kështu edhe njeriu që të qëndrojë gjithmonë në rrugën e drejtë, duhet që jeta e tij të jetë në ekuilibër mes materiales dhe shpirtërores. Ai duhet të ushqejë mendjen dhe zemrën e tij me nurin e Kuranit dhe Sunetit, pra me një fjalë, t'i nënshtrohet edukimit hyjnor.

DASHURIA DHE BINDJA

Në një hadith fisnik thuhet:

"Njeriu është bashkë me atë që do." (Buhari, Edeb, 96.)

Dashuria ndaj të Dërguarit të Allahut (a.s.), kërkon bindje dhe lidhje shpirtërore, sepse dashuria është si një linjë elektrike midis dy zemrave dhe intensiteti i dashurisë varet nga gjendja e kësaj lidhjeje. Kjo lidhje zemrash bëhet e mundur me thellimin e ndjenjave, duke përfutuar nga morali profetik dhe duke i parë krijesat me syrin e mëshirës, ashtu siç i sheh Krijuesi i tyre.

Shpirtrat mund të marrin ushqim dhe begati shpirtërore prej të Dërguarit të Allahut (a.s.), aq sa janë të lidhur me të dhe aq sa i ngajnë atij në moral. Dashuria për të varet nga bindja ndaj tij dhe nga sakrificat e përpjekja që tregohet për t'i ngjarë atij. Ndërsa dashuria ndaj Allahut kërkon besim dhe bindje ndaj të Dashurit të Tij fisnik (a.s.). Në një ajet urdhërohet:

Thuaju (o Muhamed): "Nëse ju e doni Allahun, atëherë më ndiqni mua, që Allahu t'ju dojë dhe t'ju falë gjynahet!..." (Al'Imran, 31.)

"Ka njerëz që e fllojnë veten, për të fituar pëlqimin e Allahut..." (el-Bekare, 207.)

Në fakt, njeriu duhet t'i bëjë të panjohurat, të njohura, duhet t'i ndriçojë shtigjet e errëta, si edhe të vërtëdojë për të papriturat e botëve, që janë jashtë fushës së perceptimit të tij, si varri dhe jeta e përtejme. Gjithashtu, duhet t'i bindet me nënshtrim të plotë dhe dashuri të madhe Allahut Teala, i Cili do t'i falë paqe shpirtit të tij. Vetëm në këtë mënyrë robi do të arrijë pjekurinë shpirtërore, me të cilën Allahu do të jetë i kënaqur.

Në këtë pikë, rruga më e saktë për t'ndjekur, është rruga e gjurmëve të ndritura të Profetit (a.s.), që Allahu Teala ia dhuroi të gjithë njerëzimit, si modelin e Njeriut të Përsosur.

PJEKURIA SHPIRTËRORE

Bota shpirtërore e atyre, që me besnikëri ia kanë kushtuar jetën rrugës së drejtë, shndërron në një det të gjerë mëshire, sepse Allahu, që është Rrahman dhe Rrahim, e ka dërguar Resulullahun (a.s.), si mëshirë për të gjithë njerëzit dhe e ka bërë atë shembull për njerëzimin, me cilësinë e kësaj mëshire.

Prandaj, ata që përfitojnë ashtu siç duhet prej moralit shpirtëror të Resulullahut (a.s.), arrijnë ta bëjnë shpirtin e tyre vend mëshire, i cili përqafon të gjitha krijesat. Ata tashmë janë liruar nga robëria e fiksimeve të nefsit dhe llogarive të interesave të tyre personale. Shpirtrat e tyre, duke dashur Allahun dhe Profetin (a.s.), kanë shijuar dashurinë e vërtetë. Për këtë arsye, çdo kënaqësi dhe shije e përkohshme e ka humbur ndikimin dhe rëndësinë në sytë e tyre. Tashmë, i gjithë mudi, mendimi, shqetësimi, halli dhe përpjekja i tyre është për paqen dhe lumturinë e të gjitha krijesave.

Si rezultat i edukimit hyjnor dhe profetik, ata kanë



**Thuaju (o Muhamed):
"Nëse ju e doni Allahun,
atëherë më ndiqni mua,
që Allahu t'ju dojë
dhe t'jua falë gjynahet!.."**

(Al'Imran, 31.)

shpëtuar prej egoizmit, pra kanë ikur nga stacioni i "unit", janë bërë altruistë duke hyrë në stacionin e "bashkësisë". Ata që janë shqetësuar me shqetësimin e të tjerëve dhe janë qetësuar me qetësimin e të tjerëve, kanë arritur pjekurinë e një shpirti të butë dhe të ndjeshëm. Ata e kanë kuptuar shumë mirë se shpëtimi i tyre kalon nga përpjekja për shpëtimin e të tjerëve.

Sa bukur e shpreh ky tregim pjekurinë shpirtërore që kërkohet për takimin me Allahun:

Bejazid Bistami (Allahu e mëshiroftë), tregon:

"Në kohën tonë kishte me mijëra veli. Mirëpo, detyra e prijësit (në rrugën e drejtë) për atë shekull, ishte besuar një hekurpunuesi me emrin Ebu Hafs. Për të mësuar më shumë rreth kësaj urtësie, shkova te dyqani i tij. Kur e pashë, vura re se ai ishte shumë i shqetësuar dhe i hidhëruar. E pyeta për arsyen e kësaj dhe ai m'u përgjigj me këto fjalë:

"Vallë, a ka dert më të madhe se derti im, dhe njeri më me shumë derte se unë? Vallë, si do të jetë gjendja e umetit të Muhamedit (a.s.), në Ditën e Kiametit?"

Më pas filloi të qante dhe më bëri edhe mua të qaja. U bëra kureshtar dhe e pyeta:

"Përse të shqetëson kaq shumë fakti se njerëzit do

të dënohen?”

Ebu Hafsi u përgjigj:

“Natyra ime është mburjtur me mëshirë dhe dhembshuri. Nëse i gjithë dënimi që do t’u jepej njerëzve të shkujdesur do të binte mbi mua dhe ata do të faleshin, unë do të isha tepër i kënaqur prej kësaj dhe derti im do të merrte fund...”

Prej kësaj, kuptova se Ebu Hafsi nuk ishte nga ata që thoshin “unë, unë”, por duke qenë në rrugën e Profetit (a.s.), ishte nga ata që thoshin “umeti, umeti!”

Siç shihet, gjendja e trashëgimtarëve të Profetit të mëshirës (a.s.), të cilët kanë përfutuar prej moralit të tij shpirtëror, reflekton ndjenjat e larta të një shpirti që është bërë fole mëshire.

I nderuari Hasan Harakani ka thënë: “Nëse në gishtin e njërit prej vëllezërve të mi të fesë, që ndodhen midis Turkistanit dhe Shamit, ngulet ndonjë gjemb, është njësoj sikur ai gjemb të më ngulej në gishtin tim... Hidhërimi i zemrës së tyre, është derti im.”

I nderuari Serijji Sakati, tridhjetë vjet të jetës së tij, i kaloi duke bërë *teube* dhe duke kërkuar falje prej Allahut, sepse, për një shkujdesje të çastit nuk mendoi për fatkeqësinë që u kishte ndodhur vëllezërve të tij të fesë, por u gëzua që shpëtoi vetë. Këta dhe shembuj të tjerë prej të dashurve të Allahut, tregojnë qartë për ndjenjat e thella, që kishin këta njerëz në shpirtat e tyre.

VIRTYT MBI VIRTYT

I nderuari Rabi ishte një prej të dashurve të Allahut, i cili tregojë i butë, bujar dhe i mëshirshëm me të tjerët, duke sakrifikuar edhe veten e tij. Në kohën kur u paralizua, një i varfër i erdhi te dera dhe i kërkoi diçka. Rabi tha:

“Jepini një ëmbëlsirë!” Sepse edhe vetë i pëlqente shumë ëmbëlsirat. Kështu e kuptonte ai ajetin: **“Nuk kenë për ta arritur përkushtimin e vërtetë, derisa të ndani (lëmoshë) nga ajo (pasuri) që e doni...”** (Al’Imran, 92.)

Njëherë, kur iu shtuan shumë dhimbjet, dëshiroi të hante mish pule. Mirëpo, duke e mbajtur veten për dyzet ditë me radhë, nuk hëngri mish pule. Një ditë i tha së shoqes:

“Kam dyzet ditë që dëshiroj të ha mish pule, por po e mbaj veten duke shpresuar se mund të heq dorë edhe nga kjo dëshirë.”

E shoqja ia ktheu:

“Fesubhanallah! Shiko se prej çfarë po e mban veten! Allahu ta ka bërë hallall atë ushqim!”

Pas kësaj, e shoqja shkoi në pazar dhe bleu një pulë, të cilën e preu dhe e poqi për bukuri. Pastaj gatoi bukë dhe përgatiti një sofër me



“Betohem në Allahun, në dorën e plotfuqishme të të Cilit ndodhet shpirti im, se nëse nuk mëshironi njëri-tjetrin, nuk do të hyni në xhenet.”

ushqime të ndryshme.

Të gjitha këto i mori dhe ia çoi përpara të nderuarit Rabi. Por në atë moment, një i varfër u afrua tek dera dhe tha:

-Më jepni ndonjë gjë për hir të Allahut, që Allahu t’u japë begati!

Rabi hoqi dorë nga pula dhe i tha së shoqes:

-Merre këtë pulë dhe jepja atij!

E shoqja iu përgjigj:

-Fesubhanallah!

Rabi këmbënguli:

-Bëj atë që po të them.

Këtë herë, e shoqja reagoi:

-Të paktën bëj diçka që do të jetë më e mirë për të.

-E çfarë të bëj?

-I japim paratë e pulës, ndërsa ti ha pulën që ke dëshiruar aq shumë!

I nderuari Rabi i tha:

-Një propozim shumë i bukur! Më sill aq para sa bën kjo pulë!



Kure shoqja ia solli paratë, ai tha:

-Tani vendosi paratë pranë pulës dhe jepja atij nevojtar!

E shoqja, mori paratë dhe pulën e

“Mëshira (për të cilën po flas), nuk është vetëm ajo që duhet të keni ndaj njëri-tjetrit, siç e kuptoni ju, por mëshira e cila përfshin të gjitha krijesat, po të gjitha krijesat!..”

ia çoi nevojtarit. (Bursevi, Ruhu'l-Bejan)

Padyshim që kjo gjendje është edhe niveli më i lartë i bujarisë, pra virtyti “ISAR”. Kjo është sakrifica e dhënies së pasurisë një vëllai të fesë, vetëm për hir të Allahut. Sa bukur shprehet Allahu Teala në lidhje me këtë virtyt të lartë:

“Ata i ushqejnë të varfrit, jetimët dhe të zënë rob, edhe pse vetë janë nevojtarë, duke thënë: ‘Ne ju ushqejmë vetëm për hir të Zotit. Për këtë, nuk duam shpërblim e as falënderim! Ne i frikësohemi Zotit tonë në një Ditë të ashpër, që do t’i bëjë fytyrat të jenë të vrenjtura.’ Por Allahu do t’i ruajë ata nga tmerret e asaj Dite e do t’u japë shkëlqim dhe gëzim”. (el-Insan, 8-11.)

HORIZONTI I MËSHIRËS

Ja pra, morali islam ka arritur të ndërtojë një shpirt me pjekuri të përsosur, i cili kur është nevoja, heq dorë nga nevoja e vet dhe qetësohet duke kënaqur shpirtin e një vëllai të fesë. Ata që arrijnë këtë pjekuri shpirtërore, i kanë kuptuar në mënyrën më të bukur fjalët e

Profetit (a.s.), i cili ka thënë:

“Kush nuk shqetësohet për hallet e besimtarëve, nuk është prej tyre.” (Hakim, Mustedrek, IV, 352; Hejthemi, Mexhmau’z-Zeuaid, I, 87.)

“Kush shtrihet i ngopur, ndërkohë që komshiu i tij është i uritur, nuk është prej nesh.” (Hakim, II, 15/2166a.)

Pra, ata e kanë kuptuar shumë mirë se janë përgjegjës për çdo gjë, të cilën duart e tyre mund ta arrijnë. Gjithashtu, ata kanë kuptuar se uria nuk është vetëm ajo e stomakut, por edhe ajo e shpirtit njerëzor, e cila bëhet shkas për sëmundje edhe më të rrezikshme.

Personaliteti i pashoq dhe shembullor, Profeti Muhamed Mustafai (a.s.), një ditë u tha shokëve:

“Betohem në Allahun, në dorën e plotfuqishme të të Cilit ndodhet shpirti im, se nëse nuk mëshironi njëri-tjetrin, nuk do të hyni në xhenet.”

Sahabët e nderuar thanë:

-O Resulallah! Ne të gjithë jemi të mëshirshëm.

I Dërguari i Allahut (a.s.), thotë:

“Mëshira (për të cilën po flas), nuk është vetëm ajo që duhet të keni ndaj njëri-tjetrit, siç e kuptoni ju, por mëshira e cila përfshin të gjitha krijesat, po të gjitha krijesat!..” (Hakim, IV, 185/7310.)

Pra, mëshira dhe dhembshuria e Profetit (a.s.), kishte cilësinë që përfshinte të gjitha krijesat, sepse shpirti i tij i bekuar, i shihte krijesat ashtu siç i sheh Krijuesi i tyre.


Kjo është arsyeja që ai edhe armikun e tij e shihte me sy mëshire. Në luftën e Bedrit, kur dy ushtritë u vendosën përballë njëra-tjetrës, Resulallahu (a.s.), u dërgoi mushrikëve përfaqësuesit e tij, që të merreshin vesh pa luftë. Në atë çast, disa mushrikë, në mesin e të cilëve gjendej edhe Hakim bin Hizami, erdhën të pinin ujë tek pusi i myslimanëve. Myslimanët deshën t’i pengonin, por i Dërguari i Allahut (a.s.), tha:

“Lërinë të pinë!”

Ata erdhën, pinë ujë dhe më vonë, përveç Hakimit, të gjithë mushrikët e tjerë nxorën shpatat kundër ushtrisë islame dhe të gjithë përfunduan të vranë. Ndërsa Hakimi, më vonë do të nderohej me udhëzimin në rrugë të drejtë. (Ibën Hisham, II, 261.)

Në vitet kur mushrikët e Mekës, të cilët i torturuan myslimanët vite me radhë, i kapi zia e bukës dhe ngelën të uritur, Profeti (a.s.), dërgoi ushqime për ta. Në këtë mënyrë, ai u tregoi atyre, të cilët njëherë e një kohë kishin vendosur embargo ndaj myslimanëve duke i lënë të vdisnin urie, botëkuptimin e moralit të lartë që zotëron

1. Të dhënit bujarisht e e asaj për të cilën ti vetë ke nevojë.



Islami.

Profeti (a.s.), sa herë që i jepej rasti, i këshillonte njerëzit të tregonin mëshirë ndaj krijesave për hatër të Krijuesit, dhembshuri, delikatesë dhe veçanërisht për të pasur kujdes që të mos thyenin askujt zemrën. Në sajë të këtyre këshillave, zbuteshin zemrat, delikatesa dhe butësia arrinin majat më të larta dhe ndërtohej një pjekuri shpirtërore, e cila do të përfaqësonte bukuritë e Islamit.

Resulallahu (a.s.), ka dhënë shumë këshilla edhe në lidhje me mirëmbajtjen dhe pastrimin e kafshëve. Veçanërisht, ka kërkuar që delet dhe dhitë të pastroheshin mirë nga papastërtitë dhe dheu. (Hejthemi, IV, 66-67.)

Ai na ka urdhëruar, që edhe kur vrasim ndonjë gjarpër ose ndonjë kafshë të rrezikshme, ta bëjmë me një të rënë dhe pa e torturuar.

Një prej sahabëve, Ebu Derda (r.a.), kishte parë disa njerëz që i ngarkonin shumë devetë e tyre, aq sa ato nuk mund të ngriheshin në këmbë prej ngarkesës së rëndë. Ebu Derda (r.a.), pasi ia hoqi ngarkesën e tepërt, e ngriti një rënë nga devetë në këmbë dhe, duke iu drejtuar të zotit të kafshës, tha:

“Nëse Allahu Teala do t’ju falë për këtë keqtrajtimit që u bëni kafshëve, do të tregohet shumë falës ndaj jush. E kam dëgjuar Resulallahun (a.s.), të thotë:

“Allahu Teala ju urdhëron të silleni mirë me kafshët,

“Allahu Teala ju urdhëron të silleni mirë me kafshët, sepse ato nuk mund të flasin! Nëse kaloni në ndonjë tokë pjellore, lejojini kafshët të kullosin! Nëse kaloni në ndonjë tokë të shkretë, ecni shpejt...”

sepse ato nuk mund të flasin! Nëse kaloni në ndonjë tokë pjellore, lejojini kafshët të kullosin! Nëse kaloni në ndonjë tokë të shkretë, ecni shpejt...” (Ibën Haxher, el-Metalibu’l-’Alije, II, 226/1978.)

Njëherë, Resulallahu (a.s.), pa një njeri i cili po milte delen e tij dhe i tha:

“O filan! Kur ta mjelësh kafshën, lër qumësht edhe për të voglin e saj!” (Hejthemi, VIII, 196)

Seuade bin Rebi (r.a.), na transmeton këtë shembull të mëshirës dhe delikatesës së pashoqe:

“Shkova tek Profeti (a.s.), dhe kërkova diçka prej tij. Ai urdhëroi që të më jepeshin disa deve. Pastaj më këshilloi me këto fjalë:

“Kur të shkosh në shtëpi, thuaji familjes t’i mirëmbajë kafshët dhe t’u japë ushqim të bollshëm! Urdhëroje atë që t’ua lëmojë thundrat dhe, kur t’i mjelë, të mos i dëmtojë e t’u shkaktojë plagë!” (Ahmed, III, 484; Hejthemi, V, 168, 259, VIII, 196.)

Njëherë tjetër, kur Profeti (a.s.), ishte duke udhëtuar për në Mekë bashkë me sahabët, panë një gazelë që po flinte në rrugë. Profeti (a.s.), që ishte dërguar mëshirë për botët, urdhëroi njërin prej sahabëve të qëndronte pranë gazelës derisa të kalonin të gjithë, me qëllim që kafsha të mos trembej. (Muvatta, Haxh, 79; Nesai, Haxh, 78.)

Kur po shkonin për të çliruar Mekën me një ushtri prej dhjetë mijë vetash, në rrugë vuri re një qen, i cili ishte shtrirë dhe po u jepte gjë këlyshëve të vet. Profeti (a.s.), caktoi Xhuajl bin Surakan (r.a.) rojë pranë qenit dhe këlyshëve të tij dhe e porositi atë të kujdesej për të. (Uakidi, II, 804.)

Njëherë, Profeti (a.s.), pa një fole milingonash së cilës i ishte vënë zjarr. Ai u pezmatua nga një gjë të tillë. Foleja e djegur e milingonave ia kishte hidhëruar aq shumë zemrën e tij të ndjeshme, prandaj dhe me hidhërim të madh tha:

“Kush e ka djegur këtë fole? Dënimin me zjarr, i takon ta japë vetëm Zoti i zjarrit.” (shih. Ebu Daud, Xhihad 112/2675, Edeb 163-164/5268.)

Njëherë tjetër, Profeti ynë (a.s.), pa një beduin, i cili kishte marrë një shkop dhe u binte degëve të një peme, duke u përpjekur të shkundte gjethet e saj për kafshët e tij. Pastaj u tha atyre që kishte pranë:

“Ma sillni këtu atë beduin, por silluni butë dhe mos e trembni!”

Kur beduini i erdhi pranë, Profeti (a.s.), me delikatesë

të madhe i tha:

“O beduin! Gjethet shkundi me kujdes e butësi dhe jo duke gjuajtur e thyer degët!” (Ibnu'l-Esir, Usdu'l-Gabe, Bejrut 1417, VI, 378.)

Profeti ynë (a.s.), zemra e të cilit nuk duronte dot as thyerjen pa arsye të një dege të njomë, sa herë që i jepej rasti, e ftonte umetin e tij të sillej me delikatesë, butësi dhe mëshirë ndaj çdo gjëje. Në një hadith, Profeti (a.s.), në lidhje me mirëmbajtjen e bimëve, thotë:

“Nuk ka asnjë bimë, e cila ka mbirë në tokë dhe të mos ketë një melek që e ruan me krahët e tij. Kjo vazhdon deri sa të vijë koha e korrjes së asaj bime. Atë që e shkel dhe prish atë bimë, ai melek do ta mallkojë.” (Ali el-Muttaki, Kenz, III, 905/9122.)

MOS I BËJ KEQ AS MILINGONËS!

Në sajë të begatisë së moralit profetik, që ishte shembulli më i mirë i zemrave të besimtarëve, u edukuan njerëz me ndjenja të thella, të cilët nuk këpusnin as edhe një lule, e nuk u bënë keq as milingonave...

Kjo ngjarje që vijon më poshtë, është një nga shembujt më të përsosur të mëshirës:

Sulltani Kanuni Sulejman, me një bejte, kërkoi fetva prej Shejhu'l Islamit Ebu Suud Efenidiut, që të vriste milingonat që kishin tharë pemët e dardhave të kopshtit të sarajit:

Nëse milingonat dëmtojnë të mbjellat,

A lejohet t'i vras, çfarë thotë feja?

Kërkesës për fetva të sulltanit, Ebu Suud Efenidiu i përgjigjet me një bejte tjetër:

Nesër, kur para Hakut të dalë,

Prej Sulejmanit, milingona hakun do ta marrë!

Zemrat e besimtarëve të përsosur janë mbujtur me një edukatë aq të lartë shpirtërore, sa që nuk mund t'i bëjnë keq as edhe një milingone. Në sajë të butësisë dhe mëshirës së tyre të gjerë, ata i gjallërojnë dhe i gjelbërojnë bahçet e zemrave.

PËR HATËR TË KRIJUESIT

Njëri nga të dashurit e Allahut, Ahmed er-Rufai, ishte shumë i mëshirshëm ndaj kafshëve. Një qen ishte së-

murë me zgjebe dhe kushdo që e shihte neveritej prej tij. Ai dëbohej nga çdo derë në të cilën shkonte, derisa arriti te dera e Ahmed er-Rufaiut. Ishte i rraskapitur dhe i mbushur me plagë. Kur e pa gjendjen e kafshës, e mori qenin dhe e çoi në një vend jashtë qytetit. I bëri një vend me hije dhe filloi ta kuronte. E pastroi mirë e mirë, ia leu plagët me melhem dhe pastaj e ushqeu.

Pas dyzet ditësh kurim, shëndeti i qenit u përmirësua dhe nuk i ngeli asnjë shenjë prej sëmundjes së zgjebes. Pastaj e lau mirë e mirë dhe e çoi në qytet. Kur arriti në qytet, ata që e panë, e pyetën:

-Zotëri! U kujdesët jashtë mase për këtë qen. A mund ta dimë urtësinë dhe arsyen?

Ahmed er-Rufai u përgjigj me këto fjalë:

-U frikësova se mos Ditën e Kijametit Zoti im, do të më pyesë: “Si s'të erdhi keq për atë qen? Përse nuk u mundove ta shëroje? Përse nuk mendove se edhe ti mund të sëmuresh një ditë në atë mënyrë?”

O njerëz! Mbushini zemrat tuaja me mëshirë ndaj krijesave të Allahut Teala! Kini frikë se mos Allahu ju sprovon me të njëjtat fatkeqësi si të tyre!”

Ja pra, të dashurit e Allahut, nuk cenonin askënd, nuk i hynin askujt në hak dhe nuk e zgjasnin dorën në atë që s'u takonte. Mirësitë që ata zotëronin i shihnin si amanete të Allahut dhe me një ndjenjë të thellë përgjegjësie, kanë vepruar me përpikmëri dhe delikatesë të veçantë.

Nuk duhet harruar se Allahu Teala, në çdo moment i fton besimtarët për në Daru's-Selam, pra në Xhenet. Prandaj çdo besimtar:

- Duhet të jetë gjithmonë me Allahun dhe në çdo moment të kërkojë kënaqësinë e Tij.

- Duhet tadojë dhe t'i bindet të Dërguarit të Allahut (a.s.).

- Nuk duhet të harrojë përgjegjësinë e vëllazërisë fetare.

- Duhet që çdo krijesë ta shohë me syrin e mëshirës.

Allahu Teala bëftë që këto ndjenja të mos mungojnë në kurrë në shpirtin tonë! I bëftë zemrat tona fole ku çdo krijesë gjen paqen dhe qetësinë!

Amin!..

Çdo grup shoqëror përpiket të ndjekë dhe të marrë si shembull prijësin e tij. Nëse prijësi gëzon dashurinë dhe respektin e popullit, atëherë çdo veprim i tij merret si model nga shoqëria. Veçanërisht, kjo gjendje fiton një përmasë krejt tjetër, kur ky nuk është vetëm prijës politik, por në të njëjtën kohë është edhe udhëheqës shpirtëror duke arritur kulmin, kur përkrah këtyre dy cilësive është edhe i ngarkuar nga Allahu me detyrën e përcimit të mesazhit hyjnor tek njerëzit. Në këtë rast përvetësimi, shembulli dhe ndjekja e tij konsiderohet virtyt dhe vlerësohet ibadet.

Muhamedi (a.s.), duke qenë profeti dhe shembulli i fundit i dërguar nga Allahu për njerëzimin, karakterizohet nga përsosmëria në të gjitha aspektet. Allahu e përcakton qartë në Kuran personin që duhet marrë si shembull dhe të mirat që sjell ndjekja e tij: **“Në të Dërguarin e Allahut ka një shembull të mrekullueshëm për atë, që shpreson tek Allahu dhe Dita e Fundit dhe e përmend shumë Allahun.”** (Ahzab, 21) Ndjekja e Pejgamberit (a.s.), është detyrë dhe virtyt i vyer për çdo besimtar.

Të gjithë pejgamberët kanë qenë udhërrëfyes, prijës dhe shembuj të përsosur për popullin. Para ardhjes së Pejgamberit (a.s.), shoqëria vuante nga mungesa e shembujve të gjallë, pas të cilëve të kapeshin për të ecur përpara. Kur u shfaq Pejgamberi (a.s.), me mësimet hyjnore dhe moralin e përkryer, menjëherë u mor si shembull nga sahabët, për të vazhduar më tej nga të gjithë besimtarët deri në Ditën e Kiametin. Ngrënia-pirja si Profeti, sjellja me njerëzit si ai, të qenët mik, bashkëshort dhe komshi si ai, janë parë gjithmonë si ideale të dëshirueshme nga të gjithë besimtarët. Thënia e tij: *“Jam dërguar për të plotësuar e përsosur moralin e mirë”*, përbën një ftesë për ta ndjekur atë si një Pejgamber, i Dërguar për t’u mësuar njerëzve moralin e bukur. Ai erdhi për t’u mësuar njerëzve imanin, kaq të nevojshëm për ta. Shkëputja e plotë nga shirku dhe kushti që të adhurohet vetëm Allahu, është hapi parë i bërjes së njeriut, njerëzor.

Pas imanit, hapi i dytë i domosdoshëm për t’u bërë njeri i përkryer është ibadeti. Muhamedi (a.s.), krahas imanit hodhi themelet për krijimin e një shoqërie ideale dhe një qytetërimi madhështor. Përmes Muhamedit (a.s.), njerëzimi shpëtoi nga botëkuptimi pagan, duke përvetësuar parime që do ta çonin në kulmin e marrëdhënieve ndërnjerëzore. Ndër shumë parime të jetës qytetare, Pejgamberi (a.s.), u mësoi njerëzve dashurinë, mëshirën, solidaritetin dhe ndihmën reciproke. U mësoi devotshmërinë, u mësoi të qëndronin larg nga gjërat e ndaluara. U tregoi se të pasurit kanë detyrime mbi të varfrit. Ua qëndisi në zemër besimtarëve se sadakaja më tepër se mirësi, është detyrim për besimtarët. Duke inkurajuar për bujari, u bëri të qartë se imani dhe koprracia nuk mund të gjenden në një zemër.

Muhame lider

Medi (a.s.), model

U tregoi se besimtari nuk mund të jetë dembel, u tregoi për rëndësinë e urdhërimit për mirë dhe ndalimit nga e keqja. I urdhëroi të pengonin të keqen me dorë apo me fjalë, kur është e nevojshme. U ndaloi përdorimin e çdo gjëje të dëmshme dhe u bëri të qartë dëmin e madh që i sjellin shoqërisë. U ndaloi vjedhjen, imoralitetin, mashtrimin, magjinë dhe çdo vepër tjetër të keqe. I këshilloi të qëndronin larg thashethemeve, përgojimeve dhe bestytive.

Një nga parimet bazë të mësimave islame është respektimi i të drejtave të njeriut dhe marrja në mbrojtje e tyre. Vrasja e një njeriu të pafajshëm, është si vrasja e të gjithë njerëzimit.

Muhamedi (a.s.), i konsideroi si amanet bashkëshortet dhe i këshilloi sahabët ta ruanin në mënyrën më të mirë amanetin dhe për këtë tregoi shembullin e vet. U tregoi se myslimani më i mirë dhe më i devotshmëm, është ai që sillet më mirë me bashkëshorten e tij. Femrën e vlerësoi si pasurinë më të shtrenjtë të kësaj bote. Një tjetër parim i Pejgamberit (a.s.), është fshirja e të gjitha dallimeve dhe ndasive racore apo sociale. Pejgamberi (a.s.), na mësoi përmes mësimave të Tij se një arab nuk ka përparësi ndaj një joarabi dhe një i bardhë ndaj një të ziu. Dallimi ekziston vetëm në mirësi dhe devotshmëri. Nxitja për t'u pajisur me dituri përbën një nga shembujt më të qartë të Pejgamberit (a.s.). Ai e konsideroi obligim kërkimin e ditorisë për besimtarët. Kjo bëri që besimtarët të kërkojnë dituri në çdo cep të botës, duke përhapur dritën e dijes në gjithë botën.

Pejgamberi (a.s.), përmes shembullit të Tij vendosi parime të pavdekshme në të drejtën civile. Një nga konceptet bazë, që Pejgamberi (a.s.), ia mësoi njerëzimit është koncepti i drejtësisë. Ai urdhëroi të gjykohej me drejtësi midis njerëzve.

Islami i ofroi ymetit një formë të shëndoshë qeverisjeje dhe në këtë kontekst përsëri shembulli më i përkryer është Pejgamberi (a.s.). Ai (a.s.), megjithëse i Dërguar i Allahut, të gjitha vendimet i merrte duke u këshilluar me shokët. Këtë mënyrë ua urdhëroi shokëve dhe gjithë besimtarëve. Në këtë kontekst, i urdhëroi besimtarët t'i bindeshin drejtuesit dhe të mos krijonin anarki.

Një tjetër aspekt i rëndësishëm i mësimave të Pejgamberit (a.s.), është dashuria dhe uniteti midis besimtarëve. Për t'ia arritur kësaj, së pari dha shembullin e vet në marrëdhënie me të tjerët. Ai tregoi dashuri dhe dhembshuri për të varfrit, të dobëtit, jetimët dhe nxiti edhe sahabët të tregonin respekt dhe dashuri për këtë grup njerëzish. Përmes veshjes së bukur dhe pastërtisë, Ai u bë shembull për sahabët. Këto mësimave janë shembull në çdo kohë dhe çdo vend për besimtarët që dëshirojnë lumturinë në këtë botë dhe tjetrën.

Medreseja e Madhe e Gjakovës, vatër e dijes



Ibrahim Sherifi, i lindur me 14.02.1997 në Shkup, u regjistrua në Shtator të vitit 2011, në Institutin tonë të Hifzit në Gjakovë. Ai për një periudhë kohore rekord, një vit e gjashtë muaj, më saktë, në Janar të vitit 2013, përfundoi hifzin (Mbajtjen përmendsh të Kuranit). Gjithashtu, brenda kësaj periudhe përfundoi me sukses të lartë edhe klasën e dhjetë të medresesë së mesme "Isa Beu" në Shkup. Qysh në rininë e hershme, në pranverat e jetës së tij, Ibrahim Sherifi mori edukatën fetare nga familja. Vullneti dhe puna e tij e palodhshme vetëm se ia përforcoi qëndrueshmërinë dhe besimin në të gjitha nivelet mësimore.

Në shkollën fillore, ishte një nxënës i shkëlqyer. Dallohej nga të tjerët edhe për qëndrimin e tij stoik ndaj të papriturave, sepse kishte vetëm një synim: besimin. Kënga e tij ishin vargjet kuranore, që i pëshpëriste përditë me vete.

Gjyshi i tij, siç duket, kishte treguar një kujdes të veçantë për të, sepse ai vetë ishte hafiz i Kuranit. Në shumë raste plaku i urtë, si mik i Kosovës që ishte, e vizitonte Kosovën shpesh dhe qëndronte me muaj të tërë në anët e Rrafshit të Dukagjinit. Me të dëgjuar se në Gjakovë ishte themeluar Instituti i Hifzit, vendosi ta dërgonte nipin e tij në këtë vatër të dijes hyjnore, ku edhe i plotësohet dëshira. Ibrahim regjistrohet në Institutin e Hifzit në Medresenë e Madhe të Gjakovës. E fillon dhe e mbaron atë për një periudhë shumë të shkurtër prej 17 muajsh, ku as ai vetë nuk e ka besuar se po bëhej hafizi i parë në Shkup pas dyzet viteve.

Nga kjo vatër të dijes kaluan edhe një numër i konsiderueshëm nxënësish nga të gjitha trojet shqiptare. Në vitin 2009 janë diplomuar dymbëdhjetë hafizë të rinj. Ndërkohë që 6 muaj më pas, diplomohen edhe grupe të tjera nxënësish. Në vitin 2012 u çertifikuan tre hafiz të rinj:

1. Ibrahim Sherifi nga Shkupi
2. Burhan Islami nga Gjilani
3. Gëzim Shuku nga Vushtrija

Të gjithë ne falënderojmë Këshillin e Bashkësisë Islame të Kosovës, Shoqatën Istanbul dhe mbarë stafin e saj drejtues. Zoti ia shpërbleftë me të mira mundin e secilit që ka kontribuar për këtë çështje...

Amin!

Drejtoria e Medresesë së Madhe, Gjakovë

A janë fetarë njerëz të tillë?

Muhamed El-Gazali

I urrej njerëzit e vrazhdë dhe të egër. Sikur ndonjëri prej tyre të ishte tregtar dhe unë të kisha nevojë për të blerë tek ai, nuk do të shkoja kurrë në dyqanin e tij. Dhe, sikur të ishte nëpunës e unë të kisha nevojë për të, përsëri nuk do të shkoja në zyrën e tij. Por fatkeqësisht e madhe është atëherë kur ai është imam namazi apo hatib xhumaje ose aktivist në thirrje (davat). Me të vërtetë, ai është fitne e gjallë, që ripërtërihet e ta nxin shpresën.

Në qoftë se feja nuk është sjellje e bukur, fytyrë e qeshur, shpirt tolerant, fqinjësi e mirë dhe jetë tërheqëse, çfarë është ajo?

Në qoftë se feja nuk është nevojë për Allahun, përgjërimit i përhershëm përpara pranisë së Tij, lutje për mëshirën e Tij të madhe dhe aspiratë që mirësia e Tij të përfshijë tërë njerëzit dhe botën mbarë, çfarë është ajo?

Lëvizja e disa namazlinjve për t'u rreshtuar në saf ngjan sikur po lëviz mali! Dhe disa predikues (vaizë) flasin sikur vetëm ata janë të pagabueshëm dhe njerëzit, përveç tyre, janë gjynahqarë! Ja, djaloshi i ri e mendon veten e tij kujdestar hyjnor për ta rregulluar njerëzimin, duke i vështruar të mëdhenjtë dhe të vegjlit me një shikim zhbirues guximtar.

Nuk ka dyshim që zemra e ashpër dhe kulti vetjak i tepruar janë argumenti më i qartë i zemërimit të Allahut dhe largimit nga rruga e Tij e drejtë, siratun mustekim... është e lehtë që njeriu të veshë rrobat e ibadeteve mbi trupin e ndotur dhe brendësinë plot të meta.

Sikur një njeri t'i njihete të metat e mia dhe t'i mbulononte ato, pastaj të vinte tek unë për të m'i treguar gabimet, e të më kthente tek Zoti im, patjetër do ta

kisha falënderuar dhe do të isha lutur për të! Sepse ai më ka bërë një punë të mirë dhe Allahu e mëshiroftë atë njeri që m'i tregon të metat e mia.

Unë frikësohem për veten time dhe për njerëzit nga ulëritësit, demaskuesit, shpirtligjtë, që u rrinë në pritë gabimeve për t'u hedhur ndaj njerëzve, ashtu siç hidhet ujku ndaj deleve. Ai, në pamje të jashtme duket se është xheloz i së drejtës dhe brenda tij është egërsirë, ku devotshmëria nuk ia ka shkurtuar kthetrat dhe imani nuk ia ka larë turpin dhe as nuk e ka pastruar.

Dikur, në kohë të vjetra, havarixhët kanë ecur në këtë rrugë. Historia na tregon se Amare ibn Kard, doli në luftë dhe qëndroi duke luftuar sa ia kishte shkruar Allahu, pastaj vendosi të kthehej dhe duke iu afruar Ehvazit në Persi, dëgjoji ezanin dhe u nis andej nga i erdhi zëri për të falur namazin me xhemat. Kur mbërriti, zbuloi se ata ishin ezarikë, fraksion i havarixhëve, të cilët i konsideronin emevitët qafirë (jobesimtarë) dhe kush luftonte përkrah jobesimtarëve edhe ai ishte jobesimtar! Me ta parë këtë komandant të madh në mesin e tyre, i thanë:

- Çfarë të ka sjellë këtu, o armik i Allahut?
- A nuk jeni vëllezërit e mi?
- Ti je vëlla i shejtanit, patjetër do të të vrasim!
- Përse nuk bëheni razi me mua për atë që i Dërguari i Allahut u bë razi ndaj meje?
- Me çfarë ishte razi për ty?
- Shkova tek ai, ndërkohë që unë isha jobesimtar (qafir), dëshmoja që nuk ka zot tjetër, përveç Allahut dhe se ai është i Dërguari i tij dhe më la të lirë...!

Por, havarixhët e morën dhe e mbytën!.

Nën moton islame ka njerëz që nuk zotërojnë aftësi kuptimi dhe nuk kanë aspak edukim, mashtrohen me lexime, oratori e me kundërshtime në disa situata dhe e shohin fenë si pronë të tyre, ndërsa mohimin (kufrin) pronë të kundërshtarëve, duke lejuar derdhjen e gjakut, shkatërrimin e pasurisë dhe nderit të tyre.

Ky nuk është Islam dhe me këto mënyra nuk i shërbejnë asnjë feje, prej çfarëdo lloj feje qofshin.

Përktheu nga arabishtja
Lavdrim Hamja



Familja profetike

Jeta bashkëshortore e Profetit Muhamed (Paqja doftë mbi të)

Altin Torba

Të gjitha gratë e Profetit (a.s.), me të cilat ai lidhi kurorë konsiderohen nëna të myslimanëve.

Beqaria e Muhamedit (a.s.), ishte e dëlirë dhe larg çdo të mete. Ajo zgjati deri në moshën 25- vjeçare, ku zë fill jeta e tij bashkëshortore përmes martesës me Hadixhen (r.a.), një grua e ve, fisnike, e pasur dhe 15 vjet më e madhe se ai, me të cilën Muhamedi (a.s.) bën një jetë ideale për 25 vite. Prej këtyre, 15 vite do t'i takonin kulmit të rinisë së Profetit (a.s.) dhe kohës para se atij t'i zbriste Shpallja Hyjnore, ndërsa 10 vitet e tjera do t'i takonin mes-moshës dhe 10 viteve të para të profetësisë.

Hadixha (r.a.), ndërroi jetë në moshën 65- vjeçare dhe rreth një muaj pas vdekjes së saj, Muhamedi (a.s.), në të pesëdhjetat, martohet me Seuden (r.a.), një vejushë plakë, e shëndoshë, jo e lakmueshme, me pesë fëmijë. Bashkë me ish-bashkëshortin e saj kishin qenë prej myslimanëve të parë dhe pas vdekjes së tij ajo kishte mbetur te familjarët e saj idhujtarë në kushte jo shumë

të mira. Profeti (a.s.), martohet me të dhe ajo mbetet gruaja e tij e vetme përreth tre vjet e ca.

Ky është historiku i jetës bashkëshortore të Muhamedit (a.s.), në 30 vjet, deri në moshën 54 vjeçare, pas së cilës ai do të jetojë vetëm 10 vite të tjera dhe sigurisht që ky historik përbën një argument të mjaftueshëm kundër sharlatanëve që shpifin në lidhje me poligaminë e tij, ndërkohë që poligamia (martesa me shumë gra) është në fakt karakteristikë e thujtës të gjithë profetëve të martuar, gjë në lidhje me të cilën vetë Bibla thekson se Daudi (a.s.), kishte pasur 100 gra, kurse Sulejmani (a.s.), 300 gra dhe 700 skllave.

Në fakt, poligamia e Muhamedit (a.s.), e ardhur në çerekun e fundit të jetës së tij bashkëshortore – madje shumica e martesave i takuan 2-3 viteve të fundit të jetës së tij – vijnë si rezultat i disa cilësive të tij unike, prej të cilave mund të theksohen: dinjiteti i tij si bashkëshort dhe kryefamiljar, pasqyrimi i dispozitave të rëndësishme shariatike që kanë të bëjnë me gruan

muslimane në veçanti, por edhe me institucionin e familjes në përgjithësi; përkujdesi i tij social për vejëshat besimtare, sidomos për të mbeturat pa mbështetje; mbrojtja e reputacionit të krerëve të fiseve dhe përthithja e tyre në Islam, përmes martesës me bijat e tyre dhe krijimit të lidhjeve miqësore me ta etj.

BASHKËSHORTET E MUHAMEDIT (A.S.)

Muhamedi i ndershëm (a.s.), 15 vite përpara profetësisë, në moshën 25- vjeçare, për herë të parë në jetën e tij martohet me Hadixhen fisnike 40- vjeçare. Bashkëshortja më e vlerësuar tek ai, me të cilën jetoi 25 vite, e cila kishte lindur në vitin 68 para Hixhrit dhe ndërroi jetë në moshën 65 vjeçare, në vitin e 10 të profetësisë, në vitin 3 para Hixhrit, rreth 13 vite para se të ndërronte jetë Profeti (a.s.).

Pas rreth një muaji, pra në vitin e 10-të të profetësisë, në vitin 3 para Hixhrit, në moshën 50- vjeçare, ai martohet me gruan e dytë, Seude bintu Zem'a, një grua në moshë, e cila ndërroi jetë në vitin 54 Hixhri, rreth 43 vite pasi ndërroi jetë Profeti (a.s.).

Në vitin e parë Hixhri, në moshën 54 vjeçare, ai u martua me gruan e tretë, Aishe bintu Ebu Bekër, bashkëshorten e tij të preferuar, e cila kishte lindur rreth vitit 9 para Hixhrit. Ajo ndërroi jetë në vitin 58 Hixhri, rreth 46 vjet pasi ndërroi jetë Profeti (a.s.).

Në vitin 3 Hixhri, në moshën 56 vjeçare, ai martohet me gruan e katërt, Hafsa bintu Umar, i shoqi i së cilës kishte rënë dëshmor në Bedër. Ajo kishte lindur në vitin 18 para Hixhrit. Ajo ndërroi jetë në vitin 45 Hixhri, rreth 34 vjet pasi ndërroi jetë Profeti (a.s.).

Po në vitin 3 Hixhri, në moshën 56 vjeçare, ai martohet me gruan e pestë, Zejneb bintu Khuzejme, i shoqi i së cilës kishte rënë dëshmor në Bedër. Ajo kishte lindur në vitin 26 para Hixhrit dhe ndërroi jetë pasi jetoi vetëm 8 muaj me Profetin (a.s.), në vitin 4 Hixhri, rreth 7 vjet para se të ndërronte jetë Profeti (a.s.).

Në vitin 4 Hixhri, në moshën 57 vjeçare, ai martohet me gruan e gjashtë, Ummu (nëna e) Seleme, e quajtur Hind, i shoqi i së cilës kishte rënë dëshmor në Uhud. Ajo kishte lindur në vitin 28 para Hixhrit dhe ndërroi jetë në vitin 62 Hixhri, 51 vjet pasi ndërroi jetë Profeti (a.s.).

Në vitin 5 Hixhri, me një vendim hyjnor të ardhur në lidhje me anullimin e birësimit në Islam, në moshën 58 vjeçare, ai martohet me gruan e shtatë, Zejneb



bintu

Xhahsh, pasi atë e divorcoi Zejdi, ish i birësuar nga Profeti (a.s.), e cila lindi në vitin 33 para Hixhrit dhe që ishte gruaja e parë e tij që ndërroi jetë pas tij, në vitin 20 Hixhri, pra rreth 9 vjet pasi ndërroi jetë Profeti (a.s.).

Në vitin 6 Hixhri, në moshën 59 vjeçare, ai martohet me gruan e tetë, bijë e një prijësi, Xhujevrie bintul Harithe, pasi i shoqi vritet në Betejën Benu el Mustalik, ku ajo zihet robëreshë, pranon Islamin dhe martohet me Profetin (a.s.). Ajo kishte lindur në vitin 14 para Hixhrit dhe ndërroi jetë në vitin 56 Hixhri, rreth 45 vjet pasi ndërroi jetë Profeti (a.s.).

Në vitin 7 Hixhri, në moshën 60 vjeçare, ai martohet me gruan e dhjetë, Umu Habibe bintu Ebi Sufjan, e divorcuar nga i shoqi, i cili u bë i krishterë në Abisini. Ajo lindi në vitin 25 para Hixhrit dhe ndërroi jetë në vitin 44 Hixhri, rreth 33 vjet pasi ndërroi jetë Profeti (a.s.).

Po në vitin 7 Hixhri, në moshën 60 vjeçare, ai u martua me gruan e njëmbëdhjetë, Safije bintu Hujej ibën Akhtab-it, prej hebrejve të fisit Benu Nadir, pasardhës të profetit Harun (a.s.), një e ve i shoqi i së cilës ishte prej të vvarëve të Khajberit, pranon Islamin dhe martohet me Profetin. Ajo kishte lindur në vitin 10 para Hixhrit dhe ndërroi jetë në vitin 50 Hixhri, rreth 39 vjet pasi ndërroi jetë Profeti (a.s.).

Po në vitin 7 Hixhri, pas Umras së Kadasë, në moshën 60 vjeçare, martohet me gruan e dymbëdhjete, Mejmune bintu el Harithe, 36 vjeçare, gruaja e ve që ia dhuroi veten e saj Profetit (a.s.), bashkëshortja e

fundit e tij, e cila kishte lindur në vitin 29 para Hixhrit dhe që ndërroi jetë në vitin 51 Hixhri, rreth 40 vjet pasi ndërroi jetë Profeti (a.s.).

PREJ ROBËRESHAVE TË TIJ ISHIN:

Rajhana, prej hebrenjve të fisit Benu Kurejdha, bie robëreshë, i vritet i shoqi, pranon Islamin, merret nga Profeti (a.s.), në vitin 6 Hixhri dhe ndërroi jetë në vitin 10 Hixhri, kur Profeti kthehet nga Haxhi i Lamtumurës, rreth 1 vit para se ai të ndërronte jetë.

Maria egjiptiane, që i dhurohet Profetit (a.s.), në vitin 7 Hixhri, nga El Mukaukis, patriarku i Egjiptit, e cila ndërroi jetë në vitin 16 Hixhri, rreth 5 vite pasi ndërroi jetë Profeti (a.s.).

Profeti (a.s.), ndërroi jetë duke lënë pas vetes nëntë nga bashkëshortet e tij: Seuden, Aishen, Hafsen, Umu Selemen, Zejneb bintu Xhahshin, Umu Habiben, Xhuejrijen, Safijen dhe Mejmunen (r.a.).

E vetmja grua e Profetit (a.s.), e cila ishte shumë e re dhe e pamartuar më parë, ishte Aishja (r.a.), e cila, e edukuar në familjen madhështore të Ebu Bekër es Siddikut dhe e pajisur me kapacitete të mëdha e me një nxënie të rrallë, sidomos falë moshës së saj të re, jeton rreth 10 vite me Profetin dhe ndërroi jetë rreth 46 vite pas tij, duke u shndërruar në nxënësen dhe transmetuesen më të madhe të akademisë profetike, jo vetëm në lëmin e çështjeve sheriatike të gruas dhe jetës familjare, por edhe më gjerë.

FËMIJËT E PROFETIT (A.S.)

Muhamedi (a.s.), ishte babai i shtatë fëmijëve, gjashtë të parët prej të cilëve kishin nënë Hadixhen dhe i fundit kishte nënë Marien egjiptiane:

El Kasimi, më i madhi dhe i pari prej fëmijëve të Profetit (a.s.), i cili ndërroi jetë në Mekë në moshë të vogël;

Zejnebja, lindi pas El Kasimit, 10 vjet para profetësisë, kur Profeti (a.s.), ishte rreth 30 vjeç, në vitin 23 para Hixhrit. Ajo martohet me Ebu el As ibën Rabia, i cili e pranoi Islamin pasi Zejnebja shkoi në Medinë, me të cilin pati një vajzë që quhej Umame – mbesa e Profetit (a.s.), që e pati mbajtur në qafë teksa po falej në xhami. Ajo u martua dhe pati dy palë fëmijë. Zejnebja ndërroi jetë në vitin 8 Hixhri rreth moshës 30 vjeçare, afërsisht 3 vite para se të ndërronte jetë Profeti (a.s.).

Abdullahu, që thirrej ndryshe Et Tahir dhe Et Tajib, i cili lindi pas Zejnebit dhe ndërroi jetë në moshë të

vogël pas El Kasimit;

Rukija, lindi pas Abdullahut, teksa Profeti (a.s.), ishte 33 vjeç. Divorcohet para Hixhretit nga njëri prej djemve të Ebu Lehebit, pastaj martohet me Uthmanin dhe të dy bashkë emigrojnë dy herë në Abisini. Lindi me të Abdullahun, që ndërroi jetë në moshën 6 vjeçare; Rukija ndërroi jetë në vitin 2 Hixhri, gjatë luftës së Bedrit, në moshën afërsisht 20 vjeçare, rreth 9 vite para se të ndërronte jetë Profeti (a.s.).

Umu Kulthumi, lindi pak vite pas Rukijes, divorcohet para Hixhretit nga njëri prej djemve të Ebu Lehebit. Pas vdekjes së të motrës, në vitin 3 Hixhri, ajo martohet me Uthmanin, me të cilin nuk pati fëmijë; Umu Kulthumi ndërroi jetë në vitin 9 Hixhri në Medinë, rreth 2 vite para se të ndërronte jetë Profeti (a.s.).

Fatimja, lind pas Umu Kulthumit, afërsisht 2 vite para profetësisë, në vitin 15 para Hixhrit, teksa Profeti (a.s.), ishte rreth 38 vjeç. Martohet me Aliun në vitin 2 Hixhri,

lind me të El Hasanin, El Husejnin, Umu Kulthumin dhe Zejneben dhe ndërroi jetë në muajin Ramazan të vitit 11 Hixhri, rreth moshës 26 vjeçare, afërsisht 6 muaj pasi ndërroi jetë Profeti (a.s.). Ajo ishte vajza e tij më e veçantë, një nga katër zonjat e Xhenetit dhe qenë pikërisht dy djemtë e saj, El Hasani dhe El Husejni ata që përbëjnë vijimësinë e linjës së familjes profetike, prej të cilëve do të vijë edhe Mehdiu.

Gjashtë fëmijët e parë të Profetit (a.s.), kishin nënë Hadixhen, e cila me dy burrat e parë të saj kishte vetëm

dy vajza, që të dyja me emrin Hind. Katër vajzat e Profetit (a.s.), e arritën epokën e Islamit; emigruan në Medinë; u martuan që të katra; patën fëmijë vetëm tre prej tyre, konkretisht Zejnebja, Rukija dhe Fatimja; tre të parat ndërruan jetë para Profetit (a.s.), kurse Fatimja ndërroi jetë pas tij.

Ibrahimi, i biri i Mariës egjiptiane, i cili lindi në Medinë, në vitin 8 Hixhri, teksa moshë e Profetit (a.s.), ishte rreth 60 vjeç; Ibrahimi i vogël ndërroi jetë pas vdekjes së Zejnebes, në të njëjtin vit që ndërroi jetë Umu Kulthumi, në vitin 9 Hixhri, rreth moshës 18 muajsh, afërsisht 2 vite para se të ndërronte jetë Profeti (a.s.).

Falënderuar qoftë Allahu i Lartësuar, i cili na dërgoi këtë Profet të ndritur për të na nxjerrë nga errësira në dritë.

Paqja, mëshira dhe lavdërimi i Allahut qoftë mbi Muhamedin (a.s.), familjen e tij, shokët e tij dhe të gjithë ata që kanë ndjekur dhe do të ndjekin rrugën e tij deri në Ditën e Fundit!





Jeta

Festim Rizanaj

Ndoshta prisni që të bëj përshkrimin e ndonjë ngjarjeje me personazhe që luajnë teatër! Por në fakt, në këtë shkrim kam vendosur të flas për rrugëtimin me titull "Jeta". Një ngjarje unike në të cilën të gjithëve na jepet nga një rol. Prej momentit kur kemi lindur, secili mundohet që rolin e vet ta luajë në mënyrën më të mirë, deri sa të mbyllen perdet e kësaj jete dhe të hapen perdet e tjetrës.

Disa e realizojnë këtë jetë si një komedi romantike, dhe mësojnë të dashurojnë, kurse disa të tjerë e realizojnë atë si dinamike e aktive, dhe mësojnë ta përballojnë... Llojet e ndryshme të mënyrave të jetesës na mësojnë secila nga një fshehtësi të vetën dhe na mbulojnë nga një mangësi tonën.

Një miku im thoshte: "Tema me të cilën më së shumti jam munduar në jetë, është dashuria! Nuk arrita ta gjej dozën e duhur të dashurisë dhe rashë në sprovë! Unë nuk dija të dashuroja, por Zoti më mësoi"! Kur ai m'i tha këto fjalë, fillova t'i shikoja njerëzit përreth dhe vëreja se secilit i është dhuruar një fshehtësi në jetën e tij.

Kur Zoti "prek" zemrat tona, na janë mjekuar mangësitë dhe tepritë, si dhe na është dhënë mundësia për t'i kuptuar ato. Njeriu, që përveç vetes shoqërohet edhe me të tjerët, e kupton këtë dhe është ngritur në një shkallë më të lartë.

Ndonjëherë, mendoj se aq shumë mërzitemi nga roli ynë, sa që nisim të përzihemi në shpirtrat e të tjerëve, për të shijuar sa më shumë lloje të ndryshme jetësh. Duke u marrë me personalitetin e tjetrit, humbet vlerat e tua dhe vazhdimisht dëmton veten dhe i bën padrejtësi asaj. Jeto ashtu si u krijove, mos e ndrysho ecjen tënde! Ose nëse do të ndryshosh, atëherë ndiq udhëzimet e Atij që të ka krijuar, që t'i përmirësosh talentet

që ke. Ti je i veçantë, në këtë botë, nuk ekziston dikush tjetër krejt si ti, dhe njerëzit të duan kështu siç je, se kështu të formësoi Krijuesi yt. A ka një pikë ngopjeje? Unë besoj se në këtë jetë nuk ka! Çdo herë njeriu kërkon më shumë. Kur të arrijë në një vend, kërkon të vazhdojë edhe më tej. Sepse njeriu është udhëtar që kërkon të kthehet në atdheun e tij të vërtetë, në Xhenet. Po deri kur? Deri kur?

Tani jemi të rinj dhe po jetojmë në një kohë, kur jeta është bërë shumë dinamike dhe na pret një jetë e tërë përpara. Neve na duket, sikur para kemi edhe shumë kohë që do të marrim frymë, nganjëherë na duket se nuk ka fund kjo kohë. Duke parë që jeta po na kalon shumë shpejt, duhet t'i japim rëndësi çdo frymëmarrjeje... Çdo dhimbjeje të jetuar shtrojani këtë pyetje: "Cilat janë shkaqet e të jetuarit të saj?"... Dhe, kështu shpresa nuk do t'ju humbë dhe një ditë me respektin më të madh do të lidheni me Atë që ju ka krijuar dhe botës suaj shpirtërore do t'i jepni jetën e vërtetë.

Një dijetar e përkufizon jetën kështu: "Gjëja më e rëndësishme në të gjitha gjërat e krijuara, është jeta, kurse detyra më e rëndësishme është shërbimi ndaj saj. Detyra më e rëndësishme ndër detyrat e jetës, është që pikërisht këtë jetë, që do të marrë fund, ta transformojmë në një jetë të pafundme."

Një ligj thotë: "Bëhu njeri sa një mijë njerëz e, nëse nuk mundesh, qëndro një njeri e mos u bëj gjysmë njeriu."

Mos u frikësoni! Luajeni natyrshëm rolin tuaj, mos kujtoni se jeta juaj është e pavlerë. Sepse, Ai që ua ka dhënë atë, ju ka vlerësuar dhe ju ka dhënë vend dhe kohë në këtë ngjarje... Kuptojani vlerën, shijojani shijen dhe pagujeni këtë me falënderimet ndaj Tij...

Miqësia mes Njeriut dhe Kuranit

Semra Kyrin Çekmegll

Shpallja hyjnore cakton Pejgamberin, cakton po ashtu të gjitha ndodhitë në univers, cakton rrjedhën, kuptimin dhe rëndësinë esenciale të përmbajtjes së këtyre ekzistencave. Allahu Teala i ka krijuar të gjitha krijesat. Kështu, atyre u ka dhënë edhe nga një detyrë. Çdo krijesë e bën punën e saj pa asnjë mangësi. Secila prej tyre e vazhdon jetën e saj, duke ndihmuar dhe plotësuar tjetrën, brenda një sistemi e rregulli.

Toka ka nevojë për farën, fara për ujin, çdo krijesë ka nevojë për tjetrën, ndërsa njeriu ka nevojë për të gjitha këto. Sikur pemët të ishin lapsa dhe detet bojë, nuk do të mjaftonin për të treguar këtë krijim e ekzistencë.

Ai që guxon ta bëjë këtë, nuk ia del dot mbanë.

Përse? Për kë janë krijuar të gjitha këto krijesa? Kush e njuh dhe kush mund ta shpjegojë këtë krijim mahnitës? Çfarë është kjo ekzistencë? Njeriu është ai i zgjedhuri ndërmjet të gjitha këtyre krijesave. Çdo gjë është në shërbimin e tij, çdo gjë ka marrë kuptim nga ai, është vepra artistike e pashoqe e Allahut Teala, i krijuar në formën më të mirë. Atij i janë mësuar të gjithë emrat e gjërave dhe i është dhënë urtësia?

Ata që ua mësojnë njerëzve parimet, janë pejgamberët e zgjedhur ndërmjet të gjithë njerëzve të krijuar.

Të gjitha pyetjet gjejnë përgjigje, duke pranuar pejgamberët. Allahu Teala na ka njoftuar nëpërmjet tyre për shpirtat, për krijesat në qiej dhe për botën e dukshme dhe të padukshme. Njeriu është mëkëmbës në tokë, për shkak se është krijuar me cilësitë, si mendja, konceptimi dhe vullneti.

Kur njeriu, që është zgjedhur ndërmjet të gjitha krijesave të tjera, t'u besojë pejgamberëve, në mesin e njerëzve, atëherë e njuh Krijuesin e tij, e kupton se sa e vlerëson Ai, e mëson se me çfarë punësh lartësohet vlera e njerëzimit dhe e koncepton se do të humbë vlerë,

nëse lë pas dore disa amanete...

Kur njeriu, që është krijuar në formën më të mirë, i refuzon pejgamberët, e humb privilegjin dhe te Krijuesi bie në një shkallë aq të ulët, saqë nuk mund të krahasohet me asnjë krijesë, sepse natyrshmëria e njeriut është "Ahseni Takvim". Për fat të keq, më vonë ai e mbuloi natyrshmërinë me dëshirat e pasionet vetjake dhe e neglizhoi të vërtetën e krijimit të çdo gjëje dhe qëllimin kryesor të krijimit.

Me këtë gjendje, edhe nëse standardi i jetesës së njeriut është në shkallën më të lartë, edhe nëse bën jetën më të mirë e më të rehatshme, në të vërtetë ai është prej të mashtruarve dhe prej të humburve. Njerëz të tillë kanë harruar se kanë për t'u kthyer në botën tjetër. Ashtu si foshnja nuk ka mundësi të vendosë për të ardhur në këtë botë, edhe njeriu përballë vdekjes nuk ka asnjë mundësi ndikimi. Kjo është një e vërtetë që nuk mund ta mohojë askush. Në Kuranin Fisnik, Allahu i Madhëruar e shpreh kështu gjendje e njerëzve që kanë neglizhuar argumentet e Tij:

"(Allahu do t'u thotë): Tashmë na vini veç e veç, ashtu siç ju krijuam herën e parë, duke lënë pas vetes ato që ju patëm dhuruar. Ne nuk po i shohim me ju ndërmjetësuesit tuaj, për të cilët pretendonit se ishin ortakët e Allahut. Midis jush janë shkëputur të gjitha lidhjet dhe ajo tek e cila shpresonit, ju ka lënë në baltë." (En'am, 94.)

"O njeri! Dëgjoje zërin e natyrshmërisë tënde dhe atë që të thërret për tek ajo. Kjo thirrje është për njerëzit e mençur. Njeriu, i cili është krijuar nga asgjëja!"

Edhe pse ke fuqi për të bërë shumë gjëra me vullnetin tënd, prapëseprapë nuk mund t'i largosh fatkeqësitë e padëshiruara, ashtu siç nuk mund të arrish çdo gjë që dëshiron.

"O njeri! Ç'të mashtroni ty që nuk i besove Zotit tënd bujar, i cili të krijoi ty, të dha përmasa të rregullta dhe të harmonizoi dhe, që të ka mbrojtur në çfarëdo forme që ka dashur?" (Infitar, 6-8)

Tani le të mendojmë! A nuk arrihet qetësia shpirtërore dhe siguria, nëse do të përjetohej Kurani dhe zbatoheshin urdhrat e tij? Sado që të ketë zulumqarë dhe injorantë, që i mbyllin veshët ndaj thirrjes së Allahut të Madhëruar, ata nuk do të guxojnë të bëjnë ligësi.

Të gjithë i dimë përpjekjet e atyre që luftojnë pa mëshirë, për t'i arritur shpresat dhe dëshirat e tyre të përkohshme në këtë botë, në vend që të luftojnë për zbatimin e Kuranit Fisnik dhe njohjen e sundimit të drejtësisë së tij...

Ai që nuk ka frikë nga Allahu, mendon vetëm për interesat e kësaj bote të përkohshme. Për këtë arsye, i del kundër çdo gjëje që mund të jetë pengesë për interesat dhe pasionet e tij. Sigurisht, se këtë do ta bëjë me mbështetësit që ka pranë. Kurani Fisnik e konkretizon këtë me shembullin e Faraonit, Hamanit, Karunit dhe Bel'ami.

Domethënë, Faraonin e mbante në këmbë Hamani, që ishte fuqia ushtarake, Karuni që ishte fuqia ekonomike dhe Bel'ami që jepte fetva sipas interesave të tij.

Botën që po prishet, po shkatërrohet dhe që po mbytet çdo ditë e më shumë në ndjenja kafshërore, që

po e drejtojnë njerëz të paaftë e që po e kthejnë në një kaos, mund ta shpëtojë vetëm bashkësia që ndërton Kurani Fisnik. Ata të cilët i besojnë një ndërtimi të tillë, duhet ta lexojnë Kuranin sikur t'u ishte shpallur atyre, ta përsosin moralin me dispozitat e tij dhe të paguajnë çfarëdo lloj çmimi në atë rrugë.

Pra, duhet të punojmë si sahabët e nderuar dhe i Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, i cili, siç i premtoi njerëzimit siguri, drejtësi dhe xhenet, po ashtu nuk u dha rëndësi propozimeve të femohuesve që ngelën të paaftë përpara tij.

Në Kuranin Fisnik, Allahu Teala thotë:

"Allahu u ka premtuar atyre prej jush, që besojnë dhe që bëjnë vepra të mira, se do t'i bëjë mëkëmbës në Tokë, ashtu si i ka bërë ata para tyre dhe që do t'ua forcojë fenë e tyre, me të cilën Ai është i kënaqur dhe që frikën do t'ua shndërrojë në siguri. Le të më adhurojnë Mua e të mos më shoqërojnë asgjë (në adhurim). Sa për ata që, pas kësaj, mohojnë (besimin), pikërisht ata janë mëkatarët." (Nur, 55)

O njeri, që të ka mëshiruar Allahu! O njeri, që je ngritur në miraxh duke i bërë sexhde Allahut Teala me plot bindje! Kthehu në originalitetin tënd! Kërko mbrojtje nga Zoti, në mënyrë që të arrish krenarinë, nderin, virtytin dhe lumturinë e përhershme! Kjo rrugë nuk është qorrsokak, por një rrugë që të shpie në përjetësi.



TË KUPTOS

Nuredin Jëlldëz

Allahu qoftë i kënaqur me ta!

Ata të gjithë fituan kënaqësinë e Allahut, që prej atij, i cili besoi i pari dhe mori nderin të ishte sahabi i parë e deri te sahabi që ndërroi jetë i fundit. Ata arritën suksese në kohën më të vështirë dhe në punët më të rëndësishme. Dëshën dhe u deshën. Me ta u hodhën themelet e para. Jetuan me një besim të patundur. Mendimet e huaja brenda vetes i shkulën nga rrënjët dhe i hodhën. Ndërsa nga jashtë nuk futën asgjë në besimin e tyre. Ata u takuan me Zotin me një besim krejtësisht të pastër.

Allahu qoftë i kënaqur me ta!

Ata i zbatuan të parët ajetet që zbritën. Duke qëndruar përreth Resulullahut (a.s.) dhe duke ndjekur gjurmët e tij në mënyrën më të përsosur, na lanë si trashëgimi një rrugë të ndriçuar. Falë përpjekjeve të tyre, netët e jetës sonë u ndriçuan po aq sa ditët. Për shkak se u nderuan me Islam, pas një periudhe injorance të thellë në jetën e tyre, përqafimi me Islamin te ata ishte më i sinqertë dhe më real se sa ai i brezave, të cilët e gjetën Islamin si fenë e shtëpisë ku lindën.

Myslimanët e të gjitha kohëve janë të detyruar t'i kuptojnë sahabët. Aq sa kuptohen ata, aq arrihet edhe ëmbëlsia e të qenit mysliman. Nëse nuk kuptohen ata, nuk kuptohet as Islami.

Kur mendojmë vetëm vështirësitë dhe vuajtjet që ata kaluan, në një farë mënyre na ngushtohet edhe

hapësira që duhet të marrim si shembull. Po, ata e jetuan fenë me njëmijë e një vuajtje. Torturat dhe kurbeti u bënë jeta e tyre e përditshme. Ata shijuan llojet e ndryshme të varfërisë. Madje, pranuan të ndaheshin edhe prej familjeve të tyre, për hir të fesë së Allahut.

Marrja shembull e sahabëve është e rëndësishme për të gjitha çështjet e jetës sonë fetare. Prandaj dhe nuk është e drejtë, që kjo temë të kufizohet vetëm me emigrimin, varfërinë, durimin, adhurimin e natës, dhurimin, xhihadin dhe bindjen. Sahabët fisnikë janë njerëz, që kanë arritur të bëjnë një jetë në përputhje me kënaqësinë e Allahut. Prandaj dhe për t'i kuptuar ata, kërkohet përpjekja për të bërë gjithçka që duhet për një jetë në përputhje me kënaqësinë e Allahut.

Kushti i parë për t'i kuptuar ata me një logjikë, e cila do të ndikojë tek ne, është pranimi i faktit, se "sahabët kishin standard njerëzor". Asnjë sahab, nuk është rezultat i ndonjë mrekullie. As Ebu Bekri (r.a.) dhe as Uahshi (r.a.), nuk ishin frut i ndonjë mrekullie. Ata nuk hynë në këtë rrugë me ndonjë dua apo me shtytjen e ndonjë dore të padukshme. Cilësia e tyre thelbësore ishte se, ndërkohë që jetonin në standartet njerëzore, ata garuan me melekët. Kjo është ajo që i bën të veçantë ata. Nëse do të ishte e mundur të mbështeteshin e të lartësoheshin me dua, para çdokujt tjetër, kjo do të bëhej për xhaxhain e Profetit tonë (a.s.), Ebu Talibin. Në fakt, nuk mund të themi se asnjë nuk mori dua. Kishte edhe prej atyre për të cilët



SH SAHABËT

u bë dua, por ajo dua ishte për një çështje të caktuar dhe jo për të arritur atë nivel të lartë.

Këtë cilësi të tyre, pra vullnetin dhe meritën për të garuar me melekët, duke qenë në standardet njerëzore, mund ta shohim në çdo fushë të jetës së tyre. Nëse ia ndjekim gjurmët, do të kuptojmë, se mund të marrim shembull edhe prej aftësive të tyre, të cilat ngelen jashtë gradës "sahabi". Në të vërtetë, nuk është e mundur të bëhemi sahabë, por padysim që ne mund të bëhemi Ebu Bekri i kohës në të cilën jetojmë. Çdo rrugë është e hapur për të nxjerrë në dritë një Ebu Bekër. Feja është e njëjta fe dhe kërkesat janë po të njëjtat kërkesa. Të gjithë e zotërojnë nefsin (egon), prej robërisë së të cilës Ebu Bekri (r.a.) arriti të shpëtonte me sukses. Ai që tregon sinqeritet në realizimin e atyre që bëri Ebu Bekri (r.a.) dhe afrohet vazhdimisht me sinqeritetin e tij, do të thotë se është në rrugë të drejtë. Të njëjtën gjë mund të themi për të gjithë sahabet, deri te i fundit.

Kur të shpëtojmë nga të imagjinuarit e tyre (sahabëve) vetëm duke vringëlluar shpatat në Uhud dhe të mundohemi t'i shohim edhe duke shtypur nefsin me vullnetin e tyre, atëherë do të kuptojmë ndikimin e tyre të vërtetë.

Ashtu siç emigruan prej atdheut të tyre, Mekës, ata ditën të emigrojnë edhe prej lakmisë ndaj mallit e pasurisë. Kur Profeti (a.s.), tha se e kishte vënë kamatën nën këmbët tij, ata shfaqën vullnetin dhe

aftësinë për të mos iu afruar kurrë më kamatës. Kur Allahu i sprovoi me të gjitha ngjyrat e jetës, ata bënë atë që duhej në çdo sprovë. Ne do t'i gjejmë ata si sahabë kudo që t'i kërkojmë, në durim e në dhurim, në bindje e në adhurim, në dorëzim, në besnikëri etj. Ata shfaqën të njëjtën nivel edhe gjatë adhurimeve të natës, edhe në xihadin (luftën) e tyre gjatë ditës. E njëjta gjë ishte edhe me jetën e tyre bashkëshortore, edhe me identitetin e tyre shoqëror. Ata nuk bënë asnjëherë ndarje midis natës dhe ditës. Këtë botë dhe botën tjetër, nuk i vunë kurrë në pozita të kundërta me njëra-tjetrën. Ata ishin Ebu Bekër, Omer, Othman, Ali... edhe nëse punët u shkonin mbarë, edhe nëse jo. Ata që ishin gjatë Ramazanit, po ata ishin edhe në muajt e tjerë para dhe pas tij.

Të kuptosh sahabët, është një gradë e lartë. Nëse nuk e arrijmë atë gradë, do të thotë se kur të shohim rrugën tonë, do të detyrohemi të shohim një rrugë të gjatë para nesh. Nëse vazhdojmë t'i shohim ata vetëm duke vringëlluar shpatat e tyre në Uhud, do të thotë se ende nuk e kemi gjetur identitetin e tyre të vërtetë, të cilin duhet ta ndjekim. Por, nëse i shohim ata se sa të bindur e të dorëzuar ishin ndaj Sunetit të Profetit, se si e bënin kurban egon e tyre, se si falnin namazin dhe se si sillëshin në shtëpitë e tyre, do të thotë se kemi kapur imazhin e vërtetë që i pasqyron ata.

Allahu qoftë i kënaqur me ta!..

Plotësisht

Idris Arpat

Njeriu është një krijesë e përsosur. Përsosmëria e tij del në pah kur shtjellohet i tëri. Njeriu është i përsosur, por dora dhe këmba e tij nuk janë të tilla, veçmas. Njeriu i cili përbëhet prej duarve, këmbëve dhe zemrës, është i përsosur. Madje, nëse të gjitha pjesët e njeriut nuk janë bashkë, një prej pjesëve të tij apo disa prej tyre nuk mjaftojnë për të përcaktuar identitetin e tij. Njëri prej organeve më kryesore të njeriut është truri. Truri është në kokë, por koka pa të tjerat nuk e përfaqëson tërësisht njeriun. Njeriu është një tërësi. Kur ruhet kjo tërësi, del në pah ana e tij njerëzore.

Edhe feja jonë është një tërësi. Ajo përfshin çdo gjë që ka lidhje me nevojat e njeriut. Nëse njeriu merr frymë, ajo ia rregullon frymën. Nëse njeriu ha e pi, ajo ia përcakton ato, që duhet të hajë dhe të pijë. Nëse fle, ia sistemon gjumin. Fe është ajo, që me rregullat e saj, ia sistemon njeriut ecjen, të folurit dhe të shikuarit. Fe është ajo që e bën njeriu zot shtëpie kur hyn në shtëpi, dhe e bën të marrë frymë kur hyn në xhami. Fe është ajo që është e pranishme në mes të ditës, në errësirën e natës dhe e cila ka sjellë sisteme që funksionojnë në çdo kohë. Ajo fe, është sigurisht feja islame.

Islami është fe për njeriun. Për shkak se ajo është njëqind për qind fe për njeriun dhe është dërguar në përputhje të plotë me natyrshmërinë e tij. Ajo ka sjellë lehtësimin dhe dashurinë për një jetë ideale dhe kurrësesi nuk erdhi për t'ia vështirësuar atij.

Ashtu si nuk është e mundur të merret një pjesë nga njeriu dhe të shfaqet si "njeri", po ashtu nuk është e mundur të merret një pjesë prej fesë, Islamit, e cila është dërguar për njeriun dhe të paraqitet si "Islam". Islami e përfshin njeriun në çdo plan. Në një vend, ku njeriu gjendet si njeri, edhe Islami duhet të gjendet me të gjithë përfshirjen e tij, që të paraqesë mënyrat për shpëtimin e përhershëm. Në të kundërt, në pah del një Islam i lidhur duarsh e këmbësh. Ai Islam nuk është, as Islami i zbritur nga Allahu (xh.xh.) dhe as Islami që mund të japë zgjidhje.

Ne mund të flasim për faktorët e jashtëm që e shkatërrojnë tërësinë e Islamit. Po ashtu, mund të themi se kjo pjesë e Islamit ka mbetur pa u praktikuar, për shkak të këtij presioni apo

pengese të jashtme. Kjo mund të rregullohet me kalimin e një pjese të caktuar të kohës dhe mund të arsyetohet. Ndërsa myslimanët që besojnë në Islam, nuk kanë asnjë lloj justifikimi për të mos praktikuar ndonjë pjesë të tij. Pjesa e lënë pa praktikuar, për shkak të faktorëve të jashtëm, sigurisht se ka arsye të logjistikshme.

Nëse Islami kërkon që shtëpia të sistemohet sipas rregullave të tij, myslimani është i detyruar t'ia japë shtëpinë Islamit. Kjo nuk mund të bëhet duke ndarë dhomën e ndenjës apo ndonjë dhomë tjetër për të. Nëse shtëpia i jepet e tëra Islamit me dhomën e ndenjës, me kuzhinën dhe sidomos me dhomën e gjumit, atëherë myslimani mund të pohojë se ia ka dhënë shtëpinë fesë së tij.

Të njëjtën gjë mund të themi edhe për vendin e punës ku gjendet myslimani. Nëse Islami kërkon t'ia sistemojë edhe vendin e punës, administrimin e tij në të gjitha ditët e vitit, ai duhet t'ia lërë fesë. Faktikisht, të jesh mysliman, do të thotë të jesh një njeri i nënshtruar ndaj Allahut, do të thotë, t'ia lësh në dorë fesë administrimin dhe formimin e punës. Nëse këtë e kufizojmë gjatë muajit të Ramazanit apo vetëm për festa, do të thotë se feja është një mysafir i përkohshëm në vendin e punës së myslimanit.

Ne e kemi kusht që të gjithë kohën dhe energjinë tonë ta përdorim sipas fesë islame. Të gjitha mjediset tona duhet të sistemohen sipas saj. Të bëhesh mysliman, do të thotë t'i nënshtrohesh Allahut (xh.xh.). Nënshtrimi nuk bëhet duke zgjedhur.

Që nga ekonomia jonë e deri te pushimi, çdo gjë duhet të ngjyroset me Islamin dhe me dispozitat e tij në çdo vend dhe kohë. Siç nuk mund ta përfaqësojë një krah njeriun, edhe muaji i Ramazanit nuk mund ta shfaqë të gjithë fenë tonë, por vetëm një pjesë të saj. Nëse jemi të sjellshëm me shoqërinë, kjo nuk sjell mirësi, nëse nuk e shfaqim këtë cilësi edhe në shtëpi. Edhe namazi kështu është. Përderisa në portofol ka kamatë, namazi nuk është një faktor që tregon Islamin. Edhe për tespitë mund të themi të njëjtën gjë. Ne duhet të flasim bukur, aq sa bëjmë edhe tespih, që nënshtrimi ndaj Allahut të madhëruar të realizohet plotësisht.



Litëraturë e zgjedhura

Ferid Piku

Parasitë E PROFETIT

Zoti ynë na urdhëron në Kuranin famëlartë, duke thënë: **Çfarëdo që t'ju japë i Dërguari, merreni atë, e çfarëdo që t'ju ndalojë, hiqni dorë prej saj. Frikësojuni Allahut, sepse Allahu, dënon vërtet ashpër.** (Hashr, 7)

Figura e Profetit (a.s.), është madhështore. Sado të flasin gjuhët, sado të shkruajnë librat, ai mbetet madhështor, sepse të tillë e krijoi Zoti i gjithësisë.

Ai nuk ishte vetëm profet, nuk ishte vetëm njeri i madh, por ishte një vëllai i mirë, një shok i mirë, një edukator i jashtëzakonshëm.

Ishte nga ata njerëz, që kur e shikonte një të keqe, i digjej zemra dhe me urtësinë më të madhe e korrigjonte atë. Ishte nga ata njerëz, që kur pyetej për diçka të mirë, me zellin më të madh që mund të ketë ndonjë mësues, ia shpjegonte nxënësit më së miri atë që pyeste. Fjalët e tij ishin të pakta, por kishin kuptim të thellë. Kur dora e tij e butë vihej mbi supin e njërit prej shokëve të tij, fjalët që dilnin nga goja e Profetit (a.s.), futeshin thellë nëpër zemra e nuk harroheshin asnjëherë. E merrte shokun e tij veçmas dhe i fliste dy – tri fjalë. Ishin fjalë me peshë, sepse dilnin nga zemra e atij personi, që e donte çdo njeri. Këto porosi të vogla i mjaftonin shokut të tij për gjithë jetën. Me dy – tri fjalë ai e mësonte fenë e Zotit. Me dy – tri fjalë ruante besën dhe amanetin e Zotit.

Kam zgjedhur vetëm një nga porositë e Profetit (a.s.), një fjalë që Muhamedi (a.s.), ia tha njërit prej shokëve të tij, që donte shumë. Realisht ai i donte të gjithë shumë, por këtë e donte, sepse ishte nxënës i zgjuar dhe pyeste vazhdimisht. Ai ishte Muadh Ibn Xhebel (r.a.).

Muadh Ibn Xhebel (r.a.), e donte xhenetin dhe e kishte frikë xhehenemin. Ai tregon: "Kur e pashë një ditë Profetin (a.s.), vetëm, larg të tjerëve i afrova dhe i thashë:

-O Profet i Zotit! Kam një pyetje që s'më lë të fle natën dhe më ka shqetësuar shumë. Ma trego një punë që më fut në xhenet dhe më ruan nga zjarri! Vetëm kaq dua.

Profeti (a.s.), i cili shikonte besnikëri dhe sinqeritet tek Muadh iu përgjigj:

-O Muadh, ke pyetur për një gjë të madhe, por që me lejen e Zotit është e lehtë, për ata, që Zoti ua lehtëson. O Muadh, adhuroje Zotin dhe mos i bëj shok Atij! Fale namazin, jepe zekatin, agjëroje Ramazanin dhe bëje haxhin, nëse ke mundësi!"

Pastaj mësuesi e pyeti nxënësin e tij, sepse ishte nxënës besnik dhe i zellshëm:

-O Muadh, a ke dëshirë të t'i tregoj dyert e punëve të mira?

-Patjetër, o profet i Zotit – tha Muadh, - m'i trego.

Profeti (a.s.), vazhdoi:

-O Muadh! Agjërimi është mburojë, sadakaja i fik gjynahet si uji zjarrin. Fale namazin në mesin e natës.

Pastaj lexoi ajetin kuranor, ku Zoti thotë: **"Ata ngrihen nga shtrati, i luten Zotit të tyre me frikë e shpresë dhe japin nga ajo që iu kemi dhënë Ne. Askush nuk di se çfarë gëzimesh janë fshehur për ata (në jetën tjetër), si shpërblim për punët e mira që kanë bërë."** (Sexhde: 16-17)

Pastaj Profeti (a.s.), vazhdoi përsëri:

-O Muadh, a do ta dish kokën, shtyllën dhe kulmin e kësaj pune?

Muadh iu përgjigj:

-Patjetër, o Profet i Zotit.

Profeti (a.s.), tha:

-Koka është Islami, shtylla është namazi dhe kulmi është xhahadi në rrugën e Zotit.

Pastaj vazhdoi:

-O Muadh, a do ta dish kryesoren e të gjitha këtyre që të kam thënë?

-Patjetër, o Profet i Zotit.

Atëherë profeti (a.s.), kapi gjuhën e tij me dorë dhe tha:

-Mbaje fort këtë, o Muadh!

-O Profet i Zotit! A do të na marrë Zoti në llogari edhe për fjalët që flasim?

-Të pastë nëna, o Muadh, po a ka gjë tjetër që i fut njerëzit në zjarr më shumë se gjuha e tyre?¹

Këto ishin fjalët e mësuesit, fjalët e Profetit (a.s.), fjalë të vogla, por që lanë ndikim të madh në zemrën e Muadhit, prandaj ai ia thoshte këto fjalë çdo njeriu që takonte.

Çfarë ishin këto fjalë? E thënë shkurt, shqetësimi i Muadhit (r.a.), ishte shqetësimi i sahabëve. Ata nuk ishin njerëz të fjalëve. Flisnin pak e punonin shumë. Pyesnin pak e zbatonin shumë. Ata nuk i zinte gjumi natën nga shqetësimi: "Do të hyjmë në xhenet apo në zjarr". E kishin kuptuar situatën dhe ishin të sigurtë se e ardhmja e tyre ishte xheneti ose zjarri. Për këtë e pyeti edhe Muadhi (r.a.), Profetin (a.s.), për punën që të çon në xhenet. Profeti (a.s.), nuk i tha thjesht: "Bëj punë të mira", por i tha: "O Muadh, ti po pyet për një gjë të madhe."

A të duket e lehtë të hysh në xhenet e të ruhesh prej zjarrit? A nuk e di se Zoti i ka dërguar fetë për këtë çështje, profetët kanë ardhur për këtë çështje, librat kanë zbritur për këtë çështje. Zoti thotë në Kuranin famëlartë: "**Kush i largohet zjarrit dhe futet në xhenet, ai ka fituar.**" (Al' Imran, 185.)

Nuk është e lehtë të hysh në xhenet. Vallahi, është aq e vështirë, saqë kur melekët e panë xhenetin se me çfarë vështirësisht ishte rrethuar, thanë: "O Zot, askush nuk do të hyjë në xhenet". Por Zoti tha: "Do të hyjnë ata që i përveshin krahët për këtë dhe Unë do tua lehtësoj". Kush e do rrugën e mirë, sado e vështirë të jetë ajo, bëhet e lehtë me lejen e Allahut (xh.sh.), sepse e lehtëson Zoti i gjithësisë.

Kush e do rrugën e keqe, ajo është e lehtë dhe Zoti nuk ia vështirëson këtë, por në fund të gjithë do të kthehemi tek Allahu (xh.sh.), e do të japim llogari për atë që kemi punuar, e dijeni se Zoti nuk e do të keqen dhe nuk i bën padrejtësi askujt.

Profeti tha: "O Muadh! Adhuroje Zotin dhe mos i bëj shok Atij." Zoti të ka krijuar, të ushqen, të furnizon, të ka dhënë jetë. Mos i bëj shok Zotit, se atëherë ke bërë padrejtësinë më të madhe që mund të bëhet. Pastaj Profeti (a.s.), tha: "O Muadh, fale namazin, agjëroje Ramazanin, jepe zekatin dhe bëje edhe haxhin, nëse ke mundësi." Profeti (a.s.), nuk e la me kaq, por vazhdoi edhe më tej: "A do t'i dish rrugët e punëve të mira?" E tha këtë, sepse donte t'i tregonte nxënësit të tij se ka punë të mira që pak njerëz i bëjnë, por, nëse do që të hysh në xhenet, duhet t'i bësh.

Cilat janë këto punë?

AGJËRIMI - Profeti (a.s.), tha: "Të agjërosh nafile (vullnetarisht), është mburojë." Kur ushtari shkon në luftë, merr mburojën me vete. Po kështu, kush agjëron nafile, pra jo

1. Tirmidhiu, Ahmedi dhe Nesaiu. Tirmidhiu e vlerëson hadithin të pranuar, të vërtetë.



vetëm në muajin e Ramazanit, por edhe jashtë tij, ai mbron veten nga fjalët dhe punët e pahijshme. Agjërimi e mbron robin nga zjarri i xhehenemit.

Profeti (a.s.), ka thënë: "Kush agjëron vetëm një ditë për hir të Allahut (xh.sh.), Ai, e largon atë njeri 70 vite nga zjarri i xhehenemit."² Agjërimi është mburojë. Kush ka mundësi, le ta bëjë këtë punë, sepse Zoti do ta ruajë në këtë botë dhe në botën tjetër.

SADAKAJA - Profeti (a.s.), tha: "Sadakaja i fik gjynahet si uji zjarrin". Pse tha i fik dhe nuk tha i fshin. E tha kështu, sepse gjynahu është i nxehtë dhe duhet diçka për ta fikur atë. Kush ka mundësi, le të japë sadaka me pasuri, me fjalë, me ndihmë, me kontribut fizik. Nëse nuk bën keq, dije se edhe kjo është pjesë e sadakasë. Sadakaja e fik zemërimin e Allahut (xh.sh.). Zoti na bëftë nga ata njerëz, tek zemra e të cilëve ka vend sadakaja, sepse kush ka vend në zemrën e tij për sadaka, inshallah do t'ia japë Zoti mundësinë të japë sadaka edhe me dorën e tij.

NAMAZI I NATËS - Profeti (a.s.), tha: "Të falësh dy rekatë namaz në mesin e natës." Kjo të ruan në këtë jetë dhe në jetën tjetër, sepse është krenaria e besimtarit dhe pak besimtarë e bëjnë një gjë të tillë. Na bëftë Zoti nga ata njerëz, që u del gjumi dhe ngrihen e falin qoftë edhe dy rekatë namaz nate. Nëse nuk kanë mundësi të marrin abdest e të falen, të paktën të thonë njëherë me gjuhë fjalët LA ILAHE IL ALLAH, MUHAMEDUN RESULULLAH, se Zoti u thotë melekëve: "A e shihni robin Tim? Po ngrihet natën e po më kujton Mua. A keni parë ndonjëherë njeri të tillë?" Me të vërtetë është dhunti e madhe, prandaj Zoti na ndihmoftë ndaj egos sonë.

Pastaj, Profeti (a.s.), vazhdoi: "A do ta dish kokën e kësaj

2. Buhariu dhe Muslimi.



pune, shtyllën dhe kulmin e saj?"

Koka është Islami. Islami është gjithçka. Kush ka Islamin, ka gjithçka, kush ka humbur Islamin, ka humbur gjithçka. Islam do të thotë dorëzim me zemër te Zoti i gjithësisë. Flasim për dorëzim me dëshirë, se me imponim të gjithë njerëzit dorëzohen tek Allahu (xh.sh.).

Shtylla e kësaj feje është Namazi. A ndërtohet çadra pa shtyllë? Po shtëpi pa kolona e pa mure, keni parë ndonjëherë? Po kështu, nuk ndërtohet feja e Zotit për robin që nuk fal namaz. E di që mund të gjenden 1000 justifikime për të mos e falur namazin, por çfarë t'i themi Zotit, që i di punët dhe hallet tona.

O vëllezër, ky problem është i sqaruar. Kush ka mëshirë për veten e tij, le të punojë. Kush nuk ka mëshirë, ai merr në qafë vetëm veten. Namazi është shtylla e kësaj feje. Kush rrëzon këtë shtyllë, ka rrëzuar fenë e Allahut (xh.sh.).

Kulmi i fesë është Xhahidi në Rrugën e Zotit. Xhihad do të thotë të përpiqesh me gjithçka që ke, me fjalën tënde, me pasurinë tënde, me punën tënde, me penën tënde, me fjalën tënde, me trupin tënd. Të përpiqesh në rrugë të Zotit e t'ua duash njerëzve të mirën. Islami nuk është feja e atyre që duan rehatinë, feja e atyre që e jetojnë jetën si t'u vijë ose mundohen të jetojnë ndryshe nga të tjerët. Islami është feja e njerëzve që duan të derdhin djersë, që duan të lodhen, është feja e xhihadit vetëm për hir Zotit.

Xhihad nuk është vetëm luftë, por është shumë më tepër se kaq. Në fund vjen edhe lufta, me qëllim që të mos tolerohet padrejtësia dhe të ndalet ajo.

Pastaj, Profeti (a.s.), tha atë fjalë, që nuk e priste Muadh (r.a.), as ne: "O Muadh, a do ta dish sekretin e gjithë këtyre punëve? Kape fort këtë (gjuhën)".

Muadh (r.a.), me çiltërsi e pyeti Profetin (a.s.): "O Profet, a për fjalët që themi do të na marrë Zoti në llogari?" Profeti (a.s.), ia ktheu: "Të pastë nëna ty, o Muadh. Po a nuk e di ti se ajo që i fut njerëzit më shumë në zjarr, është

gjuha?"

Gjuha i fut njerëzit në zjarr. Kur njerëzit e analizojnë veten e tyre, thonë: "A për këtë gjuhë u futëm në zjarr? Asnjëherë nuk na paska shkuar nëpër mend kjo gjë."

Prandaj profeti (a.s.), ka thënë: "Kush më garanton për epshin dhe gjuhën e tij, unë i garantoj xhenetin."³ Garantonin nderin dhe gjuhën tuaj, që Profeti (a.s.) t'ua garantojë, xhenetin.

Pse gjuha? Me gjuhë mohohet Zoti. Me gjuhë akuzohet, me gjuhë gënjehet, me gjuhë bëhen padrejtësi, me të bëhen të gjithë të zezat. Për gjuhën, sahabët kanë thënë: "Kjo (gjuha) është dashur të mbahet në burg më shumë se gjithçka tjetër."

Zoti na bëftë nga ata njerëz, që u mjaftojnë dy a tri fjalë. Njerëzve të mirë nuk duhet t'u mbash ligjëratat. Njeriu i mirë e kupton dhe e pason të mirën. Ata njerëz i ka drejtuar Allahu (xh.sh.) dhe me të vërtetë janë të mençur. Kjo është gjithçka në këtë jetë.

Profeti (a.s.), e merr njëherë tjetër për dore Muadh (r.a.), ecën pak dhe i thotë: "O Muadh, po të jap disa porosi, prandaj ki mendjen. O Muadh, kije frikë Zotin, thuaj të vërtetën, mbaje besën, dorëzoje amanetin, braktise tradhtinë, mëshiroje jetimin, ruaje komshiun, mbaje zemërimin, zbutë fjalën, jepen selamin, mos iu ndaj grupit, kuptoje Kuranin, duaje ahiretin, frikësoju llogarisë, mos iu mbështet shumë kësaj jete, se është e shkurtër; punën që të besohet, bëje sa më mirë. O Muadh, unë po të ndaloj për diçka, prandaj ki kujdes. Mos e shaj myslimanin, mos e beso gënjeshtarin, mos e përgënjeshtro të sinqertin, mos e kundërshtoj prijësin e drejtë, mos bëj dëme mbi tokë. O Muadh, kujtoje Zotin në çdo pemë e në çdo gur. Sa herë të bësh një gjynah, pasoje gjynahun me pendim, qoftë kur je vetëm, qoftë edhe kur je me njerëzit e tjerë."

Zoti na bëftë nga ata njerëz, që pyesin pak e punojnë shumë. Zoti na bëftë nga ata, që e dëgjojnë fjalën e mirë dhe e pasojnë atë në formën më të mirë.

E lus Allahun (xh.sh.), të fusë në zemrat tona dashurinë për Profetin (a.s.), të na bëjë nxënës të mirë të këtij mësuesi.

E lus Allahun (xh.sh.), t'i falë gabimet tona, të mëdhatë e të voglat, ata që duken e ata që nuk duken.

E lus Zotin e gjithësisë t'i ruajë zemrat tona, gjuhët tona dhe gjymtyrët tona.

E lus Allahun (xh.sh.), të mos sillat ndaj nesh siç ne e meritojnë, por siç i takon madhësisë dhe mëshirës së Allahut (xh.sh.). Ai është falës i madh, Ai e pranon pendimin e robit të Tij.

Lus Zotin të na mëshirojë ne dhe prindërit tanë, ata që janë gjallë e ata që kanë vdekur, të gjithë myslimanët kudo që janë, të gjithë njerëzit që duan mëshirën e Allahut (xh.sh.).

Amin!..

3. Buhariu



Librari Progresi

Libraria Progresi prezanton librin
Titulli: Rugëtimi i Shpirtit
Autor: Osman Nuri Topbash
Botues: Shtëpia botuese Progresi

Profeti ynë i dashur (a.s.), i cili është poezia më e bukur e gjithësisë, zotëruesi i zemrës më të përsosur dhe më të mëshirshme, të gjithë një-rëzimin e ka parë nga kjo dritare botëkuptimi. Përveç faljes së gabimeve dhe të këqijave që i janë bërë, është sjellë mirë edhe me atë të cilit ia ka parë të keqen. Ka bërë dua dhe ka dëshiruar prej Allahut udhëzimin e tij. Ashtu si guaska e detit, që ia dhuron perlën që mban brenda edhe atij që e godet me gurë, edhe Profeti ynë (a.s.), duke nxjerrë perlat e mëshirës prej zemrës së tij të sedefitë, u lut për udhëzimin e atyre që e goditën me gurë në Taif. Ai nuk i mallkoi as ata që i thyen dhëmbët e tij të bekuar dhe i plagosën fytyrën në Uhud, por u lut që ata të gjenin rrugën e drejtë. Gjithashtu, na mjafton si shembull edhe fakti se ai, për të mbrojtur nderin e fesë me të cilën erdhi, nuk kërkoi që populli i Mekës të shkatërrohej nga ndëshkimi hyjnor, por dëshiroi që çdo njëri prej tyre të nderohej me islam.

Shpirti ka një qëllim. Ai qëllim është udhëtimi drejt Allahut. Dhe ky udhëtim mund të realizohet



vetëm me virtytet që nxjerrin në pah mëshirën, pra me fitoret e shpirtit.

Si përfundim, kush dëshiron të ketë një zemër të gjallë, të shijojë kënaqësinë e miqësisë me Allahun Teala dhe të arrijë lumturinë në të dyja botët, duhet t'i vërë veshin kësaj thënieje të urtë të Mevlanës:

“Nëse dëshiron të përhapësh dritë, duhet të djegësh nefsin tënd që i ngjan natës.”

“Kur të pastrohesh nga cilësitë që i takojnë nefsit, deti i urtësive dhe të fshehtave do të të mbajë (si kurorë) në kokë.”

TË GJITH KEMI NJI DERT!

Për m'i bâm ballë rrezikut të zhgattrimit, kujtojse s'gjindet kush ndër ne qi të mohojë nevojën e kurës (tedavi) qi kem. M'e mendue mbandej mënyrën se si mund të shërohemi sa mâ mirë e mâ shpejt, besoj se çdo mysliman qi kupton pak a shum, e ka si detyrë të domosdoshme. Pozicioni, në të cilin ndollemi na, më vjen se na, urdhnnon kësodoret:

Mbassi jemi të smuet si element (xhema-at) detyra e ynë, heren e parë është të diktojme smundjet e randa qi kem; së dytit të rrahim të diskutojmë me gjak ftoftsi e pa u nxem, masat qi duhen marrë për me pritë kështû, hovin e damshëm të lëngatës qi na ka kapë. Kjo qi thomi, s'është një punë aq e lehtë, qi të kryhet hê për hê, pse s'do qitë në harrësë se një lëngatë e vjetër, edhe mbassi qi të diktohet, don mjeft kohë për m'u shëruem jo mâ qi lëngata shoqnore e ynë është sa e randë aq edhe e kadtëshme.

Elementi mysliman i Shqipnis, çë prej ditës qi u formue Xhema-ati Islamiya, hudhi themelin e parë t'ekzistencës së vet dhe e çfaq botnisht se don të marrë masat për me rrojte si mysliman, s'po tham vetun nen hijen madhshore të Shqipnis së lirë, por n'Europen e nijzetit shekull të qytetnimit. Edhe një mend, në statutin e bukur qi la në duer të Këshillit të Naltë të Sherjatit, caktoj planin e vet, due të tham pikat esencjale të fatit të tij dhe ç'at ditë e sod ka nisë të kurohet e të këthejë për kah mâ mira. A s'është kështu? Për ata qi kanë sy me pa, për ata qi ndien ndopak në shpirt të të vet, mashina e Xhema-atit Islamiyes, për sa ka qenë e mundun e per sa mjete qi ka pasë, deri sod ka ecë e shkue per bukur.

Me gjith kët, s'mund thomi se i a kemi arrijtë qellimit. Koha qi ka kalue ç'prej themelimit të Xhema-ati Islamiyes e deri sod, na ka diftuem faret mirë se sa jemi të zot me bâ. Prandej gjith ata qi shofin pak a shum mâ larg se na, n'a kanë si uha vllaznije të na këshillojnë e të na çojnë prej gjumit, për me muejtë kështû të i a mërrimë muradit t'onë.

Por a ke pase me ne bjen njeri në bela, pse kuer s'na pelqen e së na bje per shtat, s'duem me ndiem as këshiell as kurgjâ e, me gjith qi e dijme se pa luejtë pakës për së gjalli s'bâhet gjëkafshë, prep se prep kemi qefë mos me na ngucë kushi, por me na lânë në hall t'onë deri kû të mund shkojmë! Mâ pse tash i del tymi mbandej, hiç s'duem me dijte e madje ka asish qi thonë -Zot ruejna- po, ça i duhet kuej m'u perzi e me hî në fjalë, as

lêne me shkue siç a nisë e ka m'e mbyllë loja vedin pa dijte kushi gjâ e pa i ra aq tepër kuejt në sy! Kush thotë kështû, kush? (ve ilallahî'l-mushteki)

Harrojmë se Perendija (azze she'nuh) urdhnnon e thotë:

(Estaidhu billah: Inna nahnu nezzena'dh-Dhikra ve inna lehu lehafidhun)¹

Na vjen çudë ndoshta pse shifen asish qi mundohen t'i rrijnë pikë për pikë fjalës së Pejgamberit: (Men asbaha ve lem jehtem...)² Ah, vëllazen; është e drejtë të na thohet se e kemi lânë rrugen e s'jemi kerkund aty pari! At qi del sheshazi e na fton per një të mirë, arsya thot t'a falundurojmë e jo ta mësuem, pse kështu na detyron edhe feja shëjte e ynë Myslimanizmi. Por kah haku është i idhët, ne s'na bluen mindja e shkretë. Aspak të mos na vijë keq kuer të na thohet që e kemi tretë fillin e punës edhe sakt qi e kemi tretë.

Qe edhe nj'a dy shembuj ndersa tjerë qi diftojnë sa keq e terthuras i kemi kapë punët: mbas besimit jemi t'urdhuem me menduem e me kujtuem mirë për shoqishojnë; mirë po na, kemi marrë aqsin, kemi rrokë të kunderten, e aq tepër jemi marrë mendsh sa s'din pendë me na vajtuem? Çë bājme na? Mendojmë se â mâ zi për tjetrin e aq verbtas ecim, si mos m'i pasë mendt në krye e sytë në ballë. Pse more të shkretit na kaq për bunë! Po kuer të hjekim besimin prej shoqishojt, si ka me muejtë m'u këqyrë punë? Nuk mâ ha mendja kurrsesi, se çë dobi mund kemi nga su-i zanni prej të cilit fetarisht jemi aq të ndaluem! Veset e liga, adeta janë bâ petk për ne: guxojmë m'i bâ tjetrit iftirana (çpifje); edhe ket s'e kemi për kurgjâ; pse flasim një për një tjetër as ket s'e kemi për asnjisend.

Së dij jo, se ku bazohemi qi ecim mbas mehamendjes? Pse s'mendojmë pakës njiherë qi jemi të gjith mysliman e qi kemi zbashkut një derd! Në vend qi të këshillohemi si vëllazen e t'u bājme derman derdevet të randa qi kem, largohemi prej tezit e kapemi me malihuljana qi s'i pershkohen askuej nder mend. Sakt i hjedhim ca fjalë qi s'kanë vend kërkund. Shtojcat qi bājme, pse bien me vedi efektin e keq, s'kemi kurrnji pikë gajlet, mjeft qi një herë të i a dalim m'e bâ t'onen!... Pse fitojmë njimij

1. Me te vertete na me madhnin t'onë e kemi zhdrype Kuranin dhe na jemi vet ronjsit e tij.

2. Ai qi zbardhe e s'kujdeset per çashtje te myslimanvet, s'është prej nesh.

haramë, prep s'është kurgjâ, qyesh se i kemi hjedhë mbas shpindet gjynahet e mëdha qi bājme, tuej folë fjalë qi s'kanë të bājnë me asnjerin prej nesh. Të mendojmë, se mendimet e burravet qi kanë kompetencë të hudhen në lamije t'arsytimit e të diskutimit, duhet të dijmë m'i kundruem e m'i karshillatisë e të mos këqyrim veç se si t'u kapemi e t'u ngatrohemi, pse as s'jemi në gjendje për m'u kapë me shoqishojnë as nuk na del edhe një dobi veç sherrit; por detyra e ynë është të kqyrim m'i perkrahë me gjith shpirtë aty ku të jen mirë e, aty ku të mos na duken me vend e s'mbesim të bindun, le t'i pervershemi pendës me urti e logjik e, tuej respektue rregullat e pergjithshme të polemikës, të dalim në shesh me mprojtë diepozitat, të cilavet sher-an e aklen jemi të detyruem m'u dalë zot.

Mënyren e bisedimit e të kuvendimit me shoqishoqin, Kurani Qerimi na ka tregue bukur mirë. (estaidh billah, udu ila sebili rabbike...)³ (ve la tuxhedilu ehlel kitabi illa billeti...)⁴ janë prej atyne ajeteve të madhnueshëm, të cilët na, lypset t'i kemi udh-hjekës, pse tuej punue dora doras kësodoret, udobisht kishim me muejtë m'u kapë në qellimin shëjt të caktuem t'onin. Prandej ne, s'na ka hije snji fije m'u sjellë ndryshe, pse kjo difton at-herë çiltas se s'jemi të zot e, kah s'dijmë me i a mbajtë, duem të përfitojmë prej ujit të turbullt. T'a dijmë se ka nisë m'i shkue made edhe ndër ne gjuetis së peshkut n'ujë turbull. Falemi nderës të Lumit, populli â zgjue e s'digjon me hangër një për një tjetër. Populli ynë, i zgjuet pernjihëri edhe prej natyret, s'ka ngae të hyjë në kurthë, pse i a çilë syni. Asht për t'u admirue per dashtni të madhe qi ka në besim e për ndjenja të forta qi ushqen për te Me gjith kët, mendja e preftë e tij, s'e lën të besojë gjâna qi s'kanë të bājë me të verteten. Fjalve qi së kanë manâ, s'u qasë veshin aspak, pse shyqyr ka mësuem e ça shef të shkrueme, s'ka nevojë të i a këndojë kush e ça është mâ mirë e per t'u lavdue, s' len të i a interpretojë tjetri ashtu si i kande ati e këti, porse e gjikon punen vetë është ashtu siç e shef. A s' â kështu? (Hadha min fadlli Rabbi)

Nji njeri qi ka mend në krye, s'çohet kurr për mirikande të kerkojë me bâ operacion në trup të vet; mund t'i shkojë kësajë, vetun kuer të ndijë nevojë e at-herë mos m'e bâ, sakt kishte për të bâ një gjynah të madh, pse lën vedin me shkue në rrezik e me mbaruem keqas me frymë.

Ai qi don të rrojë e mos të vdesë, natyrisht ulë kryet e i bindet kësajë mënyrë kure, mbassi s'ka rrugë tjetër për shërim veç operacionit a të premunit të ndo'i gjymtyre të trupit; por ay q'i pret drût shkurt e thot: valla, pa bâ muradë Zoti e pa pasë exhel, s'diset - thuese ata qi u këqyrkan nder heqim, s'i besokan vëç exhelit! - pa shyphe ky njeri, bâhet helaqë e për ket kryeneçsi të fortë qi difton, ka me pësue më tepër randë. (Hafazenallah!)

3. Grise njerzin ne rrugen e Zotit t'And me Kuran e me fjale te buta dhe luftoji me menyren mâ te bukren.

4. Mos e lefto ehli qitabin (besimtarin e fes se perparshme) veç me menyren qi është mâ bukur.

Tashti edhe puna e ynë, të rrij në shtremtë e të flasim drejtë, sikundër tham mâ syprî, i ngjet një të ligu. Për me muejtë m'u shndoshë, për ne ka vetun dy rrugë: m'i shue pares e me bâ kursime. Po s'punuem kshtu do të shkojmë tepër keq, me rrezik qi me lam durët një herë e pergjithmonë. Të flasim tani pra me insafë: kush del mâ i mirë e i aferm tu Zoti e tu robi a ai qi del e na çon prej gjumit apo ai qi don të na mbajë fjetë? Cili allahile cili? Këtë po ia lâ t'a gjikojë vetë opinjoni publik e sidomos intelektualt (efkar munevvera) e mbarë masa e re e ynë.

Si s'mendojmë pakës se kuer të na vije thika N'asht, at-herë s'na mbatet çëmë bâ. Mund të bājme sod, sa jemi vetë gjallë; jo jo, paçim vedin në qafë se s'na ka faj kerkushi. Më vjen keq pse s'i hyjmë pakës çashtjes në shpirtë por i shkojmë anave e syperfaqsisht. Po, hajdeni njihërë e t'a vëmë doren në zëmër na qi mba-hemi diçka, qi thomi edhe se na dhem zëmra e na djeg shpirti e s'kemi një muradë tjetër, vall si kishim me dalë në kontrollim?

Mos me qenë fedaqarlleku i ca imamve e i mezinave, besa për ne, kam frigë se ca xhamija kishin me mbetë mbyllë. Në Shkoder t'onë, për njeti s'dij, mos t'ishte sakrifica e madhe qi bâni imami e mezini i Xhamis së Ndo-caj, tuej pranue me sherbyem tri vjet gratis, un kujtoj se dugâjët qi u dogjen vjet në Pazar, s'do t'u goditshin. E po t'ishin qenë imami e mezini qi s'kan, si do ishte bâ puna? Po pse ky fedaqarlllek kaqi madh u kerkue vetun prej imamit e mezinit e s'u da rrota porcjon në mes t'onë, apo ndoshta imami e mezini janë mâ të pasun se na?

Të gjitha këto gjâna jemi qi shofim me sy edhe i flasim me gojë, tuej u ankue se janë keq e dijmë boll mirë se po u lënë kështu si janë e po s'u bâ një çajre, puna e tyne ka me shkue edhe mâ keq. Mirë po, kjo a bân? Në qoftë se ka gjâ qi s'ban në fytyrë të tokës, është vetun e vetun pozicjoni i ynë qi duem t'i ham punët e nevojtë t'ona me suqut! Lutem më thoni jo, në qosha se s'jam me vend.

At-herë pra a s'është shani i yne qi t'a presim me kënaqë shpirti atë qi na fton m'i dalë para me kohë kësaj punë? A s'kemi të drejtë të plotë të thomi se kemi të gjith një dert e i' hall?

Ja Rab! mos na bân prej atyne qi Vetë urdhnon e thue: (Ja ehlel kitabi lima telbisune el-hakka bilbatil ve tek-tumune el-hakka ve entum talemun)⁵ por në qofët se ne e kuptojmë, por s'na vjen për hesapë!

Shkodrani.

Marrë nga revista "Zani i Nalte", nr: 10, fq. 299. Maj 1927.

5. O ehli qitabe, pse mveshni te drejten (hak) me te shtremte (batil) e pse e mloni te verteten, kurse ju e dini?

ZBULOHEK ANTITRUPI, QË VRET ÇDO FORMË TË TUMORIT

Hulumtuesit e Universitetit "Stanford" në Kaliforni kanë zbuluar ilaçin, i cili "ka vrrarë" apo zvogëluar secilën formë të tumorit kundër të cilit është përdorur.

Ky ilaç bllokon proteinën e quajtur CD47, të cilën qelizat kancerogjene e prodhojnë në sasi të mëdha për të "mashtuar" sistemin imun të organizimit, kështu që ai pastaj nuk i shkatërron qelizat e kancerit.

Shkencëtarët krijuan antitrupin që bllokon proteinën CD47, duke e detyruar në këtë mënyrë që sistemi imun të sulmojë qelizat e kancerit. "Kemi treguar se madje edhe kur tumori forcohet, antitrupi mund ta shërojë tumorin apo ta ngadalësojë rritjen e tij dhe të pengojë metastazat",- tha biologu Irving Vajzman nga Fakulteti i Mjekësisë së Universitetit të Stanfordit.

Ilaçi u dëshmuar efikas kundër disa llojeve të tumoreve tek minjtë, duke përfshirë edhe tumorin e gjirit, vezoreve, zorrës së trashë, mëlçisë, trurit, prostatës dhe fshikëzës. Në të gjitha rastet, antitrupi arriti të stimulojë sistemin imun të minjve për të shkatërruar qelizat e kancerit.

"Ky është trajtimi i parë me antitrupa, i cili u dëshmuar efikas kundër një numri të madh të tumoreve të ngurtë dhe reaksionet janë vërtet fantastike, kështu që do të vazhdohet me kërkime klinike gjatë dy vjetëve të ardhshëm",- thuhet në ueb faqen e Universitetit Stanford. Rezultatet e hulumtimit janë publikuar të martën në ueb faqen e Akademisë nacionale të shkencave.

KRIPA E TEPËRT RREZIKON JETËN

Rreth 2.3 milion njerëz vdesin çdo vit në mbarë botën nga teprimi me sasinë e kripës që konsumojnë në ushqim.

Ky është përfundimi në të cilin ka arritur një grup studiuesish amerikanë. Kripa e tepërt shkakton infarkt, iktus dhe probleme kardiovaskulare. Gati 65 për qind e popullsisë globale konsumon dyfishin e sasisë ditore të kripës së rekomanduar nga mjekët, sasi që është 1.5-2 gram në ditë.

Grupi i shkencëtarëve të "Harvard School of Public Health" në Boston, paralajmëron të gjithë qytetarët që të kenë kujdes, sidomos me ushqimet e gatshme që merren nga supermarketet.

"Konsumojmë sasi të mëdha kripe pa e kuptuar. Vetëm 20 për qind të sasisë së kripës e marrim me vetë-

dije, ndërsa pjesa tjetër e saj na mbërrin nga ushqimet e gatshme, sidomos ato që marrim nga ushqimet e gatshme",- thuhet në studim.



FEMRAT KANË NEVOJË PËR MË SHUMË GJUMË

Shkencëtarët kanë studiuar kualitetin e gjumit tek 210 persona dhe kanë zbuluar që pas kohës së njëjtë të kaluar në gjumë, femrat në mëngjes tregohen më nervoze dhe armiqësore në krahasim me meshkujt.

Shkencëtarët nga universiteti "Duke" në Karolinën Veriore, kanë thënë se dallimi në hormone është arsyeja që femrat kanë nevojë për gjumë më tepër se meshkujt. Sipas ekspertëve, femrat vuajnë më shumë nga ana nervore dhe fizike nëse nuk flenë mirë, sepse kanë nevojë për më shumë gjumë për të ruajtur ekuilibrin hormonal.

Udhëheqësi i hulumtimit, Edward Suarez, thotë, seky hulumtim nxjerr në pah që gjumi i keq, i cili matet me numrin e përgjithshëm të orëve të gjumit, me kohën

e kaluar në gjendje të zgjuar gjatë natës dhe ç'është më e rëndësishmja, kohën e nevojshme për të fjetur, ka pasoja më serioze për shëndetin e femrave sesa të meshkujve.

Kemi vërtetuar që tek femrat gjumi i keq është i lidhur me nivelet e larta të stresit psikologjik dhe ndjenjën më të fortë të armiqësisë, depresionit dhe zemërimit. Përkundër kësaj, ndjenjat e tilla nuk janë pasojë e shkallës së njëjtë të çrregullimit të gjumit te meshkujt.

Hulumtimi ka treguar se mundësia që femrat të preken nga sëmundje të zemrës, depresioni dhe problemet psikologjike, për shkak të gjumit të keq, është më e madhe se tek meshkujt.

SKANER 3D PËR EKZAMINIMIN E VESHIT

Lantos Technologies ka prezantuar një skaner 3D të kanalit të veshit, të aprovuar nga FDA, që do t'u mundësojë mjekëve të diagnostikojnë më mirë veshët e pacientëve.

Ky sistem skanimi 3D i veshit mund të krijojë një imazh në formë harte të pjesës së brendshme të veshit, gjithashtu edhe një matje më të mirë për vendosjen e pajisjeve dëgjimore për veshët me probleme.

Është krijuar si një skaner tepër kontabël me një otoskop video për vizualizimin dhe navigimin në kanalën e veshit. Imazhet kapen dhe një skanim 3D për veshët gjenerohet, duke përdorur optika dhe algoritma të ngjitjes në një kohë brenda minutës.

Kjo teknologji mund të zëvendësojë procesin aktual që harxhon tepër kohë. Përmes saj mjekët krijojnë idenë se mbase veshi i pacientit gjeneron një substancë tip rrëshi-

re. Kjo substancë injektohet në kanalën e veshit dhe bëhet një masë solide. Heqja e kësaj njësie mund të jetë tepër e papërshtatshme dhe mund të shkaktojë një deformim në kuptimin e formës.

Sistemi 3D i skanimit të veshit, që nga fundi i këtij viti do të jetë i gatshëm për shitje. U zhvillua dhe u testua nga bashkëpunimi me mjekët ORL me sistemet e krijimit të pajisjeve dëgjimore. Pritet që ky zbulim të sjellë të reja në fushën e trajtimit mjekësor të problemeve dëgjimore, në fushën e mbrojtjes ndaj zhurmës industriale dhe në fushën e teknologjisë së komunikacionit.



IMPIANTI MË I MADH NË BOTË I ENERGJISË DIELLORE HAPET NË ABU DHABI



Lindja e Mesme është e njohur më shumë për naftën dhe, natyrisht, paratë që vijnë nga nafta. Megjithatë, rajoni po i hyn gjithashtu energjisë së rinovueshme dhe metodave alternative për sigurimin e energjisë elektrike, më specifiku Emiratet e Bashkuara Arabe, të cilat tani strehojnë impiantin më të madh në botë të energjisë diellore, vendosur në Abu Dabi.

Kompania e energjisë Shems Power ka hapur stacionin e ri Shams 1, që ka një kapacitet prej 100 megavat dhe mund të

furnizojë deri në 20.000 shtëpi. Ky impiant nuk e ndot ambientin dhe është i barabartë me mbjelljen e 1.5 milionë pemëve ose heqjen nga qarkullimi të rreth 15.000 makinave.

Stacioni Shems 1 përdor mbi 258.000 pasqyra alegorike, të cilat mbledhin rrezet e diellit. Stacioni mbulon rreth 1.55 kilometra katrorë. Këto lloj stacionesh të energjisë diellore datojnë që nga vitet 80, ku të parat janë ndërtuar në Kaliforni të SHBA-së. Megjithatë, Shems 1 mori kurorën si stacioni më i madh në botë.

SUBERKOMPJUTERI NË NDIHMË TË TË SËMURËVE

Hulumtuesit janë duke përdorur superkompjuterin "Gordon", i cili ka marrë emrin e heroit në filmin "Flash Gordon", për të sjuar një mënyrë për të udhëhequr zhvillimin e trajtimeve për çrregullimet mendore, si skizofrenia dhe autizmi.

Kur Gordon kaloi zyrtarisht online, në Janar 2012 në Qendrën e Super Kompjuterëve në San Diego (SDSC), superkompjuteri ishte shumë mbresëlënës, duke mbështetur më shumë se 35 milionë operacione në sekondë, një rekord botëror në atë kohë.

Operacionet input/output janë një mjet i rëndësishëm për të dhënat intensive informatike, pasi ato tregojnë aftësinë e një sistemi që komunikon shpejt me një sistem të përpunimit të informacionit, si kompjuteri dhe bota e jashtme.

Sistemi është përdorur nga shkencëtarët për punë

kërkimore ose krijimin e bazave të të dhënave të mëdha për përdorim të menjëhershëm ose të mëvonshëm, duke përfshirë hartime për aplikime në mjekësinë e personalizuar dhe shqyrtimin e automatizimit kompjuterik të aksioneve tregtare nga firmat investuese në Wall Street.



Muajin e kaluar kërkuesit nga SDSC dhe Pasteur Institute në Francë përdorën Gordon, për të krijuar një mënyrë novatore për të përshkruar një proces, që gjen shprehjet në tru dhe që mund të përdoren për të drejtuar zhvillimin e trajtimeve për çrregullime mendore.

Gjetjet mund të përdoren për zgjedhjen e faktorëve që mund të transkriptohen dhe që mund të ndihmojnë në trajtimin e çrregullimeve të caktuara mendore.

IZRAELI KËRKON FALJE NGA TURQIA DHE PRANON KUSHTET E ANKARASË

Izraeli i ka kërkuar falje Turqisë për sulmin ndaj anijes «Mavi Marmara», ku humbën jetën 9 qytetarë turq. Kryeministri Izraelit, Benjamin Netanjahu i kërkoi të falur Turqisë dhe pranoi kushtet e Ankarasë.

Pas sulmit kundër anijes «Mavi Marmara», Turqia i kish-te ulur marrëdhëniet diplomatike me Izraelin në nivelin e sekretarit të dytë. Për tre vjet me radhë Turqia nuk kishte hedhur hap prapa nga kushtet e saj, të cilat janë: kërkimi të falur, dëmshpërblimet dhe heqja e bllokadës ekonomike ndaj Gazës.

Në lidhje me kërkim faljeje nga ana e Izraelit për sulmin e organizuar ndaj anijes «Mavi Marmara» në vitin 2010, e cila transportonte ndihma humanitare për Gazën, Kryeministri Erdoan tha: «Gjaku i dëshmorëve të rënë në anijen *Mavi Marmara* nuk mbeti pa u paguar». «Ne nuk mundëm të injoroni vrasjen e 9 vëllezërve tanë dhe nuk heshtëm ndaj përpjekjeve për ta mbuluar këtë rast. Kërkuam dëmshpërblim dhe falje për dëshmorët tanë, kërkuam heqjen e rrethimit të Palestinës, ndërkaq nuk hodhëm hap prapa deri në përmbushjen e kërkesave tona të drejta.»

Ministri turk i Punëve të Jashtme, Ahmet Davutollu theksoi se është shumë e rëndësishme që Izraeli i kërkoi falje Turqisë dhe shtoi: «Ne këmbëngulëm që prej fillimit për çështjen e «kërkimit të faljes». Vija e kuqe e Turqisë në këtë proces 3-vjeçar ishte të kërkohet falje ndaj popullit turk dhe më në fund Izraeli arriti në atë pikë. Nëse nuk do të kishte kërkuar falje, kjo çështje nuk do të mbyllej, edhe sikur të

zgjaste një shekull apo më shumë»

Ndërsa Kryetari i Asamblesë së Madhe Kombëtare të Turqisë, Xhemil Çiçek deklaroi se ky është një zhvillim pozitiv, të cilin e kanë pritur me kënaqësi. «Shpresoj që probleme të tilla të mos përsëriten më në të ardhmen. Përderisa nuk kemi të bëjmë me një shkelje të të drejtave dhe ligjeve tona, ne deri më sot nuk kemi pasur probleme me askënd dhe nuk do të kemi as në vijim. Turqia kishte paraqitur disa kushte dhe në deklaratën e bërë nga pala izraelite thuhet se kushtet në fjalë janë plotësuar, prandaj këtej e tutje bashkëpunimi do të vazhdojë», - u shpreh kryeparlamentari turk.

Menjëherë pas «kërkimit të faljes» nga pala izraelite, marrëdhëniet Turqi-Izrael filluan të hyjnë në rrugën e përmirësimit. Ministria e Drejtësisë së Izraelit, Tzipi Livni i telefonoi Ministrin të Jashtëm të Turqisë, Ahmet Davutollu. Siç njoftohet, në këtë bisedë telefonike janë shqyrtuar marrëdhëniet ndërmjet dy vendeve pas kërkimit të falur nga ana e Izraelit.

Një nga temat që u diskutua më tepër ishte dëmshpërblimi për viktimat e ngjarjes së «Mavi Marmara». Sipas kësaj, u vendos për realizimin pa humbur kohë, një takim mes autoriteteve të ministrive të jashtme të Turqisë dhe Izraelit.

Planifikohet që Nënsekretari i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Turqisë, Feridun Sinirliollu, të takohet me homologun izraelit dhe në bazë të kësaj, të përcaktohet se kur dhe ku do të takohen autoritetet e ministrive të jashtme të dy vendeve.

DËNOHET ME 45 VJET BURG VRASËSI I GËRBAVICËS

Një gjykatë në Bosnjë Hercegovinë e ka dënuar me 45 vjet burg, ish pjesëtarin e forcave paraushtarake serbe të Bosnjës, Veselin Vllahović, i njohur edhe si «vrasësi i Gërbovicës». I dënuari Vllahović, që e kishte nofkën Batko, ishte i njohur për mizorinë e tij famëkeqe, pasi kishte kryer sulme kundër banorëve joserbë të Sarajevës, gjatë luftës në periudhën 1992-95.

Ai është shpallur fajtor për 31 vrasje, për dhunim të së paku 13 femrave, dhe për burgosje ilegale, torturë dhe vjedh-

je të një numri të civilëve në hapësirat e okupuara nga serbët në Sarajevë. Vllahović ia doli të ikte nga paraburgimi në Mal të Zi në vitin 2001, por në vitin 2010 është arrestuar në Spanjë dhe më vonë u është dorëzuar autoriteteve të Bosnjë Hercegovinës.

Dënimi i Vllahovićit është më i rëndi deri tash, i kumtuar në ndonjë gjykatë të Bosnjë Hercegovinës për krime të luftës.

SHQIPTARËT E LIBANIT SHPREHIN MIRËNJOHJE PËR TURQINË

Shoqata Ndërkombëtare e Shqiptarëve të Libanit dhe Qendra Kulturorë «JunusEmre» në Bejrut organizuan një konferencë me temë historinë shqiptare dhe osmane. Në konferencë u mbajtën kumtesa mbi pozitën e shqiptarëve në historinë e Shtetit Osman dhe të Turqisë, si dhe u prezantuan punime artistike të komunitetit shqiptar që jeton në Liban.

Ligjëruesit folën për interesin e veçantë të Shtetit Osman ndaj kulturës dhe artit shqiptar. Folësit në Konferencë theksuan origjinën shqiptare të Mehmet Akif Ersojit, autorit të himnit kombëtar të Turqisë dhe një prej poetëve të res-

pektuar të letërsisë turke.

«Në emrin tim personal dhe të Shoqatës Ndërkombëtare të Shqiptarëve të Libanit, dua të shpreh mirënjohjen ndaj Shtetit Osman dhe Turqisë. Para së gjithash, me organizimin e këtij aktiviteti deshëm të shlyenim një detyrim të besnikërisë që kemi ndaj popullit turk dhe Osmanëve. Falënderoj Turqinë në emrin tim dhe të njerëzve me origjinë shqiptare, që sot në botë numërohen me miliona», - tha Abdulkërim Kasim. Në Liban sot jetojnë rreth 30 mijë qytetarë me origjinë shqiptare.